

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 421 • DHJETOR 2025



| TURPI DHE MORALI – DY KONCEPTE
| TË PANDASHME NË KURANIN FISNIK

| KUSH PO E PËRQAFON DHE
| KUSH PO E BRAKTISË ISLAMIN?!

| JETA VIRTUALE – NJË PORTË DREJT
| LAJTHITJES SË BREZIT TË RI

“40-vjet nga botimi i shqipëruar i Kuranit fisnik”



EDITORIAL

- 4 E mira dhe e keqja, dhe përpjekjet për ridimensionim të tyre
- 5 Njëzet vjet dritë, devotshmëri dhe vizion
Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Departamentit të Gruas

FETARE

- 9 Turpi dhe morali – dy koncepte të pandashme në Kuranin fisnik
Prof. ass. dr. Lulzim Esati
- 12 Amoraliteti si shkak i krizave dhe sëmundjeve shoqërore
Isa Tërshani
- 16 Besimi ndërmjet bashkëshortëve – çelës i jetës bashkëshortore
Artan Musliu
- 19 Ekuilibri riprodhues në perspektivën islame
Fitim Flugaj
- 22 Mënyra se si bëhet rukuja
Dr. Ejup Haziri

AKTUALITET

- 25 Kush po e përqafton dhe kush po e braktisë Islamin?
Hajrudin S. Muja
- 31 “Lëvizja e Deçanit” po mashtron, sepse katolicizmi nuk është shqiptarizëm
Milazim Krasniqi
- 34 Fryma e munguar romantike dhe propaganda e gjallë ideologjike antikombëtare
Besnik Jaha

FAMILJE & EDUKIM

- 38 Jeta virtuale – një portë drejt lajthitjes së brezit të ri
Nada Dosti
- 41 Rrënjësia e virtyteve etike të fëmijët në mes psikologjisë dhe Islamit
Adlie Morina-Krasniqi



- 45 Varësia dopaminike si sfidë e shekullit – një qasje neuroshkencore dhe islame
Dr. Erda Ballëk

KULTURË

- 49 Prezantimi i denjë i Islamit në xhamitë e mërgatës shqiptare – ky mision i shenjtë mbi supet tona
Besnik Kadrioli
- 52 Kimia në shërbim të mjedisit – përgjegjësia e njeriut sipas Islamit
Mr. Njomza Sadriu
- 55 Zëri i Atdheut në Poezinë e Mulla Mehmet Gashit
Ymer Havolli

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 57 Prishtina gjatë shekujve XV-XVI
PhD cand – Agon Krasniqi
- 61 Kontributi i vëllezërve Benu Musa në zhvillimin e shkencës (shekulli IX)
Artan S. Mehmeti

REPORTAZH

- 66 “40-vjet nga botimi i shqipëruar i Kuranit fisnik”
69 “20-vjet përkushtim me vizion”

AKTIVITETE

- 71 Myftiu Tërnavë u prit në takim nga ministri i Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit i Mbretërisë së Arabisë Saudite

**DITURIA ISLAME**

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 421 • viti 39 • Dhjetor 2025
• Xhumadel Ahire / Rexheb 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



*“Sot u janë lejuar
për juve gjërat e
mira (e të pastra)...”*

(El Maide, 5)

Përpjekjet për ridimensionimin e së mirës dhe të keqes

Para ardhjes së shpalljes përfundimtare të Islamit, njerëzit jetonin në një konfuzion të thellë moral dhe në një gjendje anarkie gjithëpërfshirëse. Nuk ekzistonin kritere të qarta për të dalluar të mirën nga e keqja, as kufij që përcaktonin vlerat dhe antivlerat. Prandaj, siç edhe pritej, kjo fe mori përsipër që të përcaktojë standardet e të mirës, duke e bërë të ligjshme-hallall atë, dhe përcaktoi standardet e së keqes, duke e bërë të ndaluara-haram atë. Allahu i Lartëmadhërishtëm njoftoi se kriter për ta shpallur një vepër të lejuar, është të qenit të saj “e mirë”. Ai, në Kuran, tha: *“Sot u janë lejuar për juve gjërat e mira (e të pastra)...”* (El Maide, 5). Pra, nominimi hyjnor i një vepre si e lejuar erdhi vetëm pasi e vlerësoi Krijuesi atë si vepër të mirë, ashtu siç nominimi i një tjetre si e ndaluar, erdhi vetëm pas klasifikimit të saj nga Ai, si vepër e shëmtuar dhe e keqe. Megjithatë standardet, tekton dhe prirjet e njerëzve mund të vazhdojnë të mbesin në konfuzion të plotë dhe kundërshti të thella, kur ata bëjnë përpjekjet për ta kriterizuar të mirën dhe të keqen, atëherë ndërhyrja hyjnore bëhet e domosdoshme. Këtë qartësi të standardit hyjnor, që bën dallimin ndërmjet veprave të mira dhe atyre të liga, Muhamedi a.s., e vuri në spikamë kur në hadithin e transmetuar nga Selman el Farisiu r.a., tha: “Hallall - e ligjshme është ajo që Allahu e ka lejuar në Librin e Tij, haram- e paligjshme është ajo që Allahu e ka ndaluar në Librin e Tij, dhe ajo për të cilën Ai ka heshtur është nga ato që i ka falur (i ka lënë të lejuara).” (Et Taberani, El Mu’xhem el Kebir, nr. 6356). Ky hadith, lë të kuptohet se ekziston një bonton veprime, të cilat meqë nuk kanë ndonjë dëm ose dobi të theksuar për njeriun, kanë mbetur në dispozicionin e njeriut dhe Ligjvënësi ka hequr dorë nga përvijimi normativ i tyre.

Ndërkaq, përpjekjet që sot njerëzit bëjnë për ta rikonstruktuar të mirën, apo edhe të keqen, ndonëse mund të duken krejt të ‘çiltra’ dhe racionale, megjithatë, janë një tregues i një lloj rebelimi të krijuar njeri ndaj Krijuesit të vet. Ato janë gjithashtu edhe tentativa për ta kthyer çështjen në pikën fillestare të konfuzionit dhe dialektikës së pafundme, ku secili ka të drejtë të lejojë për vete çdo gjë apo të ndalojë çdo gjë.

Në akaidologjinë islame, ajo mund të cilësohet dhe përfshirje njerëzore në një ekskluzivitet që i përket vetëm hyjnore-Zotit. Është kështu sepse, në korpusin vleror islam, zbulesës hyjnore gjithmonë i është dhënë epërsi ligjvënëse mbi arsyen. Meqë personaliteti njerëzor nuk ka kapacitetet e mjaftueshme që të sjellë gjykime dhe vendime përfundimtare rreth shumë sjelljeve dhe veprimeve njerëzore, ai shpesh mund ta lajthisë njeriun. Që të mos tingëllojë kjo si një teori islame që ka për qëllim të spostojë mendjen e njeriut, duhet ditur se Islami nuk synon ta lejë atë të deaktivizuar prore; krejt çka kërkohet është të vendosen linjat hyjnore të standardizimit të veprimeve të njeriut, e pastaj në ato linja, dhe sigurisht brenda tyre, njeriu do ta kuptojë të mirën dhe të keqen dhe parametrat dallues në mes tyre.

E modernizmi si doktrinë, i dha një pozicion përfundimtar dhe dominant intelektual njerëzor dhe e paraqiti racionalitetin si një të vërtetë përfundimtare. Kjo doktrinë, megjithëse njeriut i ka premtuar një jetë të lumtur në “parajsën e kësaj jete” me kusht që të jetë pa limite morale, duket se po e shtynë vrullshëm shoqërinë drejt një kulture ku ngulfatet nevoja për ekzistencën dhe ruajtjen e vlerave morale. Kjo e bën jetën tejet fluide, dhe në të, gjithçka imagjinohet të bëhet e lejuar racionalisht. “Format e jetës moderne mund të ndryshojnë në disa aspekte, por ajo që i bashkon të gjitha është pikërisht brishtësia, përkohshmëria, cenueshmëria dhe prirja e tyre ndaj ndryshimit të vazhdueshëm. ... Ajo që kam zgjedhur ta quaj modernitetin i lëngshëm”, thoshte Zygmunt Bauman. Kjo prurje e vlerësuar si e çmuar nga modernistët, ku çdo vlerë e limit moral mbetet e përkohshme dhe e mundshme për ndryshim, në fakt shpie doemos te një anarkizëm moral, të cilin e admirojnë çmendurisht një pjesë e atyre që flasin çdoherë për të drejtën individuale dhe privatësinë personale.

Natyrrshëm se Islami iu qëndron në antipod këtyre prirjeve dhe fton i njerëzit që të besojnë fuqishëm se burimi i së vërtetës përfundimtare është Allahu i Plotfuqishëm. Ai është i Gjithëdijshëm dhe përkufizimet e Tij për të mirën dhe të keqen janë rezistente ndaj furtunave ideologjike nëpër kohë, për një arsye të thjeshtë, ngase Dija e Tij është gjithëpërfshirëse, ndërkaq dituria e njeriut mbetet e mangët e relative. *“Ai e di atë që është para tyre dhe atë që është pas tyre, ndërsa ata nuk përfshijnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do...”* (El Bekare, 255).

Mr. Driton Arifi

Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Departamentit të Gruas

Njëzet vjet dritë, devotshmëri dhe vizion

- E nderuar koordinatorë e Departamentit të Gruas, znj. Vaxhide Podvorica,
- E nderuar zv.kryeministre, znj. Emilje Rexhepi,
- E nderuar nënkryetare e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu,
- E nderuar zv.ambasadore e Turqisë, znj. Shejda Ajdën,
- I nderuar drejtor i Medresesë, z. Fadil Hasani,
- Të nderuar bashkëpunëtorë,
- Të nderuar efendilerë,
- Të nderuara deputete,
- Të ndaruara mysafire nga Tirana dhe Shkupi,
- Të nderuar përfaqësues të institucioneve të ndryshme,
- Vëllezër dhe motra,
- Të nderuar të pranishëm,

Duke u nisur nga realiteti shoqëror dhe fetar i vitit 2004, realitet shpesh i rënduar nga keqkuptimet, paragjykimet dhe qasjet e papërgjegjshme ndaj fesë, besimit dhe rolit të femrës-gruas myslimane shqiptare në Kosovë e më gjerë, Bashkësia Islame e Kosovës e pa të domosdoshme që misioni i saj të shtrihej edhe më gjerë, më fuqishëm dhe më thellë në zemrën e besimtarëve tanë. Në një kohë kur zëri i gruas myslimane shqiptare shpesh sfidohej dhe nënvlerësohej, lindi nevoja për t'i dhënë vendin që i takon femrës shqiptare edhe në aspektin fetar, një vend dinjitar, vend të ndritshëm, vend që feja jonë e bekuar ia njeh dhe ia garanton asaj.

Me këtë vizion, dhe në frymën e mëshirës dhe drejtësisë që përçon Islami, BIK-u ndërmoi hapa të guximshëm, si në themelimin e paraleleve të Medresesë për vajza në Prishtinë dhe Prizren më 1997, e më vonë edhe në Gjilan, duke çelur shtigje të reja diturie dhe emancipimi. Por, viti 2004 shënoi kthesën më të madhe. Në atë vit u mor vendimi me rëndësi



për themelimin e Departamentit të Gruas – një akt largpamës, një hap i bekuar që e ngriti rolin e gruas shqiptare myslimane në pedestal të merituar brenda jetës fetare, kulturore e shoqërore, duke filluar me punë ky Departament më 18 janar të vitit 2005.

Sot, në 20-vjetorin jubilar të këtij Departamenti, kthejmë kokën pas me mirënjohje dhe zemër të mbushur me emocion. Çdo hap, çdo aktivitet, çdo kontribut i motrave dhe bijave tona të përkushtuara, ka qenë dritë që ka ndriçuar familjet tona, xhamitë tona, komunitetin tonë dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi, ngase Departamenti i Gruas u bë



simbol i fuqizimit, i besimit të pastër, i devotshmërisë dhe i urtësisë së gruas shqiptare myslimane kosovare.

Sot, pas një udhëtimi plot dritë që shtrihet mbi dy dekada, Departamenti i Gruas qëndron krenar si një nga shtyllat më të fuqishme, më të begata dhe më frytdhënëse të veprimtarisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ajo që dikur nisi si një vizion i guximshëm, sot është shndërruar në një realitet madhështor, me mbi 300 të punësuarë e të përkushtuarë në shërbim të fesë dhe kombit, me projekte të qëndrueshme që prekin zemrat e familjeve në tërë Kosovën dhe mërgatën tonë të dashur, e me një rrjet bashkëpunimi që nis nga institucionet tona vendore e arrin deri te partnerët ndërkombëtarë brenda dhe jashtë Kosovës.

Ky Departament, i lindur nga nevoja dhe i rritur me sakrificë, është bërë sot zë i fuqizimit, i dinjitetit të gruas shqiptare myslimane, shembull i profesionalizmit dhe urtësisë, një dritare që pasqyron bukurinë e rolit të saj në fe dhe shoqëri. Çdo projekt, çdo aktivitet, çdo kontribut i këtyre dy dekadave flet për mund, për devotshmëri, për përkushtim të thellë dhe për dashuri të pastër për komunitetin.

Të nderuar të pranishëm,

Në mësimet e Islamit, gruaja nuk është figurë dytësore, as hije pranë burrit, e as simbol dekorativ i shoqërisë. Ajo është genie e nderuar, e pajisur me dinjitet, me të drejta dhe përgjegjësi të plota, një shtyllë e domosdoshme në ndërtimin e familjes dhe shoqërisë së shëndoshë. Në shikimin hyjnor, nuk ka dallim ndërmjet njerëzve për nga prejardhja, ngjyra apo gjinia, ngase vlera e njeriut matet me devotshmërinë dhe zemrën e pastër.

Kurani, që në ditët e para të shpalljes, gruas i kushtoi kujdes të veçantë, e mbrojti, e ngriti, ia riktheu zërin, dinjitetin dhe vendin e merituar. Në një kohë kur padituria dhe injoranca e trajtonte femrën si barrë, madje i mohonte të drejtën të jetonte, Kurani – Shpallja e fundit hyjnore erdhi dritë që e

shpëtoi atë nga errësira, si mëshirë që ia zgjati dorën dhe si udhëzim që e ngriti në pedestal të respektit.

Femra në besimin islam mban një rol kyç në shoqëri; ajo është edukatore e brezave, është burim dashurie, burim morali dhe besimi në familje. Nëse çdo familje jeton me këtë vetëdije, e gjithë shoqëria ngrihet në dritë, në paqe dhe në harmoni. Por, roli i gruas nuk mbyllet brenda mureve të shtëpisë, ngase ajo është bartëse e dijes dhe kontributit në çdo fushë, ku moralit, urtësisë dhe butësisë së saj duhet hapur rrugë.

Arsimi, mjekësia, edukimi, shërbimet sociale, të gjitha këto fusha marrin ngjyrë më njerëzore, më të mëshirshme e më fisnike kur aty sheh një grua të përkushtuar, që e kryen detyrën e saj si adhurm ndaj Zotit dhe si shërbim ndaj njerëzve.

Sot, në -20 vjetorin jubilar të Departamentit të Gruas në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, këto vlera marrin edhe më shumë dritë, ngase ky Departament është bërë zëri, mbështetja dhe forca e gruas shqiptare myslimane kosovare; është bërë shenjë se kur puna mbështetet në besim, vizion dhe përkushtim, ajo jep fryte që ndryshojnë shoqërinë.

Shumë fëmijë, të reja, por edhe gra në moshë të thyer u udhëzuan drejt njohjes së Islamit dhe parimeve madhështore të fesë islame përmes Departamentit të Gruas, duke përvetësuar njëkohësisht edhe leximin e Kuranit fisnik, dhe mësimin përmendsh të tij, përmes mësueseve-mualimeve tona në tërë territorin e Republikës sonë. Ky angazhim i palodhur jo vetëm që i pasuroi mendjet e tyre me dije, por edhe zgjoi në zemrat e tyre një vetëdije të re shpirtërore, duke i lidhur thellësisht me vlerat, moralin dhe dritën udhëzuese të Islamit.

Të nderuar të pranishëm,

Duhet pasur parasysh se gruaja është gjysma më e çmuar dhe më jetike e shoqërisë, por gjithashtu duhet ditur se edhe

gjysmën tjetër e ka lindur gruaja, gjysma pa të cilën jeta nuk do të mund të ecte përpara dhe as shoqëria të mbetej e qëndrueshme. Ajo është zemra që rrit, edukon dhe formëson gjysmën tjetër të njerëzimit; është dorë që ushqen shpresën, mendje që ndërton të ardhmen, dhe shpirti që sjell dritë në çdo shtëpi dhe çdo brez. Është boshti i përparimit, është energjia morale dhe shpirtërore që i jep jetë komunitetit. Pa kontributin, urtësinë dhe përkushtimin e saj, nuk do të kishte as ngritje, as kulturë, as shoqëri të shëndoshë.

Në këtë përvjetor jubilar, këto fjalë marrin kuptim edhe më të thellë, ngase për dy dekada me radhë, ky Departament ka dëshmuar se fuqia e gruas myslimane shqiptare është dritë që ndërton, forcë që edukon dhe urtësi që e çon përpara mbarë shoqërinë tonë.

Islami e ka nderuar gruan me të drejta të qarta, të paceshme dhe të garantuara nga Vetë Zotit i Gjithëfuqishëm. Ai i dha asaj të drejtën të jetë pronare e pavarur, të drejtën për të trashëguar me dinjitet, të drejtën të zgjedhë bashkëshortin e saj, të drejtën e arsimit dhe të diturisë, të drejtën e punës dhe kontributit në shoqëri – dhe mbi të gjitha, i dha të drejtën për dinjitet, respekt dhe trajtim të mirë, si një krijesë e nderuar e Zotit të Madhërishtëm, i Cili thotë: “...meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar.” (En Nisa, 32).

Muhamedi a.s., ka thënë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman dhe myslimane.”

Këto të drejta hyjnore iu dhanë gruas në një kohë kur shumë shoqëri nëpër botë, madje edhe ato që sot quhen të zhvilluara, nuk e njihnin fare dinjitetin e saj, nuk ia pranonin zërin dhe as rolin e saj brenda familjes apo shoqërisë. Islami e vendosi gruan në qendër të jetës shoqërore dhe familjare, duke e bërë bartëse të dritës, të moralit dhe të mëshirës. Ky Departament, i ngritur mbi parimet hyjnore të drejtësisë dhe respektit, ka punuar për dy dekada për t'i forcuar këto të drejta, për t'i mbrojtur, për t'i promovuar dhe për t'i bërë pjesë të jetës së përditshme të femrës myslimane.

Që në zbritjen e ajetit të parë të Kuranit: “Lexo në emër të Zotit i Cili krijoi çdo gjë”, dija u shpall si dritë e hapur për të gjithë – pa dallim gjinie. Gratë e asaj kohe merrnin pjesë në mësim, bënë pyetje, jepnin përgjigje, transmetonin hadithe etj., ngase dija nuk ishte privilegj vetëm për burra, por amanet i përbashkët i të gjithëve.

Gratë në kohën e Pejgamberit a.s., ishin pjesë aktive e jetës publike: kujdeseshin për të plagosurit në betejë, merrnin pjesë në marrëveshje, në betime, merreshin me artizanate, tregti dhe shërbime të ndryshme. Ato ishin prezente, të fuqishme dhe kontribuuese, pjesë e gjallë e bashkësisë, jo të izoluara dhe jo të heshtura. Roli i gruas në familje dhe në shoqëri nuk është as sekondar, as i imponuar, përkundrazi, është rol themelor dhe rol ndërtues. Sot, këto parime marrin

dritë të re, sepse ky Departament është pikërisht vazhdimësi e asaj trashëgimie profetike: forcim i dijes, hapësirë për kontribut, nderim për rolin e gruas dhe shërbim për komunitetin me devotshmëri dhe përkushtim.

Të nderuar të pranishëm,

Islami ia ktheu gruas të drejtat që i ishin mohuar në kohën e errësirës së injorancës, kur as e drejta për të jetuar nuk i garantohej. Shpallja hyjnore erdhi si mëshirë, si dritë dhe si drejtësi: i dha të drejtën e trashëgimisë, të drejtën e pronësisë së pavarur, të drejtën e zgjedhjes së bashkëshortit, të drejtën e mirëmbajtjes materiale, të drejtën e arsimit dhe të dijes – të drejta që shumë shoqëri të botës i njohën shumë shekuj më vonë.

Islami sqaroi barazinë e qenësishme dhe të drejtat e njeriut të dy gjinive qysh para 14 shekujsh, shumë përpara se bota të nxirrte deklarata dhe konventa ndërkombëtare për të drejtat e tyre, siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme OKB-së në vitin 1948, që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të çdo personi, pa dallim race gjuhe a feje, gjinie, kombësie apo statusi. Pra, Deklarata Universale e vitit 1948, trajton çështje që, sipas fesë sonë islame, janë adresuar qysh para 14 shekujsh.

I Dërguari i fundit i Zotit të Madhërishtëm, Muhamedi a.s., me fjalën dhe shembullin e tij, ngriti pozitën e gruas si askush tjetër para tij. Madje, disa ditë para se të ndërronte jetë, në hytben – ligjëratën e tij të fundit, në atë këshillë testamentare plot dhembshuri e dashuri, ai përsëriti: “O njerëz, kini frikë Zotin në lidhje me gratë, ju porosis të silleni mirë me gratë.”

Në suren Huxhurat, Allahu xh.sh., na mëson: “...më i nderuari tek Allahu është ai më i devotshmi.”

Ky është standardi hyjnor i barazisë – jo gjinia, por devotshmëria; jo forma, por vepra; jo epërsia shoqërore, por pastërtia e zemrës.

Shpesh, kritikën për pozitën e gruas në Islam vijnë nga keqkuptimet dhe keqinterpretimet e teksteve fetare nga persona të paditur, nga individë e grupe të shtyrë nga qarqe të ndryshme kundër Islamit, dhe nga individë të paguar. Fatkeqësisht, në shumë raste, këto interpretime të shtrembëruara përdoren për të ndërtuar një imazh të padrejtë për Islamin dhe femrën myslimane. Për të parë realitetin, le ta shohim pozitën e gruas në disa prej civilizimeve të ndryshme nëpër botë.

Në Heladën e vjetër, në shekullin e katërt para erës së re, gjegjë Aristotelin një prej filozofëve idealist më të famshëm grek, i cili thoshte: “Gruaja është mashkull i paplotë, që natyra e la në shkallën më të ulët të krijimit.”

Derisa Sokrati shkoi edhe më larg: “Ekzistenca e gruas është burimi më i madh i krizave në botë; gruaja i ngjan një peme helmuese: duket e bukur, por zogjtë që hanë prej saj vdesin menjëherë.”



Në Mesjetë, brenda civilizimit evropian të krishterë, gruaja ishte e përbuzur dhe e nënçmuar, madje e quanin “një e keqe nga veprat e djallit”. Ajo trajtohej si një plaçkë që blihej e shitej në treg, pa të drejta, pa të drejtë trashëgimie, pa të drejtë pronësie, pra jetonte në një gjendje të mjerë.

Te hebrenjtë, gruaja ishte objekt i urrejtjes dhe përbuzjes, një mall i lirë që kalonte nga një burrë te tjetri me mënyra të shëmtuara. Ata e quanin gruan “mallkim”, sepse “ajo sipas tyre mashtroi Ademin”. Në Dhiatën e Vjetër thuhet: “Gruaja është më e hidhur se vdekja”.

Edhe në Gadishullin Arabik, para zbritjes së Kuranit, arabët e shihnin gruan si një objekt në pronësi. E privonin nga trashëgimia dhe thoshin: “Nuk na trashëgon askush veç atij që mban shpatën.” Vajza konsiderohej turp, nëse lindte vajzë, burri zemërohej dhe e shihte si fatkeqësi. Varrosja e vajzave të gjalla ishte praktikë e përhapur te disa fise arabe.

Islami, të cilin shumë e akuzojnë pa prova, është i vetmi që e nderoi gruan, qysh para 14 shekujve, bile Pejgamberi ynë a.s., ka thënë: “Xheneti është nën këmbët e nënës”.

Kjo thënie e vendos gruan-nënë në zenitin e hierarkisë morale, duke e bërë kujdesin dhe respektin ndaj nënës rrugën më të drejtpërdrejtë drejt shpërblimit hyjnor. Edhe përmes kësaj thënie gruas iu ruajt dinjiteti dhe iu ngrit vlera. Tekstet fetare theksojnë qartë respektimin e gruas dhe dënimin e rëndë për çdo cenim të saj.

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “Ju keni të drejta ndaj tyre, por edhe ato kanë të drejta ndaj jush.”

Derisa sot, në 20-vjetorin e Departamentit të Gruas të Bashkësisë Islame të Kosovës, të vërtetat fetare marrin jetë në formën më të bukur, ngase për dy dekada, ky Departament ka qenë shtyllë që i forcon të drejtat e gruas, zë që i mbron, dritë

që i udhëheq dhe zemër që i përfaqëson me dinjitet, moral dhe profesionalizëm. Ka qenë dhe mbetet një prej arritjeve më të mëdha të Bashkësisë Islame në misionin e saj fisnik për t'i dhënë gruas vendin që Zoti i Madhërishëm ia ka caktuar: vend nderi, vend drite, vend përgjegjësie dhe vend nderimi.

Ky jubile është dëshmi se kur punojmë me qëllimin e pastër, me besim në Zotin e Madhërishëm dhe me dashuri për komunitetin tonë, për vatanin tonë, hapat tanë lënë gjurmë që zgjasin. Le të jetë ky përvjetor një thirrje për të vazhduar edhe me më shumë forcë, më shumë dritë, më shumë përkushtim në shërbim të vlerave tona fetare dhe kombëtare.

Zoti e shpërbleftë çdo hap, çdo sakrificë dhe çdo zemër të përkushtuar që e ka ngritur këtë Departament në pedestalin ku qëndron sot. Le të vazhdojë ky mision edhe me më shumë fuqi, dritë dhe bereqet në vitet që vijnë.

Urime 20-vjetori i themelimit të Departamentit të Gruas në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në fund krejt, në emër të Bashkësisë islame të Kosovës, ju uroj edhe 28 Nëntorin – Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë.

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 25 nëntor 2025

Turpi dhe morali – dy koncepte të pandashme në Kuranin fisnik

Prof. ass. dr. Lulzim Esati

Kurani i Madhërishëm është libër hyjnor i udhëzimit për mbarë njerëzimin, sipas përkufizimit të Vetë Zotit të Lartësuar, i Cili e ka zbritur atë: “*Muaji Ramadan, që në të filloi të shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz.*” (El Bekare, 185).

Kurani gjithashtu është sistemi moral i besimtarëve, ose “rend moral”, që nënkupton tërësinë e parimeve, virtyteve dhe normave, që udhëheqin sjelljen e besimtarit sipas mësimave të Kuranit. Këtë e bën të qartë fjala e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë: “Unë jam dërguar për të përsosur moralin e lartë.”¹ Ndërtimi i këtij sistemi kishte filluar qysh nga Ademi a.s. dhe u përkrye me Muhamedin a.s., si tullë e fundit e kësaj

strukture. Allahu i Lartësuar e ka lavdëruar të Dërguarin e Tij a.s. për moralin e tij të lartë, duke thënë: “*Vërtet, ti je në një moral të lartë!*” (El Kalem, 4).

Po ashtu, Ai e ka urdhëruar atë me virtytet më të bukura, duke thënë: “*Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet (si) mik i afërt.*” (Fusilet, 34). Kështu, morali nuk është vetëm një kod rregullash, por një pasqyrë e shpirtit që e njeh Zotin dhe i bindet Atij me dashuri. Çdo pejgamber është dërguar për ta ngritur moralin në mesin e njerëzve. Apo, siç përkufizohet troç në shumë hadithe të Pejgamberit a.s.: “Ai që është më i dashur për mua është ai që ka karakterin më të mirë.”

“Vërtet, ti je në një moral të lartë!”

(El Kalem, 4)



(Transmetuar nga Buhariu); “Vërtet, ndër më të mirët prej jush janë ata që kanë moralin më të mirë.”; “Besimtari më i përsosur në iman është ai që ka moralin më të mirë. Dhe më të mirët prej jush janë ata që sillen më mirë me gratë e tyre.”³

Kurani na mëson se morali përfshin të gjitha dimensionet e jetës: drejtësinë, mëshirën, ndershmërinë, përmbajtjen, durimin dhe faljen. Zoti thotë: “Vërtet, Zoti urdhëron për drejtësi, për bamirësi dhe për ndarjen me të afërmit, e ndalon nga imoraliteti, e keqja dhe padrejtësia.” (En Nahl, 90). Ky ajet përmbledh kodin e plotë të jetës morale, ku besimi dhe veprimi janë të pandarë.

Turpi, po ashtu është pjesë e pa ndashme e besimit në Islam. Kuranin e gjejmë të ndërlidhë konceptin e turpit me pastërtinë shpirtërore dhe ndershmërinë, si në tregimin e vajzës së Shuajbit që foli me Musain me ndrojtje: “Njëra prej tyre erdhi tek ai duke ecur me turp.” (El Kasas, 25). Ky shembull tregon se turpi është shenjë e moralit të lartë dhe e karakterit të pastër. Turpi nuk është dobësi, por forcë morale, që e mbron njeriun nga devijimet dhe nga mëkatet. Kështu, në Kuranin fisnik dhe në mësimin profetik, turpi dhe morali janë dy koncepte të ndërthurura, njëri është ndjenja, tjetri veprimi; njëri rrënja, tjetri fryti i besimit të sinqertë. Pa turp nuk ka moral, dhe pa moral, turpi bëhet i pakuptimtë.

Dijetari i mirënjohur, që jetoi në shek. V hixhri, El Maverdi, në librin e tij “*Edebu Dunja ve Din*”, ka përmendur se turpi te njeriu është i ndarë në tri lloje:

Turpi nga Allahu i Lartësuar – Ky është turpi më fisnik dhe më i rëndësishëm. Ai qëndron në zbatimin e urdhrave të Tij dhe përmbajtjen nga ndalesat e Tij. Maverdiu rrëfen se e kishte parë në ëndërr të Dërguarin e Allahut a.s. dhe i kishte thënë: “O i Dërguari i Allahut, më këshillo!” Ai i kishte thënë: “Kij turp nga Allahu i Madhëruar me turpin që i takon.” Pastaj kishte shtuar: “Njerëzit janë ndryshuar!” Maverdiu e pyeti: “Si është kjo, O i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Dikur e shikoja fëmijën dhe shihja në fytyrën e tij dritë dhe turp, kurse sot e shoh dhe nuk e gjej më këtë ndjenjë në fytyrën e tij.”

Turpi nga njerëzit – Ky lloj tregon mirësjelljen dhe moralin e lartë, që shfaqet përmes largimit nga ofendimi dhe mosshfaqja e së keqes në publik. Ky lloj turpi është shenjë burrërie, si dhe edukatë e dëshirë për reputacion të mirë.

Turpi nga vetvetja – Ky është turpi i brendshëm, që lind nga ndershmëria dhe ruajtja e vetes në vetmi. Një prej dijetarëve ka thënë: “Kij më shumë turp nga vetja jote sesa nga njerëzit e tjerë.” Ndërsa një tjetër ka thënë: “Kush bën fshehurazi atë që do të turpërohej ta bënte hapur, ai nuk e vlerëson veten e tij.” Ky lloj turpi është pasqyrë e pastërtisë së shpirtit dhe fisnikërisë së brendshme.

Në përfundim, kur njeriu arrin t’i plotësojë këto tri lloje të turpit, atëherë në të janë bashkuar të gjitha shkaqet e mirësisë dhe janë zhdukur të gjitha shkaqet e së keqes. Ai bëhet i njohur për virtyt dhe përmendet për vepra të bukura.⁴ Pejgamberi a.s., ka thënë: “Lëre, sepse turpi është nga besimi.”⁵ Ibën Kutajbe ka thënë: “Kuptimi i hadithit është se turpi e ndalon njeriun nga mëkatet, ashtu siç e ndalon imani, prandaj është quajtur ‘besim’, sepse qëndron në vend të tij.”⁶

Kurani fisnik, në suren El Araf, e ka shprehur ndjenjën e turpit (el-haja) me termin “veshja e devotshmërisë”, siç thuhet në fjalën e Allahut të Lartësuar: “O bijtë e Ademit! Ne ju kemi zbritur veshje për t’ju mbuluar pjesët tuaja të turpit dhe për zbukurim, por veshja e devotshmërisë është më e mira.” (El Araf, 26). Imam Ebu Hamid el Gazaliu, ka thënë: “Veshja e devotshmërisë” do të thotë turpi.”⁷

Pra, sipas Gazaliut, turpi është veshja shpirtërore që mbulon mangësitë e njeriut dhe e ruan atë nga mëkati, dhe nga sjellja e pahijshme, që nuk përshtatet me etiken islame, ashtu siç e mbulojnë rrobat trupin fizikisht.

Edhe këtu në këtë ajet, turpi është përmendur me një sinonim tjetër. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata fshihi (turpërohen) prej njerëzve, e nuk turpërohen prej Allahut.” (En Nisa, 108).

Me këtë sinonim i është drejtuar edhe Pejgamberit a.s.: “...dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh Allahut.” (El Ahzab, 37). Pra, po ki turp nga njerëzit.⁸

Turpi është mënyrë jetese. Pejgamberi a.s. e ka bërë turpin një mënyrë jetese dhe një kriter me të cilin njeriu i rregullon veprat dhe sjelljet e tij. Ebu Mesud el Ensarij el Bedriju r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Një nga fjalët e profetësisë së hershme që njerëzit i kanë trashëguar është: ‘Nëse nuk të vjen turp, bëj ç’të duash.’” (Transmeton Buhariu).

Ky hadith përmbledh disa kuptime të rëndësishme, ndër to: Ai të cilit i është hequr turpi, nuk i intereson se çfarë bën: hallall apo

“Një nga fjalët e profetësisë së hershme që njerëzit i kanë trashëguar është: Nëse nuk të vjen turp, bëj ç’të duash.” (Transmeton Buhariu).

haram, mirë apo keq, a është vepra e nderhme apo e ulët, sepse ai nuk ka turp nga Allahu dhe nuk i jep asnjë vlerë mendimit të njerëzve. Një i tillë është i guximshëm në veprat e neveritshme dhe i prirë drejt mangësive.

Nëse duam një shoqëri të shëndetshme që personaliteti i qytetarëve të udhëhiqet nga karakteri, e jo nga ligji, atëherë çdonjëri nga ne duhet të kemi karakter të pastër dhe ndërgjegje të dëlirë. Dhe, për t'u arritur kjo, duhet të nisemi nga vetja, nga edukimi i zemrës me turp dhe moral, përndryshe çdo reformë që nuk fillon nga shpirti le për të dëshiruar apo është e dënuar të dështoj. Këto të dyja, *"turpi dhe morali"*, kur bashkohen, krijojnë njeriun që më tepër udhëhiqet nga to se sa nga ligji.

Në një botë që njeriu vrapon pas formës dhe harron përmbajtjen, atëherë telashet e saj nuk kanë të përfunduar, ato presin zgjidhje vetëm nga ligji. Kurani famëlartë na kujton se bukuria më e madhe është bukuria e shpirtit. Dhe kjo bukuri lind nga turpi, rritet me moralin dhe përmbillet me dashurinë për Zotin dhe krijesat e Tij. Në lidhje me këtë, Allahu thotë: *"Vërtet, ai që e pastron shpirtin, ka shpëtuar, dhe ai që e ndot, ka humbur."* (Esh Shems, 9-10).

Kështu, turpi dhe morali mbeten dy fenerë të përzetshëm në udhën e njeriut që kërkon dritën.

Për komentin e këtij ajeti, Imam Ahmed ibën Omeri, ka thënë: *"Ka shpëtuar ai që e ka pastruar (shpirtin e vet)"* (Esh Shems, 9), pra, kush e pastron veten nga cilësitë e ulëta që burojnë nga prirjet e errëta trupore, dhe e stolis atë me virtyte të mira që lindin nga forcat shpirtërore të ndriçuara.⁹

Ibën Kethiri, gjatë tefsirit të këtij ajeti, ka thënë: *"Kuptimi i mundshëm i këtij ajeti është se: ka shpëtuar ai që e ka pastruar veten e tij, pra, duke iu bindur Allahut, ashtu siç ka thënë Katadeh, dhe duke e pastruar atë nga moralet e ulëta dhe veset e këqija. Një kuptim i ngjashëm përcillet nga Muxhahidi, Ikrimë dhe Seid ibën Xhubejri. Ky kuptim përforcohet edhe nga fjala e Allahut në suren El Ala, ajetet: 14–15: "Ka shpëtuar ai që është pastruar (nga mëkati), që ka përmendur emrin e Zotit të tij dhe ka falur namaz."*¹⁰ Në anën e adhurimeve, të cilat janë ligjësuar në Islam dhe konsiderohen shtylla të besimit, siç thotë shejh Muhamed el Gazali, janë ato ushtrime të përsëritura për ta mësuar njeriun të jetojë me morale të drejta dhe të qëndrojë i palëkundur në këto vlera, pavarësisht se si ndryshojnë rrethanat përreth tij.¹¹

Morali në Islam nuk bazohet në teori ideologjike, në interesa personale apo në faktorë mjedisorë, që ndryshojnë sipas rrethanave. Ai buron nga burimi i besimit, drita e të cilit ndriçon brenda shpirtit dhe jashtë tij. Morali nuk është një grup virtytesh të ndara nga njëra-tjetra, por unaza të lidhura të një zinxhiri të vetëm: besimi është moral dhe ligji hyjnor është moral; nëse myslimani e shkel njërën prej tyre, ai ka dëmtuar vetë besimin e tij.



Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Kur mëkatari bën amoralitet, ai nuk është besimtar në atë çast; kur pi alkool, nuk është besimtar; dhe kur vjedh, nuk është besimtar."* (Transmeton Buhariu).

Për fund, themi se Kurani famëlartë ka përmbledhur me një ajet anën praktike të moralit në Islam, kur thotë: *"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah Lindja ose Perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, Librit, lajmëtarëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të singertit dhe të tillët janë ata të devotshmit."* (El Bekare, 177).

1 Suhejb Abdulxhbar, *"El Xhamiul Sahih lis Suneni vel Mesanid"*, vëll. 9, f. 494.

2 Hadith muttefekun alejhi, i përcjellë nga Buhariu dhe Muslimi.

3 Transmeton Tirmidhiu, i cili ka thënë: hadith hasen sahih.

4 El Maverdi, Ali ibën Muhamed ibën Muhamed (v450h), *Edebu Dunja ve Din*, (Meltebetul Hajajt, 1986), f. 248-250.

5 *Sahihul Buhari*, Elhajau minel Ijman, nr. 23.

6 El Kadi, Husejn ibën Muhamed el Mehdi, *Sajdul efkari fil Edebi vel Ahlaki vel Hikemi vel Emthal*, (Jemen: Vezaretu Thekafu, Darul Kitab, 2009), vëll. 2, f. 91.

7 Ebu Hamid, Muhamed ibën Muhamed, (v505h), *Ihja' Ulum ed Din*, (Bejrut: Darul Mearifeti, 1987), vëll. 1, f. 5.

8 *El Muntaheb mine Tefasir*, Legjnet Kuran ve Sunne, (Kajro: Muesesetul Ahram, 1995), f. 628.

9 Nexhmudin, el Imam Ahmed ibën Omer, (v618h), *Et Tefsir el Ishari*, vëll. 5, f. 234.

10 Ibën Kethir, Ismail ibën Omer, (v774h), *Tefsirul Kurani Adhim*, (Bejrut: Darul Kutub el Ilmije, 1998), vëll. 8, f. 400.

11 Muhamed el Gazali, *Hulukul Muslim*, f. 7.

Amoraliteti si shkaktar i krizave dhe sëmundjeve shoqërore

Isa Tërshani

Islami, nëpërmjet ruajtjes së moralit dhe ndalimit të amoralitetit, synon realizimin e një stabiliteti shoqëror të përgjithshëm në të gjitha sferat. Kjo ngase amoraliteti është një sëmundje që nuk shkatërron vetëm moralin, por edhe shëndetin, mirëqenien, raportet familjare, miqësore, si dhe ato shoqërore. Një ndër karakteristikat e shoqërisë së vërtetë myslimane është natyra sublime e marrëdhënieve ndërmjet individëve, që ndërtohen mbi dashurinë, mëshirën, mbështetjen e ndërsjellë, vëllazërinë dhe sinqeritetin.

Në shoqërinë islame, qëllimi i jetës është zhvillimi dhe avancimi i saj për hir të Allahut xh.sh., duke kërkuar kështu kënaqësinë e Tij. Kjo i shtynë njerëzit të kenë ambicie të larta përtej interesave individuale të përkohshme. Ndërsa, shoqëritë perëndimore materialiste, në të cilat dominon interesi personal dhe konkurrenca klasore, kanë mungesë në dashuri, mëshirë dhe lidhje vëllazërore, vlera që janë themelore në shoqërinë islame. Kjo është vetëm një pikë uji në oqeanin e moralit, edukatës dhe traditave, që e dallojnë shoqërinë myslimane nga shoqëritë e tjera.¹ Detyra e shoqërisë myslimane është shtimi dhe përhapja e traditave, zakoneve dhe edukatës islame; edukimi i brezave të rinj me këto vlera;

Amoraliteti, me të gjitha format e tij si: korrupsioni, imoraliteti seksual, gënjeshtria, mashtrimi, padrejtësia, prishja e marrëdhënieve familjare, është burim i sëmundjeve të rënda shoqërore, që e shkatërrojnë strukturën morale të një shoqërie.

si dhe përdorimi i mediave, artit, letërsisë dhe ligjëratave për promovimin e moralit të mirë.

Vlerat morale islame janë të larta, ato janë të gjitha të zbatueshme, sepse i përgjigjen natyrshmërisë së shëndoshë njerëzore. Të gjitha ato vlera, janë praktikuar në faza të ndryshme në historinë e Islamit dhe myslimanëve, duke ndërtuar shoqëri të vërtetshme në historinë e Islamit. Përkundër prapambeturisë, dobësisë dhe ndarjes që e kanë prekur ymetin islam, shumica e këtyre vërteteve dhe moraleve ende janë të pranishme.

Shoqëria islame, përmes ligjeve dhe legjislacionit, ka për obligim të mbrojë këto zakone dhe morale nga çdo formë devijimi, sepse devijimet morale në shoqëri kanë pasoja shumëdimensionale. Allahu i Lartësuar e përshkruan qartë lidhjen midis mëkateve dhe pasojave të tyre shoqërore duke na thënë: “Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë.”²

Ky ajet thekson se çdo krizë e përhapur në shoqëri i ka rrënjët në devijimet morale të vetë njerëzve. Amoraliteti, me të gjitha format e tij si: korrupsioni, imoraliteti seksual, gënjeshtria, mashtrimi, padrejtësia, prishja e marrëdhënieve familjare, është burim i sëmundjeve të rënda shoqërore, që e

shkatërrojnë strukturën morale të një shoqërie. Kur këto përhapen, ato krijojnë krizë morale që shpie në sëmundje shoqërore.

KUPTIMI I AMORALITETIT DHE FORMAT E TIJ

Amoraliteti është vepër e turpshme, njollosëse, e cila njeriun e privon nga qetësia shpirtërore, gjë të cilën e përjeton vetëm ai që ka shpirt (moral) të pastër.³ Fjala “*amoralitet*” nënkupton çdo sjellje që bie ndesh me parimet e moralit të shëndoshë dhe normat e ligjit hyjnor. Edhe në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe kuptimet janë të njëjta.⁴ Në Islam, morali nuk është thjesht një çështje kulturore, por pjesë e besimit-fesë. Pejgamberi a.s., ka thënë: “Unë jam dërguar për ta përsosur moralin e mirë.”⁵

AMORALITETI – BURIM I KRIZAVE SHOQËRORE

Për të siguruar një stabilitet, ligjet hyjnore mbrojnë të drejtat themelore të të gjithë njerëzve. Ata që përhapin çrregullime në tokë ndëshkohen. Një ndër mëkatet më të rënda dhe rreptësisht të ndaluara, sipas Islamit, është prostitucioni. Si i tillë bie në kategorinë e mëkateve të mëdha (kebair). Prostitucion (ar. zina), llogaritet çdo marrëdhënie seksuale e paligjshme ndërmjet mashkullit dhe femrës jashtë aktit martesor, pa kurorë (nikah), pa marrë parasysh motivet, rrethanat dhe mundësitë në të cilat është kryer një marrëdhënie e tillë. Në këtë kategori hynë gjithashtu edhe marrëdhëniet e pazakonshme dhe e pamoralshme në mes gjinisë së njëjtë, qoftë ndërmjet meshkujve ose ndërmjet femrave. Qëndrimi i Islamit ndaj prostitucionit është i qartë dhe kategorik: “*Dhe mos iu afroni imoralitetit (zināsë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.*”⁶

Nga këto fjalë të Zotit të Madhëruar, qartë dhe fuqishëm kuptojmë për ndalesën e aktit të turpshëm dhe pasojat e tij të dëmshme që prostitucioni i bartë me vete.⁷ Kjo ndalesë përfshin çdo rrugë që mund të afrojë drejt mëkatit, qoftë fjalë, sjellje, shikim të ndaluar, veshje të rrobave transparente dhe provokuese, apo edhe shfaqje e pjesëve të ndaluara të trupit.

INSTINKTI NATYROR DHE QËNDRIMI I ISLAMIT

Islami e njeh ekzistencën e dëshirave natyrore dhe prirjen ndaj gjinisë së kundërt. Kjo dëshirë është njëra ndër pasionet më të forta dhe ndër faktorët e natyrshëm të njeriut. Këto gjëra janë të njohura, për të cilat mendojmë se nuk ka nevojë shumë të flitet. Mirëpo, problemi qëndron në atë se si ato epshe natyrore, për gjininë tjetër të kuptohen, si të dirigjohen, dhe si t'i menaxhosh ato. Në lidhje me këtë çështje janë marrë dhe kanë kërkuar zgjidhje pasuesit e librave të shpallura dhe besimet e ndryshme. Të gjithë kanë dhënë mendime dhe



zgjidhje të ndryshme. Disa përmes shtypjes së dëshirave dhe drejt murgërisë, e disa në skajin tjetër, të lirisë së pakufizuar epshore.

Islami e merr mesin, qëndrimin më të matur. Ai nuk i konsideron si të turpshme dëshirat e natyrshme të njeriut karshi gjinisë tjetër, së këndejmi edhe nuk e konsideron si virtut largimin nga martesja, por e favorizon, e porosit dhe e lavdëron atë. Në anën tjetër, nuk e lejon shfrenimin e pakufizuar në plotësimin e dëshirave dhe instinkteve epshore të njeriut. Sipas Islamit, lakmitë, prirjet dhe instinktet e njeriut nuk duhet të përbuzen dhe të ngulfaten, por duhet kuptuar drejt dhe të shfrytëzohen ashtu si i ka hije, por, asnjëherë të mos iu jepet liri absolute dhe hov (vrull) i pakontrolluar dhe i pakufizuar. Kjo mënyrë e zgjidhjes së kësaj çështje, jetës intime të njerëzve, përqendrohet në institucionin e martesës (kurorëzimit), që nënkupton vetëm përmes rrugës legale, rrugës së drejtë islame të martesës. Myslimani dhe myslimaneja mund ta rregullojnë jetën e tyre intime (seksuale), duke i plotësuar dëshirat gjithmonë vetëm përmes aktit martesor. Pa martesë të drejtë askush nuk guxon të ketë marrëdhënie intime.⁸ Ky është qëndrimi i drejtë dhe i matur i Islamit.

SHEMBULLI I TË RIUT QË KËRKOI LEJE PËR ZINA

Muhamedi a.s., për t'i mbyllur rrugët që shpien në imoralitet, tregonte rreziqet dhe pasojat shumëdimensionale, si në aspektin e besimit, të shëndetit, të familjes dhe të shoqërisë. Ai ka thënë: “O ju rini, ai që i ka mundësitë, le të martohet. Ndërkaq, ai që nuk i ka mundësitë, le të agjërojë, sepse agjërimi ia shuan epshin.”⁹ Pejgamberi a.s., e vë në dukje martesën si masën më të rëndësishme për ta parandaluar zinanë. Ai gjithashtu na ka treguar për rrezikun e zinasë duke thënë: “Nuk ndodh që zinaqari të jetë besimtar teksa bënë zina...”¹⁰

Lidhja e drejtpërdrejtë që i bëhet në hadith marrëdhënies jo legjitime me besimin, padyshim tregon se sa mëkat i madh është kjo vepër e shëmtuar. Do ta përmendim një rast të çuditshëm kur një i ri kishte ardhur te Pejgamberi a.s., për t'i kërkuar një leje tejet interesante. Shokët që ishin të pranishëm menjëherë reagon duke i thënë: “*Hesht, hesht!*”. Ky i ri dëshironte që për të, të bëhej një përjashtim, rregulli për ndalimin e prostitucionit të mos vlente për të. Kërkesa e tij nuk u trajtua nga aspekti banal i saj, por nga rreziku që mund të paraqiste dukuria e shthurjes morale. Si ta ndalë Muhamedi a.s., këtë të ri?! Çfarë është ajo që do të mund ta largonte prej këtij mëkati për të mos iu kthyer më kurrë?! Shikoni, poenta nuk është largimi nga mëkati aty për aty, e për t'i u kthyer më pas, ngase ka njerëz që turpërohen por nuk binden, kështu që në vetmi bëjnë mëkate të mëdha. Pejgamberi a.s., e afroi dhe me butësi dhe moral të lartë i tha: “*A do të doje një gjë të tillë për nënën tënde?*” “Jo”, iu përgjigj, “*Po me motrën, vajzën, tezen, hallën tënde?*” “Jo, o i Dërguari i Allahut!” Pejgamberi a.s., i tha: “*Po kështu edhe njerëzit nuk e duan një gjë të tillë për nënat, vajzat, motrat, tezet dhe hallat e tyre.*” Pejgamberi a.s., vendosi dorën e tij në kokën e të riut dhe u lut: “*O Zot! Falja mëkatet, pastroja zemrën nga të këqijat dhe ruaja nderin e tij.*”¹¹ Transmetuesi i kësaj ngjarje thotë se, që atëherë ai djalosh kurrë më nuk iu drejtua një vepre të tillë.

I riu, si pasojë e trysnisë së dëndur epshore, i kërkoi leje të Dërguarit të Allahut për marrëdhënie të jashtëligjshme. Muhamedi

Amoraliteti është vepër, e cila sjellë dëme të mëdha si në familje ashtu edhe në shoqëri. Kjo sjellje joetike, i hap rrugën humbjes së botëkuptimit dhe përçarjes familjare, humbjes së paqes mes anëtarëve të familjes, rritjes së numrit të fëmijëve problematik me prejardhje të panjohur dhe të rritur pa dhembshuri prindërore dhe pa edukim dhe përkujdesje.

a.s., i kuptoi ndjenjat e tij, pa e qortuar dhe pa e fyer atë, e uli pranë tij dhe duke i parashtruar pyetjet, ia bëri të qartë se sa gabim është që, një punë që nuk e dëshiron për vete, t'ia dëshirosh tjetërkujt.

PARALAJMËRIMI I PEJGAMBERIT A.S., PËR SËMUNDJET SHOQËRORE SI PASOJË E AMORALITETIT

Muhamedi a.s., na ka paralajmëruar qysh herët për rrezikun e degjenerimit moral. Ai a.s., një ditë, u afrua pranë muhaxhirëve që ishin të ulur dhe u tha se ishte i shqetësuar për pesë gjëra me të cilat ata mund të sprovoheshin. Njëra prej tyre ishte edhe shfaqja e sëmundjeve dhe epidemive të panjohura më parë nga etërit e tyre, në rast se zinaja do të përhapet aq sa kryhet haptazi, duke thënë: “Kur imoraliteti të hapet në mesin e njerëzve dhe njerëzit e bëjnë atë haptas, Allahu do të dërgojë një murtajë dhe sëmundje që nuk ka qenë e njohur më parë te paraardhësit e tyre.”¹²

Ky është paralajmërim për pasojat e dëmshme të prostitucionit, që janë të shumëfishta, jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë shëndetësor, moral, familjar dhe shoqëror.

Prostitucioni (zinaja) është shkak dhe burim i sëmundjeve (veneriane) të rrezikshme si: Sifilisi, Gonorea (triperi), Herpesi (urdhja), dhe SIDA (HIV/AIDS).

Këto sëmundje janë të tmerrshme, infektive, perfide dhe të cilat barten përmes marrëdhënieve jolegjitime-kontaktimit.¹³ Është fakt se sot në botë, sidomos në vendet e zhvilluara, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca dhe Gjermania, përkundër mjekësisë së zhvilluar, lëngojnë me qindra mija njerëz, meshkuj dhe femra.

Sëmundja e kësaj kohe, SIDA (HIV/AIDS), është sëmundje që nganjëherë përshkruhet si “epidemi globale”. Ajo është bërë fenomen frikësues, që ka përhapur frikë në mesin e njerëzve që nga viti 1981. Kjo sëmundje është përhapur në formë të epidemisë dhe është vështirë të kontrollohet ose të gjendet ilaç për të. Kombet e Bashkuara kanë raportuar se 2.8 milionë njerëz kanë vdekur nga kjo sëmundje në vitin 2002. Dhe sipas statistikave zyrtare, deri më tani, nga kjo sëmundje kanë vdekur



44.1 milionë njerëz. Në ShBA, Sida konsiderohet shkaktari numër dy i vdekjes te të rinjtë.¹⁴

Kjo sëmundje, fatkeqësisht, ka zënë vend edhe në vendin tonë. Që nga fillimi i regjistrimit në vitin 1986 e deri më 2025, në Kosovë janë evidentuar gjithsej 234 raste me HIV/AIDS, ndërsa 53 persona kanë humbur jetën si pasojë e kësaj sëmundjeje. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka raportuar se nga 1 janari deri më 31 korrik 2025 janë regjistruar 19 raste të reja me HIV/AIDS, prej të cilave 16 raste janë meshkuj dhe 3 femra.¹⁵

PASOJAT FAMILJARE DHE SHOQËRORE TË AMORALITETIT

Amoraliteti është vepër, e cila sjellë dëme të mëdha si në familje ashtu edhe në shoqëri. Kjo sjellje joetike, i hap rrugën humbjes së botëkuptimit dhe përçarjes familjare, humbjes së paqes mes anëtarëve të familjes, rritjes së numrit të fëmijëve problematik me prejardhje të panjohur dhe të rritur pa dhembshuri prindërore dhe pa edukim dhe përkujdesje. Gjithashtu, amoraliteti shkakton prishjen e sistemit shoqëror, rritjen e ndjenjës së urrejtjes dhe neverisë në mes njerëzve, rritjen e konflikteve dhe të krimeve në shoqëri, prishjen e lidhjeve familjare, fqinjësore dhe shoqërore, tronditjen në themel të vlerave etike dhe shpirtërore në shoqëri, humbjen e nderit të femrës dhe të mashkullit dhe poshtërimitin e njeriut, duke e bërë atë rob të epsheve trupore.

Nga të gjitha këto pasoja dhe shumë të tjera, Islami synon t'i eliminojë devijimet siç janë prostitucioni, homoseksualizmi etj., dëmet dhe ndikimet negative të të cilave nuk mbarojnë së numëruari. Feja islame synon të ndërtojë individin dhe shoqërinë, duke e bërë të ditur se rruga e plotësimit të

nevojave dhe dëshirave seksuale, është bashkëjetesa legjitime, pra martesë. E ardhmja e njerëzimit varet nga familja, e cila ndërtohet mbi marrëdhëniet e shëndosha mes burrit dhe gruas. Familja është themeli i shoqërisë, dhe stabiliteti i saj është garanci për ardhmërinë e njerëzimit. Në fund, po e përfundoj këtë shkrim me lutjen e Pejgamberit a.s., që e bëri për të riun, i cili kërkoi leje për prostitucion: “Zoti ynë! Na i fal mëkatet, na pastro nga të këqijat dhe na e ruaj nderin tonë.” Amin!

- 1 Dr. Muhamed Ali el Hashimi, *Shoqëria ideale*, (Prishtinë, 2008), f. 425.
- 2 Esh Shura, 30.
- 3 Afif Abdul Fet-tah Tabbareh, *Shpirti i fesë islame*, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja mr. Driton Arifi. (Prishtinë 2020), f. 316.
- 4 **Amoral.** Që i mohon normat e moralit, që i mungojnë parimet morale. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Rilindja, Prishtinë, f. 29).
Imoral. Që sillet a vepron në kundërshtim me kërkesat e moralit, i pa moral, i pandershëm. Burrë (djalë, njeri) imoral. Grua imorale.
Imoralitet. Të qenët imoral; veprim a sjellje e pandershme, pandershmëri. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Rilindja, Prishtinë, f. 715).
- 5 Sahihu el Xhamiu, 2833.
- 6 El Isra, 32.
- 7 Kasim Dobraça, *Ruhu nga të këqijat*, (Prishtinë, 1990), f. 47.
- 8 Po aty, f. 51.
- 9 Sahihu i Buhariut, 5065, vëll. IV, Harfi, Prishtinë, 2024.
- 10 Buhariu, 5578.
- 11 Ahmedi, 22211.
- 12 Ibën Maxhe. 4019.
- 13 Kasim Dobraça, *Ruhu nga të këqijat*, (Prishtinë. 1990), f. 54.
- 14 Dr. Muhamed Ali el Hashimi, *Shoqëria ideale*, (Prishtinë, 2008), f. 440.
- 15 Gazeta online: Metro. 12.08.2025.



Besimi ndërmjet bashkëshortëve – çelës i jetës bashkëshortore

Artan Musliu

Jemi duke jetuar në një epokë të zhvillimit të teknologjisë. E tërë kjo ka bërë të mundur që mediat, rrjetet sociale dhe shoqëria në përgjithësi, të kenë një ndikim të madh në jetën individuale të secilit prej nesh, duke ndikuar kështu edhe në vetë rrjedhën dhe mënyrën e jetesës tonë. Andaj, sot çdo klikim në rrjetet sociale apo ekspozim ndaj mediave është e barabartë me qindra informacione të cilat, me apo pa dëshirë, me apo pa vetëdije, janë duke ndikuar në përditshmërinë tonë. E kjo ka bërë që, pa vetëdije, të orientohejmë dhe të marrim rrugë të panjohura dhe të papërshtatshme për shoqërinë tonë kosovare.

Gjurmët e epokës digjitale në jetën tonë individuale janë të pashmangshme, të thella dhe të parikuperueshme, në shumicën e rasteve. Një individ, mesatarisht, llogaritet se kalon rreth 2 orë e gjysmë në rrjetet sociale. E tërë kjo ndikon që mes bashkëshortëve të minimizohet komunikimi. Kjo, krijon një hendek dhe një mbyllje emocionale. Si pasojë e kësaj, bashkëshortët, duke u ndikuar edhe nga rrjetet sociale, fillojnë që të krijojnë jetë paralele. Pra, krahas jetës reale, ata krijojnë edhe një jetë imagjinare të imponuar nga

Bashkëshortët, duke u ndikuar edhe nga rrjetet sociale, fillojnë që të krijojnë jetë paralele. Pra, krahas jetës reale, ata krijojnë edhe një jetë imagjinare të imponuar nga rrjetet sociale.

rrjetet sociale. E që, si pasojë e kësaj krijohet një pasiguri në vetveten e tyre, por edhe ndaj partnerit. Kështu, fillon të zë fill mosbesimi dhe dyshimi në vetvete dhe ndaj partnerit. Kështu, bashkëshortët nuk arrijnë më që ta njohin njëri-tjetrin. Pra, bashkëshortët kthehen në persona të huaj për njëri-tjetrin.

Padyshim se, dyshimi dhe hamendja janë shkaktarët kryesorë të shumë të ligave dhe problemeve. Kjo ngase dyshimet janë ato që prodhojnë mendime negative, e këto mendime reflektojnë në veprimet tona. Pra, si rezultat i mendimeve negative, do të kemi edhe veprime në afekt, veprime të nxituara dhe, veprime për të cilat do të pendohemi përgjatë tërë jetës tonë.

Një ndikim i tillë, padyshim se ka ndikuar edhe në vetë jetën bashkëshortore në shoqërinë tonë. Andaj, si pasojë e kësaj, vetëm përgjatë këtij viti kemi rreth 600 raste të shkurorëzimit. Pra, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm gjatë periudhës janar – prill 2025, janë raportuar 528 raste të shkurorëzimit apo rreth 14% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



Po ashtu, një prej pasojave të tjera, që bota digjitale ka ndikuar në shtimin e divorceve është edhe analogjia apo krahasimi i jetës bashkëshortore me atë që shfaqet në rrjetet sociale. Bashkëshortët, duke u bazuar në atë që u shfaqet nëpër rrjetet sociale, fillojnë që të krijojnë jetën bashkëshortore imagjinare. E në momentin që kjo jetë imagjinare përballlet me jetën reale, atëherë vjen deri te zhgënjimi dhe thyerja e besimit në mes të bashkëshortëve. Kjo, pasi që, secili trajton tjetrin si një mashtrues, pasi që ka zhgënjyer pritshmërisë e tij/saj.

Padyshim se, e tërë kjo ka ndikim negativ dhe është në kundërshtim të plotë me parimet dhe mësimet fetare islame. Islami e sheh jetën bashkëshortore si një strehë paqeje, qetësie dhe sigurie për familjen. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: *“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”*²¹

Po ashtu, Allahu i Madhëruar thotë: *“Ai (Allahu) është Ai që ju krijoi prej një vete, e prej saj krijoi palën e saj për t’u qetësuar pranë saj.*

Rrjetet sociale dhe bota digjitale, sot është duke e bërë të kundërtën. Pra, është duke bërë që të nxjerrën sheshit të larat dhe të palarat e jetës bashkëshortore dhe, duke i krahasuar me të tjerët, të vije deri te një nxitje drejt divorcit.

*Kur e mbuloi ai (mashkulli) atë (gruan), ajo u ngarkua me një barrë të lehtë dhe ashtu vazhdoi me të, e kur u bë e rëndë, ata të dy lutën Allahun, Zotin e tyre: “Nëse na jep një (fëmijë) të mirë (pa të meta), ne do të jemi falënderues ndaj Teje.”*²²

Mirëpo, Islami nuk e përjashton mundësinë e gabimeve dhe të lëshimeve në jetën bashkëshortore. Pra, nuk e sheh martesën dhe as bashkëshortët si të përkryer, duke e mohuar mundësinë që mes tyre të ketë zhgënjim dhe thyerje të pritshmërisë karshi njëri-tjetrit. Islami, rastet e tilla i ka krahasuar me veshjen. Imagjino sikur në trupin tënd të kesh diçka që do e zbehte bukurinë tënde, atëherë, si do të veproje me të? A do e ekspozojë para të tjerëve me krenari dhe mburrje, apo do të mundohesh që ta mbaje të fshehtë?

Padyshim se, secili prej nesh do të mendohej që ta mbante të fshehtë dhe të mos e ekspozojë para të tjerëve. E po ashtu, edhe kur flet për jetën bashkëshortore, Allahu xh.sh., e krahason me rrobat apo veshmbathje. Pra, secili partner duhet që të ngjasojë me rrobat në mbulimin e të metave të tjetrit, në mbulimin e sekreteve bashkëshortore, në mbulimin e probleme dhe të keqkuptimeve mes tyre. Në



lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: *“Natën e agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. Allahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin tuaj dhe ua fali gabimin. Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkonit atë që ua ka caktuar Allahu dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje. E kur jeni të izoluar (në itikaf) në xhami, mos t’u afroheni atyre (për marrëdhënie intime). Këto janë dispozitat e Allahut, pra mos i kundërshtoni. Ja kështu, në këtë mënyrë Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e veta që ata të ruhen.”*³

Kështu, Allahu xh.sh. na tregon se bashkëshortët janë ata që duhet të mbulojnë njëri-tjetrin, si dhe ta mbulojnë jetën bashkëshortore. Rrjetet sociale dhe bota digitale, sot është duke e bërë të kundërtën. Pra, është duke bërë që të nxjerrën sheshit të larat dhe të palarat e jetës bashkëshortore dhe, duke i krahasuar me të tjerët, të vije deri te një nxitje drejt divorcit.

Në rast se bashkëshortët e njohin mirë njëri-tjetrin, kanë komunikim të shëndoshë në mes tyre, ata arrijnë që të kuptojnë se secili individ është unik për nga personaliteti, karakteri dhe mënyra e jetesës së tij. Po ashtu, nëse ata arrijnë që të kuptojnë se jeta e tyre u takon vetëm atyre, ajo karakterizohet me vend, rrethana dhe situata që e bëjnë të dallohet nga jeta e të tjerëve qoftë edhe e fqinjëve të parë, atëherë kjo do të ndikojë në sigurinë dhe besueshmërinë ndaj njëri-tjetrit. E kur besueshmëria ndërmjet tyre të jetë e shëndoshë dhe në nivelin e kërkuar, atëherë çdo sprovë, çdo sfidë dhe problem, të cilin mund ta hasin dhe të ballafaqohen me të përgjatë jetës së tyre bashkëshortore, do të jetë lehtë i kalueshëm dhe i menaxhuar.

Shembullin më të mirë, në mesin e shumë shembujve të tjerë, kemi shembullin e Hatixhes r.a. me Pejgamberin a.s.. Dhe atë, jo për diçka të vogël, por për vetë fillimin e shpalljes. Pra, Pejgamberi a.s. kishte zbritur nga shpella Hira me shpallje, ishte në një gjendje mjaft të rëndë emocionale dhe shpirtërore. Ai a.s., në momentin që arriti në shtëpi dhe e njoftoi bashkëshorten e tij, gjeti një mbështetje të jashtëzakonshme. Këtë e gjeti pa asnjë dyshim dhe pa asnjë hamendje nga Hatixheja r.a..

Hatixheja r.a., edhe pse e dinte mirë se ajo që kishte ndodhur do t’i kthente të gjithë kundër tyre, do t’i përballte ata me më të afërmit e tyre dhe, padyshim se ishte një fillim i një epoke të vështirë, besimi i saj në Pejgamberin a.s. si bashkëshort, e kishte bërë që të mposhte çdo gjë. E për t’i ofruar mbështetje, ngushëllim, qetësi dhe prehje bashkëshortore, Hatixheja r.a. ia përmend cilësitë më të bukura dhe më të veçanta të Pejgamberit a.s.. Ajo, me bindje të plotë, i tha: “Jo, për Zotin! Zoti yt, nuk do të të lë në baltë asnjëherë, sepse ti je ai që mban lidhjet familjare dhe fafërisnore, je i sinqertë dhe i besueshëm në fjalët tua, ndihmon nevojtarët, mirëpret mysafirët dhe, je ndihmëtar i së vërtetës dhe drejtësisë.”⁴

Po ashtu, ishte edhe besimi i të Dërguarit a.s., që kishte ndaj bashkëshortes së tij, ai që e kishte nxitur t’i tregon për ngjarjen e madhe, pra për fillimin e shpalljes. Pejgamberi a.s. posa arriti në shtëpi, pas pranimit të shpalljes, i kërkoi bashkëshortes së tij që ta mbulonte, ngase dridhej i tëri nga pesha e rënd e shpalljes. E pas kësaj, Pejgamberi a.s. i tregoi asaj për ngjarjen që i kishte ndodhur në shpellën Hira.⁵

Kështu që, kur dy bashkëshortët e njohin mirë njëri-tjetrin, kanë besim të plotë ndaj njëri-tjetrit, atëherë ata sigurisht se do të jenë të hapur ndaj njëri-tjetrit. E kjo do t’ua mundësoj që t’i shprehin emocionet, t’i shprehin ëndrrat, dëshirat, problemet dhe çdo gjë tjetër. Po ashtu, besimi i ndërsjellë do t’ua mundësoj atyre që të besojnë në përpjekjen e tyre për të bërë më të mirën e mundshme për ruajtjen e jetesës bashkëshortore, do t’i bëjë të besojnë në pamundësinë e realizimit dhe plotësimit të ndonjë dëshire apo kërkesë eventuale ndaj njëri-tjetrit.

Thjesht, besimi ndërmjet partnerëve është çelësi i stabilitetit dhe garancisë së jetesës bashkëshortore.


1 Er Rum, 21.

2 El Araf, 189.

3 El Bekare, 187.

4 Këtë transmetim e shënon Imam Buhariu në Sahihun e tij. Transmetimi është prej Aishes r.a.. Shih transmetimin numër 6982.

5 Këtë transmetim e shënon Imam Buhariu në Sahihun e tij. Transmetimi është prej Aishes r.a.. Shih transmetimin numër 4953.



Ekulibri riprodhues në perspektivën islame

Fitim Flugaj

Kufizimi i lindjes së fëmijëve është i rregulluar me parime të qarta dhe standarde të jurisprudencës islame, ndërsa kontrolli i lindjes mbetet gjithmonë nën vlerësimin e motiveve dhe nevojave të individëve myslimanë. Çdo vendim, gjykohet sipas ndërgjegjes së pastër dhe sinqeritetit të besimit.

Islami e cilëson kontrollin e lindjeve në kontekstin se ai është një formë e ushtrimit të lirisë personale me standardet e besimit, siç thotë Zoti i Madhëruar: *“Gratë tuaja janë vendmbjellja juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por përgatitni për veten tuaj, dhe kini frikë Allahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepu myzhde (përgëzoni ata).”* (El Bekare, 223).

Islami rezervon kontrollin e lindjes për hir të vuajtjes së gruas nga shtatzënitë e shumëfishta ose ekspozimit të saj ndaj vdekjes dhe rrethanave të tjera urgjente personale, që nuk janë të përcaktuara me ligj, por janë të përcaktuara nga rastësia e ndërgjegjes së besimit. Përmes kësaj, ne shohim se Islami nuk bëhet pengesë në rrugën e zhvillimit sasior pa u shqetësuar për shëndetin njerëzor dhe mbështet plotësisht zhvillimin e shëndetit, i cili përfshin atë fizik dhe mendor, pjekurinë intelektuale, lëvizshmërinë ekonomike në familje dhe fuqinë ekonomike të shoqërisë.

Është një gabim i zakonshëm që rritja ose shtimi i shpejtë i popullsisë të konsiderohet absolutisht i dëmshëm, sidomos kur dihet që kemi nevojë për rritjen e numrit të banorëve në proporcion me shtimin e burimeve të mjaftueshme dhe mundësitë e shfrytëzimit të tyre. Është e vërtetë se ka vende në të cilat rritja mund të çojë në efekte negative për shkak të mungesës së burimeve, por kjo nuk është normë. Ajo që është

e rëndësishme në këtë rast është të kontrollohet shkalla e rritjes që i përshtatet rrethanave të vendit dhe të mos e neglizhojmë planifikimin familjar si koncept në tërësi, por me kusht që kjo të mos shpie deri te zvogëlimi i numrit të myslimanëve.

Për ta mbështetur zhvillimin cilësor, Islami është kthyer në një sistem rregullues të riprodhimit. Ai këtë rend të përkryer e vendos duke filluar me kërkesën e tij për ushqyerjen e plotë me gjirin e nënës për dy vjet. Zoti i Madhëruar thotë: *“Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t’u japin gji fëmijëve të vet dy vjet të plota.”* (El Bekare, 233).

Në këtë ajet fisnik, vërejmë se i referohet lejes së Zotit të Madhëruar që gruaja t’i ushqej pasardhësit e saj për një periudhë të plotë dyvjeçare. Kjo në fakt është një dhuratë nga





Zoti i Madhëruar për të, në të cilën ajo nuk ka nevojë të kërkojë leje nga askush. Në një formë a tjetër, anasjelltas ky ajet kuranor krijon një mundësi për planifikim familjar, sepse dy vitet e gjidhënies i japin hapësirë (ndonëse jo domosdoshmërisht) nënës që të pushojë nga lindja përafërsisht tri vjet, duke marrë parasysh që kur të përfundojë gjidhënia dyvjeçare të fillojë shtatzëninë e re, e cila si zakonisht zgjatë nëntë muaj (2 vjet gjidhënie + 9 muaj shtatzëni = 2 vjet e 9 muaj pushim). Kjo nuk nënkupton se gjatë kohës së gjidhënies së saj ajo s'mund të mbesë shtatzënë, por që për shëndetin e saj, ndoshta i sugjerohet që të ketë përkushtim të veçantë për secilin fëmijë.

Në këtë kontekst, në kuadër të planifikimit familjar, vërejmë gjithashtu se ligji islam i lejon masat kontrceptive gjatë marrëdhënieve intime (që të mos mbetet gruaja me barrë), sidomos kur fëmija është krejtësisht i varur nga gjidhënia ose siç u potencua më lartë, kur rrezikohet shëndeti dhe jeta e nënës. Në hadithet autentike thuhej se sahabët praktikonin ejakulimin jashtë organit gjenital (mënyrën klasike kontrceptive ose ejakulimi parandalues-preventive ejaculation). Lidhur me këtë Sufjani ka thënë: “Ne izolohehim-

bënim ejakulim parandalues ndërsa Kurani ishte duke zbritur.”¹ Ndërsa Xhabir bin Abdallahu r.a., ka thënë se, po të ishte e ndaluar, Kurani do të na kishte ndaluar prej tij. Në një transmetim, kjo i është transmetuar Pejgamberit, por ai nuk na ka ndaluar ta bëjmë këtë.²

Lidhur me këtë çështje, shtrohet një debat juridik i cili përfundon me vendimin se, ky veprim është i pa preferuar – mekruh, si një vendim arbitrar në mes të lejuarës dhe të ndaluarës kur nuk bëhet me pëlqimin dy bashkëshortëve.

Izolimi-ejakulimi parandalues është një lloj i metodave tradicionale të kontrollit të lindjes, dhe për analogji me izolimin, lejohet që gruaja të përdorë metoda moderne të planifikimit familjar, që janë të garantuara për shëndetin e nënës dhe të cilat metoda përcaktojnë dhe i përshkruajnë gruas se cilat metoda të kontrollit të shtatzënisë janë të përshtatshme për trupin e saj.

Përndryshe, po e përsërisim se, vetëm çështjet shëndetësore mund të jenë shkaktar për izolim dhe kontroll të lindjes dhe kurrësi ato ekonomike.

Por, ajo që po ndodh te ne, në vendin tonë është mjeruese. Ja p.sh., në regjistrimet e vitit 2024, të cilat kanë qenë të parapara të përfundojnë në fund të muajit gusht, e që në

rezultatet preliminare ku ende nuk kishte përfunduar regjistrimi i plotë, sidomos i diasporës, na dalin këto rezultate: Në Kosovë janë ose jetojnë 1 milionë e 586 mijë e 659 (1,586,659)) banorë. Në nëntë komuna ka pasur rritje të numrit të popullsisë e në 29 të tjera, ulje të numrit të banorëve.

Rritje e moshës mesatare të popullsisë për 4.85 vjet. Mosha mesatare 34.82 vjet. Dominon popullsia e grupmoshave 20-24 vjeç. Dominon popullsia 16-64 vjeç, rënie e moshave 0-15 vjeç dhe rritje e moshave mbi 65.

Në regjistrimin e fundit në vitin 2011 numri i banorëve ishte 1,739,825.

Duke analizuar faktet, vërejmë se, deri pas luftës, saktësisht deri në vitin 2000, Kosova kishte mbi dy milionë banorë, kryesisht shqiptar, ndërsa sot, Kosova ka rënie të theksueshme në numrin e banorëve.

Për shembull, në vitin 2004, Kosova numëronte 1,766,068 banorë dhe kishte 35,063 lindje,³ ndërsa në vitin 2024, që do të thotë pas njëzet vjetësh, Kosova numëron vetëm 1,586,659 dhe vitin e kaluar 2023 brenda dhe jashtë Kosovës sipas ASK-së (Agjencisë së Statistikave të Kosovës), nga të dhënat e marra nga Regjistri Civil i Kosovës, gjegjësisht Zyrat e Gjendjeve Civile, në vitin

Ligji islam i lejon masat kontrceptive gjatë marrëdhënieve intime (që të mos mbetet gruaja me barrë), sidomos kur fëmija është krejtësisht i varur nga gjidhënia ose siç u potencua më lartë, kur rrezikohet shëndeti dhe jeta e nënës.

2023, vetëm në Kosovë janë 21 mijë e 654 lindje, ndërsa janë regjistruar 31 mijë 110 lindje brenda dhe jashtë Kosovës.⁴

Të gjitha këto të dhëna flasin për rënie të numrit të lindjeve.

Kur i kthehemi shëndetit riprodhues në Kosovë, i cili rrezikohet mjaft shumë nga sëmundje dhe probleme të ndryshme shëndetësore, Kosova ka aprovuar Ligjin për Shëndetin Riprodhues.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 1 maj 2008, ka miratuar Ligjin për Shëndetin Riprodhues, përmes të cilit rregullohet organizimi, funksionimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore, dhe i cili mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit, duke përfshirë të drejtën për t'u informuar dhe për të pasur qasje në shërbime të duhura. Sipas dispozitave të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë ka në kompetencë të organizojë dhe koordinojë veprimtaritë në këto fusha të shëndetit seksual dhe riprodhues: të sigurojë të drejtën riprodhuese; të sigurojë për informimin, edukimin dhe këshillimin mbi shëndetin seksual dhe riprodhues përgjatë gjithë ciklit jetësor; të sigurojë amësinë e sigurt; të asistojë dhe të ofrojë këshilla për planifikimin e familjes; të marrë veprime për parandalimin dhe trajtimin e përshtatshëm të infertilitetit; të sigurojë ndërprerjen e sigurt të shtatzënisë; të ofrojë shërbimet për parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS-it, si dhe infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues; dhe të ndërmarrë veprime për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues dhe karcinomës së gjirit.⁵

Mirëpo, ky ligj nuk e garanton bërthamën ose celulën e shëndetit riprodhues, që është familja e shëndoshë, e cila krijohet nga martesë e mashkullit me femrën, respektivisht përbëhet nga nëna dhe babai, të cilët nëpërmjet shëndetit riprodhues sjellin në jetë fëmijët, dhe në këtë formë vazhdon rigjenerimi i qenies njerëzore.

Për fat të keq, ne sot hasim në pretendime dhe iniciativa të djallëzuara që synojnë

Në aspektin kombëtar, nëse vazhdojmë ta trasojmë traditën familjare, të bazuar në traditën edhe fetare edhe kombëtare, ne nuk e rrezikojmë kombin tonë dhe mund të konkurrojmë para popujve e kombeve të kjera me vlera të larta humane.

shkatërrimin e shëndetit riprodhues nëpërmjet ligjit të familjes që ka të bëjë me çështjen e martesës së gjinisë së njëjtë, të ashtuquajtur prindi 1 e prindi 2, një përpjekje e cila vazhdon ende në Parlamentin e Kosovës, në të cilin, të gjithë deputetët janë pjesëtarë të familjes së mirëfilltë, dhe të cilët nuk vijnë nga çerdhe të fëmijëve, që nuk u dihen prindërit dhe zanafilla familjare. Një gjë është shumë e çuditshme, sidomos kur shohim përfaqësues të një populli, që e shenjtëron familjen, të miratojë një akt ligjor, një ligj i cili e degeneron dhe e shkatërron familjen - bazën për zhvillimin e shëndetit riprodhues dhe rigjenerimit të vetë njeriut.

Lidhur me këtë temë ka të flitet edhe shumë. Por, mbi të gjitha themi me gojën plot se, feja islame nëpërmjet ligjeve dhe rregullave që burojnë nga Kurani dhe Suneti i Pejgamberit, mbetet garantuesi më i saktë, më i fuqishëm dhe më i kompletuar për një shëndet të mirëfilltë riprodhues, që e mbron nga çdo infektim (figurativisht) dhe sëmundje që e rrezikon atë.

Në aspektin kombëtar, nëse vazhdojmë ta trasojmë traditën familjare, të bazuar në traditën edhe fetare edhe kombëtare, ne nuk e rrezikojmë kombin tonë dhe mund të konkurrojmë para popujve e kombeve të kjera me vlera të larta humane.

E përmbylim me një pjesë të ajetit kuranor të theksuar më lartë që thotë: *“Kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër). E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kiametit do ta ringjall të verbër.”* (TaHa, 123-124).

1 <https://hadeethenc.com/ar/home> (Sahihu i Buhariut dhe Sahihu i Muslimit).

2 <https://hadeethenc.com/ar/home> (Sahihu i Buhariut dhe Sahihu i Muslimit).

3 https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Kosov%C3%ABs

4 <https://kallxo.com/lajm/agjencia-e-statistikave-tregon-se-sa-femije-u-linden-ne-kosove-gjate-2023/>

5 Vellimi-4-Numer-2-Revista-Mjeku-Shendeti-riprodhues.pdf



Mënyra se si bëhet rukuja

Dr. Ejup Haziri

Namazi ka rregulla dhe dispozita të caktuara. Namazfalësit nuk i lejohet që të falet si të dojë ai, por vetëm sipas rregullave të përcaktuara. Çdo pjesë e namazit i ka rregullat e veta. Edhe rukuja për të cilën do të flasim, i ka rregullat dhe kritetet e veta. Si ta bëjmë rukunë? Çfarë të themi në ruku? Si duhet të jenë gjymtyrët e trupit kur bëhet rukuja? Këto dhe çështje të tjera që ndërlidhen me rukunë, do të trajtohen brenda këtij punimi.

RËNIA NË RUKU DUKE SHQIPTUAR SINTAGMËN “ALLAHU EKBER”

Pas qëndrimit në këmbë (قيام), që është pjesë përbërëse e namazit (ركن) dhe leximit të Kuranit, bëhet rënia në ruku duke thënë “Allahu ekber”. Edhe rukuja, sikurse kijami-qëndrimi në këmbë është pjesë përbërëse -shtyllë e tij (ركن). Allahu i Madhërishëm thotë: “O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde...” (El Haxh, 77).

Rënia në ruku është obligim i domosdoshëm, gjegjësisht pjesë përbërëse e namazit, pa të cilën namazi nuk është në rregull, ndërsa shtrirja e duarve mbi gjunjë, lënia e gishtërinjve hapur, drejtimi i shpinës dhe kokës, dhe thënia e duave, gjegjësisht madhërimi që bëhet në ruku janë sunete të namazit,¹ ndonëse ka mendime se madhërimi në ruku është *rukun*, megjithatë këto mendime janë mendime që nuk kanë përfaqësim të madh te

fukahatë, dhe për më tepër shihen si mendime të izoluara.

Ibën Omeri dhe disa të tjerë janë të mendimit se nuk ka nevojë të shprehet sintagma “Allahu ekber” gjatë rënies në ruku dhe sexhde, megjithatë ky mendim nuk gjen përkrahje dhe mbështetës dhe mund të themi se mbetet si mendim jo i pranuar te fukahatë, për shkak se tekstet në këtë çështje janë të qarta dhe e vërtetojnë të kundërtën e këtij mendimi. Pastaj janë edhe sahabët e mëdhenj, sikurse: Omeri, Aliu, Abdullah ibën Mesudi dhe të tjerët, e shqiptonin sintagmën “Allahu ekber”, gjatë shkuarjes në ruku dhe sexhde,² gjegjësisht në çdo ulje dhe ngritje. Megjithatë kjo sintagmë nuk e ka tretmanin e njëjtë sikurse sintagma në fillim të namazit, gjegjësisht gjatë hyrjes në namaz.

Tirmidhiu, në koleksionin e tij përcjell hadithin e transmetuar nga Abdullah ibën Mesudi, në të cilin tekstualisht shprehet se i Dërguari i Allahut shqiptonte sintagmën “Allahu ekber” në çdo ulje, ngritje dhe rënie:

“I Dërguari i Allahut shqiptonte tekbin kur shkonte në ruku, ngrihej prej saj, kur ngrihej për (rekat) dhe kur ulej. Po kështu vepruan edhe Ebu Bekri dhe Omeri.”³

Hadithi në vijim që transmetohet nga Ebu Hurejre është më detajizues, sepse përshkruan më detajisht vendet në të cilat shqiptohet fjala “Allahu ekber”, në çdo ulje dhe rënie:

“I Dërguari i Allahut kur ngrihej për t’u falur shqiptonte fjalën “Allahu ekber”, pastaj

“I Dërguari i Allahut shqiptonte tekbin kur shkonte në ruku, ngrihej prej saj, kur ngrihej për (rekat) dhe kur ulej. Po kështu vepruan edhe Ebu Bekri dhe Omeri.”

kur shkonte në ruku shqiptonte gjithashtu tekbirin (Allahu ekber), më pas ngrihej nga rukuja dhe thoshte: “SemiAllahu limen hamideh”. Ai po ashtu thoshte përderisa ishte në këmbë: “Rabbena ve leke-l hamd”, e pastaj shqiptonte tekbirin dhe shkonte në sexhde. Ai po ashtu shqiptonte tekbirin kur e ngrinte kokën nga sexhdeja, e po kështu vepronte në tërë namazin derisa përfundonte. Gjithashtu shqiptonte tekbirin edhe kur ngrihej nga rekati i dytë, pas uljes.” Më pas Ebu Hurejre tha: “Unë po ua shëmbëllejë juve namazin e të Dërguarit të Allahut.”⁴

Janë të shumta hadithet që flasin për këtë tematikë, e që transmetohen nga sahabë të ndryshëm, ku përmbajtja thuajse është e njëjtë.

KOHA E RËNIES NË RUKU

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se koha e rënies në ruku është atëherë kur përfundon leximi i Kuranit. Kështu qëndron edhe në praktikë në të gjitha vendet e shtrirjes së Islamit. Mirëpo dijetarët kanë polemizuar se a lejohet të shkohet në ruku para përfundimit të leximit të Kuranit, si fjala vjen gjatë fjalës së fundit, apo edhe më tepër se një fjalë? Në këtë çështje janë të ndarë në dysh, ku shumica mendojnë se duhet të përfundohet leximi i Kuranit, e më pas të shkohet në ruku, ndonëse një pjesë e dijetarëve janë të mendimit se nuk ka të keqe nëse shkohet në ruku kur ka mbetur nga leximi i Kuranit një shkronjë apo edhe një fjalë. Madje, ka shumë imamë që gjatë faljes së tyre veprojnë kështu. Megjithatë mendimi i parë është më i fuqishëm, sepse leximi i Kuranit është bërë obligim gjatë qëndrimit në këmbë e jo në ruku.⁵

Një tjetër element në këtë tematikë është edhe sintagma “Allahu ekber” që shprehet për të shkuar në ruku, ku dijetarët kanë polemizuar se a duhet të shqiptohet ajo sintagmë në këmbë e më pas të shkohet në ruku, apo të shqiptohet gjersa shkohet në ruku. Disa kanë thënë se duhet të shqiptohet tekbiri në këmbë e më pas të shkohet në ruku, e disa të tjerë kanë thënë se shqiptohet tekbiri përgjatë shkuarjes në ruku, gjegjësisht fillohet të shqiptohet tekbiri atëherë kur fillohet të shkohet në ruku dhe përmbillet tekbiri atëherë kur je plotësisht në ruku.⁶ Shejbani në “*El Xhami’ es Sagir*” thotë: “E shqipton tekbirin duke shkuar në ruku.”

VENDOSJA E DUARVE MBI GJUNJË

Pasi të shqiptojmë sintagmën “Allahu ekber”, shkojmë në ruku, gjegjësisht përkulemi dhe dora e djathtë vendoset mbi gjurin e djathtë, përderisa e majta mbi gjurin e majtë. Gishtërinjtë e dorës mbesin të hapur, e jo të bashkuar.⁸ Në dhjetë pika ku dallon mënyra e të falurit të femrës nga mashkulli, dy dallime prej tyre janë në ruku (përderisa për dy dallimet të tjera kemi folur gjatë ngritjes së duarve në tekbirin fillestar dhe vënien e duarve për femrat mbi gjoks).



Te burrat, zakonisht duart duhet të jenë të hapura dhe të drejta, pa u kërrusur ato. Vendi i nënsqetullave te burrat duhet të jetë i hapur, gjersa te gratë preferohet të jetë sa më i mbyllur. Ndërsa dallimi tjetër është te duart e pozicionuara në ruku, ku burrat vendosin duart, gjegjësisht shuplakat e duarve të tyre mbi gjunjë, ndërsa gratë i vendosin duart mbi kofshët e tyre, ku gishtat e duarve të tyre arrijnë në gjunjë, e pjesa e duarve mbi kofshë.⁹

Autori i librit të njohur “*El Hidajeh*”, thotë: “Gishtërinjtë nuk preferohen të mbesin të hapur, përveç këtij rasti (rukusë), për shkak të përfshirjes së kapjes së gjurit, ndërsa në sexhde duhet të jenë të bashkuar, e jo të hapur. Ndërsa në vende të tjera, mbesin në formë të zakonshme.”¹⁰

Abdullah ibën Omeri na transmeton hadithin që flet për rukunë dhe vënien e duarve mbi gjunjë, duke i lënë gishtërinjtë e hapur:

“Erdhi një njeri nga ensarët tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, dua të të pyes për disa fjalë!”. I Dërguari i Allahut i tha: “Ulu!” Më pas erdhi një njeri nga thekifi dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, dua të të pyes për disa fjalë!” I Dërguari i Allahut i tha: “Të parapriu ensariu!” Ensariu i tha: “Ai njeri është i huaj, andaj po i jap përparësi atij, pra fillo me të.” I Dërguari i Allahut i tha atij që erdhi nga thekifi: “Nëse do, unë të informoj, e nëse do pyet e unë të përgjigjem?!” Ai tha: “O i Dërguar i Allahut, përgjigju ndaj pyetjeve të mia që unë doja të të pyesja ty!” Atëherë i Dërguari i Allahut tha: “Ti erdhe të më pyesësh mua për rukunë, sexhden, namazin dhe agjërimin!” Ai tha: “Pasha Atë që të ka dërguar ty me të vërtetën, nuk gabove asgjë sepse unë ashtu doja të të pyesja ty.” Atëherë i Dërguari i Allahut i tha:

“Kur të bësh rukunë, vendosi duart tua mbi gjunjët tu, gishtat tu le të jenë të hapur, qëndro ashtu derisa të pushon secila pjesë e trupit në vendin e vet...”¹¹

Gjithashtu edhe hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejre, i njohur si hadithi i keqfalësit të namazit:

“I Dërguari i Allahut a.s. hyri në xhami. Pastaj hyri një njeri u fal dhe erdhi e përshëndeti të Dërguarin e Allahut. I Dërguari ia ktheu selamin dhe i tha: “Kthehu dhe falu përsëri, sepse ti nuk je falur (siç duhet)!” Ai u fal dhe erdhi tek i Dërguari i Allahut, të cilin e përshëndeti me selam. I Dërguari i Allahut i tha përsëri: “Kthehu dhe falu përsëri, sepse ti nuk je falur (siç duhet)!” Kështu i tha tri herë, ndërsa ai ia ktheu: “Pasha Atë që ty të dërgoi me të vërtetën, nuk di përveç asaj mënyrë (që u fala), prandaj më mëso.” I Dërguari i Allahut i tha: “Kur të hysh për namaz, shqiptojë tekbirin, pastaj lexo diç nga Kurani që të vije më lehtë, e më pas shko në ruku derisa (gjymtyrët e trupit) të qetësohesh plotësisht, pastaj ngrihu (nga rukuja) derisa të drejtohesh plotësisht e më pas lëshohu për në sexhde derisa të qetësohesh (e të drejtohesh) plotësisht. Ngrihu nga sexhdeja dhe qëndro ulur derisa të drejtohesh plotësisht, e më pas lëshohu prapë për në sexhde derisa të qetësohesh (e të drejtohesh) plotësisht, e kështu vepro gjatë tërë namazit.”¹²

SHPIA TË JETË E RRAFSHËT

Shpina duhet të jetë e rrafshët, e koka të jetë paralel, gjegjësisht në të njëjtin drejtim me shpinën, as e ulur poshtë e as e ngritur. E në ruku duhet thënë: “Subhane rabbije-l adhim-”, së paku tri herë.¹³

Berra ibën Azibi ka thënë: “I Dërguari i Allahut kur shkonte në ruku, e shtrinte shpinën e tij (ishte e rrafshët)...”¹⁴

Shpina e të Dërguarit të Allahut gjatë rukusë ishte e rrafshët dhe e drejtuar, aq sa dikush e përshkroi atë se edhe po ta vendosje gotën me ujë mbi shpinën e tij nuk do të derdhje:

“E kam dëgjuar Vabisah ibën Ma’bedin duke thënë: “E kam parë të Dërguarin e Allahut duke u falur, saqë kur e bënte rukunë, e drejtonte shpinën e tij, aq sa edhe po t’i vendosej atij uji (në shpinë), do të qëndronte ashtu (uji pa u derdhur).”¹⁵

Gjatë qëndrimit në ruku, shpina, ashtu siç elaborova, të jetë e rrafshët, e jo të jetë si shpina e devesë, në formë të harkut. Kërkohet që rukuja të bëhet në formë të kërkuar, e jo të bëhet vetëm një kërrusje e shkurtër apo të ulet koka më tepër. Shumë namazfalës janë të pakujdesshëm në rukunë e tyre, ata ose nuk përkulen aq sa kërkohet, ku ose koka ose shpina nuk janë të rrafshët dhe paralel me njëra-tjetrën, ose përkulja është edhe më e theksuar se që kërkohet. Disa përkulën me një përkulje të lehtë, ku zakonisht koka nuk është paralel me shpinën, e disa nuk e drejtojnë shpinën gjatë përkuljes së tyre. Në raste të tilla, rukuja nuk i plotëson kushtet. As nuk duhet ngritur koka e as nuk duhet ulur, por duhet të jetë paralel me

shpinën,¹⁶ gjegjësisht të jetë shpina në vijë të drejtë me kokën dhe anasjelltas.

PËRFUNDIM

Në ruku shkohet duke shqiptuar fjalët “Allahu ekber”, duart duhet të jenë të vendosura mbi gjunjët e namazfalësit, gjersa shpina duhet të jetë krejtësisht e drejtë. Ky është pozicioni që duhet ta praktikojë secili namazfalës. Në ruku duhet t’i shqiptojë fjalët e njohura që shprehin madhështi absolute ndaj Allahut.

1 Kasani, *Bedaiu-s Sanaiu*, v. II, f.54-55.

2 Serhasij, *El Mabsut*, v.I, f.23.

3 Tirmidhiu në Sunen, nr. 253. Transmetime të tilla transmetohen edhe nga Ebu Hurejre, Enesi, Ibën Omeri, Ebu Malik el Esh’arij, Ebu Musa, Imran ibën Husajni, Vail ibën Huxhri dhe Abdullah ibën Abasi. Më pas Tirmidhiu thotë: “Hadithi i Abdullah ibën Mesudit është hadith hasen-sahih autentik dhe kjo ka qenë praktikë te shokët e Pejgamberit a.s., prej tyre Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu dhe te të tjerët, gjithashtu edhe te gjenerata e tabiinëve dhe te fukahatë dhe ulematë.” Albani për hadithin në fjalë thotë se është autentik.

4 Muslimi në Sahih, nr. i hadithit 28 (392); Ibën Huzejme në Sahih, nr. 578; Nesaiu në Sunen, nr. 1150. Hadithi është autentik. Albani dhe të tjerët e vlerësojnë hadithin në gradën më të lartë të besueshmërisë.

5 Ebu-l Mealij, *El Muhitu-l Burhanij fi-l Fikhi-n Nu’manij*, v.I, f.385.

6 Ibën Humam, *Fet’hu-l Kadir*, v.I, f.296.

7 Muhamed ibën el Hasen Shejbani, *El Xhami’ es Sagir*, bot.I-rë, Alemu-l kutub, Bejrut-Liban, 1406, f.78.

8 El Mevsilij, *El Ihtijar lita ’li-l Muhtar*, v.I, f.173.

9 Es Sugdi, *En Netfu fi-l Fetava*, v.I, f. 71.

10 Merginani, *El Hidajeh Sherh Bidajetu-l Muhtedi*, v.I, f.83.

11 Ibën Hibani në Sahih, nr.1887. Hadithi është i gjatë, kam shkëputur vetëm pjesën e rukusë.

12 Buhariu në Sahih, nr. 397; Muslimi në Sahih, nr. 602.

13 Merginani, *Bidajetu-l Muhtedi*, v.I, f.14; Merginani, *El Hidajeh sherh Bidajetu-l Muhtedi*, v.I, f.83; El Mevsilij, *El Ihtijar lita ’li-l Muhtar*, v.I, f.174.

14 Bejhekiu në Sunen el Kubra, nr. 2697.

15 Ibën Maxhe në Sunen, nr. 872. Albani thotë se hadithi është autentik (sahih). Në senedin e hadithit është transmetuesi Talha ibën Zejdi për të cilin Buhariu dhe disa tjerë i kanë refuzuar hadithet prej tij, ndërsa Ahmed ibën el Medinij e cilëson si shpikës të haditheve. Ibën Maxhe, *Sunen*, v.I, f.283; Ibën Kethir, *Xhamiu-l mesanid ve-s Sunen...* Me recenzurë nga Abdulmelik ibën Abdullah ed Duhejsh, bot.II-të, Mektebetu-n nehdatu-l haditheh, Meke, 1419-1998, v.VIII, f. 376. Ibën Hibani për Talhan ka thënë: “Nuk lejohet të argumentohet me lajmet (transmetimet e tij).” Ebu Hatimi për të ka thënë: “Është i dobët në hadith dhe nuk meriton të shkruhen hadithet prej tij!” Ibën el Mulekin, *Muhtesar Telhisu-dh Dhehebij*, bot. I-rë, Daru-l asimeh, Riad, 1411, v.III, f.1251.

16 Merginani, *El Hidajeh sherh Bidajetu-l Muhtedi*, v.I, f.83; Zejlei, *Nasbu-rr Rrajeh Liehadithi-l Hidajeh*, v.I, f.501.

Kush po e përçafon dhe kush po e braktisë Islamin?!

Hajrudin S. Muja

Kur po i thosha një miku amerikan se “jam mysliman”, ai më tha “mendoja se myslimanët janë të zinj, të varfër ose të paarsimuar!” Ky është perceptimi që media perëndimore ua paraqet njerëzve, po ai perceptim që mediat shqiptare, po përpiqen maksimalisht me “lëvizje” banale, të bëjnë “buallin” prej asgjëje. Habitët njeriu kur i dëgjon “analistët”, të cilët nuk dinë as të turpërohen nga padituria që kanë e që e shfaqin! Çka përfiton qytetari prej programeve të tilla, sepse injoranti vetëm injorancë mund të shesë. Çfarë qëllimi synon të ketë televizioni ose gazeta prej programeve të tilla dhe ku e gjejnë gjithë këtë kohë të merren me këta injorantë, kur shqiptarët i kanë mbuluar hallet e të gjitha llojeve. Si nuk e kanë kuptuar se në rrolin e hyzmeqarit që kanë marrë do të dështojnë, sepse kanë dështuar të gjithë hyzmeqarët e mëparshëm, që nuk kanë qenë të paktë. Se cilat plane po synojnë të realizojnë po dalin sheshi dita ditës, ndërkohë që qeveria do të duhej ta kishte para syve këshillën e prof. Milazim Krasniqit, një këshillë që e lexova në murin e tij të FB: “Shërbimet tona inteligjente dhe të sigurisë duhet të kthejnë vëmendjen edhe ndaj grupeve okulte si ‘Lëvizja e Deçanit’, si edhe ndaj disa emisioneve televizive, që nxisin konflikt në baza fetare. Me shumë gjasë janë pjesë e të njëjtës skemë për destabilizimin e

“Tregoja një dëshmi personit që përpiket të mësojë të vërtetën, ai do ta pranojë atë, jepi njëmijë dëshmi atij që nuk është i singertë, ai do t’i refuzojë të gjitha”.

Kosovës”. Për këtë të fundit as që ka dyshim! Pavarësisht emrit që posedojnë, grupet e tilla kanë për qëllim ndryshimin e identitetit kombëtar dhe fetar të shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht duke sulmuar myslimanët dhe duke kërkuar prej tyre, të lënë fenë islame për t’ju bashkuar “Shqiptarisë”. Në fjalët e aktorit të ndjerë Enver Petrovcit thoshte: “Të mjerë janë ata që nuk besojnë, ata që dinë vetëm si me qenë shqiptarë”, sepse besimi dhe shqiptaria janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Këta që po konvertohen, nuk po dalin prej Islamit, sepse nuk kanë qenë kurrë në të, vetë po e pohojnë se nuk e kanë njohur dhe as nuk e kanë praktikuar. Ata as nuk janë kthyer “në fenë e të parëve”, sepse siç pohojnë me injorancën e tyre, as atë nuk e njohin dhe as nuk e praktikojnë. Të mençurit nuk bëjnë “filma” me fenë, ata kërkojnë informacion, i studiojnë, i klasifikojnë dhe vendosin të shkojnë në atë që mendojnë se është më e logjikshme për to. Ata janë të bindur dhe instinktivisht e dinë pa mëdyshje se ekziston një Zot, një sistem jete, një e vërtetë dhe një rrugë që të çonte tek ajo. Për këtë rrugë duhet vullneti për ta mësuar, siç thuhet: “Tregoja një dëshmi personit që përpiket të mësojë të vërtetën, ai do ta pranojë atë, jepi njëmijë dëshmi atij që nuk është i singertë, ai do t’i refuzojë të gjitha”. Kështu është zinxhiri

natyror i jetës, brenda së cilës mendimet tona bëhen bindjet tona, bindjet tona bëhen sjelljet tona, sjelljet tona bëhen zakonet tona, zakonet tona formojnë karakterin tonë dhe karakteri jonë përcakton fatin tonë. Kaq e thjeshtë është kjo.

David K. Irwin ka një punim që titullohet “Çfarë duhet të dinë të krishterët për myslimanët”.¹ Bëni vetëm pak kërkime - thotë Irwin, që të gjeni listën mbresëlënëse të të konvertuarve në Islam dhe gjykoni vetë! Përse të burgosurit po konvertohen në Islam? Përse shkencëtarët dhe njerëzit e famshëm, përse ateistët, përse priftërinjtë, rabinët, misionarët dhe murgjit e krishterë?! Atje mund të gjeni shumë të konvertuar nga Krishterimi në Islam, si dhe jomyslimanë që janë të interesuar dhe po mësojnë më shumë rreth Islamit. Këta myslimanë të rinj, kanë prejardhje të ndryshme, përfshijnë intelektualë, shkencëtarë, priftërinj, rabinë, misionarë dhe artistë, të rinj dhe të vjetër, të famshëm dhe laikë, nga e gjithë bota. Një kthesë e dukshme e konvertimit në Islam në Shtetet e Bashkuara daton nga ngjarjet e 11 shtatorit (2001)², natyrisht me disa faktorë që e nxitin atë.³ Sipas një studimi me 304 gra të konvertuara, këto faktorë kryesisht ishin tërheqja e vlerave morale, dhe pakënaqësia me besimin e mëparshëm.⁴

Burimet më të fundit japin rreth 3 milionë njerëz që përqafojnë Islamin çdo vit. Këto konvertime ndodhin në kontinente të ndryshme, me rritje të dukshme në rajone të tilla si Afrika Sub-Sahariane, Evropa dhe disa pjesë të Azisë. Në Evropë konvertimi arrin në qindra mijëra dhe një rritje të raportuar së fundmi pas ngjarjeve në Gaza në fund të vitit 2023. Arsyet e konvertimit janë të ndryshme dhe mund të përfshijnë gjetjen e përmbushjes shpirtërore, një lidhje me vlerat evropiane dhe në disa raste, një afinitet të perceptuar me mësimet islame, pavarësisht klimës antagoniste ndaj Islamit në disa zona të Evropës. Nga lufta në Gaza, shkalla e konvertimit të njerëzve që pranojnë Islamin është rritur me 400% në Evropë, vetëm në Francë, më shumë se 20 mijë njerëz e kanë pranuar Islamin, pasi kanë parë klipet e mizorive në Gaza. Përqindjen më të madhe të konvertuarve e ka Anglia (150,000 dhe

200,000 konvertime vjetore) dhe Franca (rreth 100,000 konvertime vjetore). Bazuar në një raport të Qendrës Kërkimore “Pew” të këtij viti (2025), Shtetet e Bashkuara dhe Kenia kanë shkallën më të lartë të konvertimit në Islam, megjithëse këto konvertime nuk e ndryshojnë ndjeshëm peizazhin e përgjithshëm fetar të këtyre vendeve, ku myslimanët mbeten një pakicë e vogël. Sot 20% e myslimanëve të Amerikës janë të konvertuar dhe 11% e myslimanëve të Kenias thonë se janë rritur në një fe tjetër ose pa fe fare.⁵

Shumë të burgosur në burgjet e Amerikës, njerëz të rëndomtë, të cilët para se të jenë burgosur ose nuk e kanë njohur fare Islamin, ose e kanë njohur sipas shpjegimit të rrejtshëm mediatik perëndimorë, kanë përfunduar në Islam. A thua përse? Artikiulli i Gabriela Phillips-it “Pse të krishterët po konvertohen në Islam”⁶, na jep një përgjigje, pas intervistave të shumta që ajo pati me disa prej tyre. Fillimisht – thotë ajo, ato përcaktohen si “myslimanë”, pasi ndihen të rrezikuar nga bandat brenda burgut: “Ata ishin të vetmit që qëndronin së bashku dhe mbronin njëri-tjetrit”. Ata qëndrojnë krah njëri-tjetrit në pesë kohët e lutjes ditore dhe ajo lutje pastaj u jep fuqinë emocionale. Martin Michael i tha se bëri “shehadetin” në burg dhe menjëherë u bë pjesë e asaj “vëllazërie”. Pastaj me kohën, vinte tërheqja ndaj standardeve brenda mësimdhënies dhe përmbajtja e doktrinës teologjike, e cila e forcoi gjithnjë e më shumë drejt kësaj feje. Fillimisht, lutja nuk i dha paqe Michaelit, sepse ai nuk i kuptonte fjalët që recitonte, por lutja i dha strukturë: “Jeta ime ishte kaos total dhe tani kisha pesë takime me qenien më të fuqishme të universit”. Jashtë burgut, janë po ato që në rast të goditjes së ndonjë tornadoje, ata të parët të vijnë në ndihmë. Dhe... mund të ketë shumë rrethana, por e përbashkëta është se një situatë specifike nxitet konvertimi. Përveç elementeve tërheqëse doktrinare të Islamit, Phillips mendon se ka edhe një element tjetër në këtë mes: “Janë shumë të lodhur nga Krishterimi i vakët, që injoron padrejtësinë, gjendjen e vështirë të të varfërve, dhe mungesën e modestisë që u duket si pa shtyllë kurrizore”. Brenda kësaj pastaj ata gjejnë Kuranin të

Burimet më të fundit japin rreth 3 milionë njerëz që përqafojnë Islamin çdo vit. Këto konvertime ndodhin në kontinente të ndryshme, me rritje të dukshme në rajone të tilla si Afrika Sub-Sahariane, Evropa dhe disa pjesë të Azisë.

ruajtur në mënyrë të përsosur (ndryshe nga Bibla) dhe Njëtinë e Zotit që është racionale kur krahasohet me trinitetin e pakuptimtë. Prandaj, sugjerohet hulumtimi mbi efektin psikologjik që Kurani ka te lexuesit e tij, që do të hidhte më shumë dritë mbi fenomenin e konvertimit në Islam.⁷

Mund të jetë i saktë mendimi i Gabriellas për njerëzit e rëndomtë, por natyrisht është shumë më ndryshe me njerëzit që kanë arritur pedestalin e mundshëm të njohurive në fushat shkencore. Arsyet e raportuara për konvertimin midis shkencëtarëve dhe akademikëve përfshijnë: përputhshmërinë shkencore të perceptuar në Kuran, përmbushjen intelektuale dhe ekzistenciale, rezonancën filozofike, hulumtimet historike dhe akademike dhe dëshirat për një kornizë morale. Ata kanë deklaruar mahnitjen moderne të shkencës që përputhet me një tekst të përpiluat para katërmëdhjetë shekujve, si pasazhet rreth zgjerimit të universit, zhvillimit të embrionit njerëzor, fenomeneve astronomike, etj.. Disa përshkruajnë përjetimin e një boshllëku shpirtëror që vetëm ndjekjet e tyre shkencore nuk mund ta mbushnin. Kurani u ofroi përgjigje për pyetje më të thella rreth qëllimit të jetës dhe natyrës së realitetit. Disa të tjerë kanë dhënë si arsye të menduarit kritik dhe ndjekjen e dijes që rezonuan thellë me metodologjinë e tyre shkencore, ata e shohin besimin dhe arsyen jo si ndjekje reciproke përjashtuese, por plotësuese. Disa studiues dhe akademikë të specializuar në studimet islame dhe të Lindjes së Mesme, si Jonathan A.C. Brown, janë konvertuar pas kërkimeve të gjëra mbi vetë fenë, ndërkohë të tjerët janë shprehur se kanë gjetur një kuadër të qëndrueshëm dhe moral në Islam, që ata besojnë se ofron udhëzime dhe një mënyrë të shëndetshme jetese. Përgjithësisht, shkencëtarët individualë që konvertohen në Islam raportojnë arsye të ndryshme personale dhe intelektuale për zgjedhjen e tyre, me një temë të përbashkët që është përputhja e perceptuar midis zbulimeve shkencore moderne dhe përshkrimeve të gjetura në Kuran, paralele që sipas mendimit të tyre, janë prova të origjinës hyjnore.

Sa për të dhënë vetëm disa nga këto individë: doktori i Mjekësisë në Francë, dr. Ali Selman Benoist (1953)⁸, shkencëtari (atesit) japonez, dr. Atsushi Kamal Okuda (2025), mjeku francez, dr. Maurice Bucaille - ish-shef i Klinikës Kirurgjikale, Universiteti i Parisit (1970); profesori amerikan i matematikës, dr. Jeffrey Lang (1982), embriologu kanadez, dr. Keith L. Moore (1987), nga Departamenti i Anatomisë dhe Biologjisë Qelizore në Universiteti i Torontos; shkencëtari i mjekësisë nga Universiteti i Harvardit, dr. Henry Klassen (2024); Biologu E. Marshall Johnson, profesor dhe kryetar i Departamentit të Anatomisë dhe Biologjisë Zhvillimore dhe drejtor i Institutit “*Daniel Baugh*” pranë Universitetit “*Thomas Jefferson*” në Filadelfia (Pensilvani); T.V.N. Persaud - profesor i Anatomisë dhe profesor i Pediatriisë dhe Shëndetit të Fëmijëve, pranë Universiteti të Manitobës (Kanada); Joe



Leigh Simpson - profesor dhe kryetar i Departamentit të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, Kolegji i Mjekësisë Baylor në Huston – Teksas; Gerald C. Goeringer - profesor dhe koordinator i Embriologjisë Mjekësore në Departamentin e Biologjisë Qelizore pranë Universiteti Georgetown në Washington DC (2023); Alfred Kroner - profesor i Departamentit të Gjeoshkencave, Universiteti i Mainzit në Gjermani; Yushidi Kusan - drejtor i Observatorit të Tokios në Japoni (2023); William Hay - profesor i Oqeanografisë, Universiteti i Kolorados (SHBA); Durja Rao - profesor i Gjeologjisë Detare pranë Universitetin King Abdulaziz, Xheda (Arabi Saudite); Tejatat Tejasen - kryetar i Departamentit të Anatomisë dhe ish-dekan i Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Chiang Mai (Tajlandë) (2024),

Përveç shkencëtarëve, janë konvertuar edhe njerëz të famshëm, si kompozitori indian Yuwan Shankar Raja (2014), modelja franceze Marine el Himer (2022), ylli televiziv francez Dylan Thierry (2025), aktorja Sharmila Tagore (1968), kompozitori i muzikës indiane Dileep Kumar (1989), kompozitori dhe muzikanti britanik Cat Stevens - Yusuf Islam (1977)⁹, studiuesi (ateist) Martin Lings, reperi Dachi (2022), boksieri legjendar Cassius Clay Jr. përkatësisht Muhamed Ali (1964), lojtari i madh i NBA-së Kareem Abdul-Jabbar (1971), reperi i njohur Ice Cube (1990), aktorja Mahershala Ali (2000), komediani Dave Chappelle (1998), këngëtarja Janet Jackson (2012), boksieri gjerman Wilhelm Ott (2020), futbollisti Robert Bauer dhe vlogeri Christian Betzmann (2021), ish-reperi Denis Cuspert (Abou Maleeq),



ish-boksieri profesionist australian Anthony Mundine (1999), miliarderi britanik Alfie Best (2024), aktorja britanike Aisha Rosalie (2021), boksieri britanik Ryan Taylor (2024), Atletja australiane Cory Paterson (2014), këngëtari i famshëm Chauncey Hawkins – Loon (2008), ish-prezantuesja e krishterë dhe e MTV-së Kristiane Backer (1995), aktorja britanike Myriam Francois-Cerrah (2003).

Një ateist mund të konvertohet në Islam përmes një udhëtimi personal të kërkimit intelektual ose përvojave shpirtërore, që shpesh përfshijnë studimin e teksteve islame si Kurani dhe reflektimin mbi qëllimin e jetës. Disa individë raportojnë një ndjenjë ndriçimi ose një ndjenjë se Islami ofron një shpjegim më të plotë për realitetin pas reflektimit kritik. Të tjerë përshkruajnë një pikë kthese shpirtërore, siç është një ngjarje bindëse ose krizë personale, që i shtyn ata të kërkojnë përgjigje në fe. Shembuj të të konvertuarve: G. Willow Wilson, autore amerikane, që u rrit si ateiste përpara se të konvertohej në Islam, ajo më vonë rilançoi serinë e komikëve Ms. Marvel, me një super hero mysliman. Dr. Jeffrey Lang, një profesor amerikan që ishte ateist përpara se të konvertohej në Islam në fillim të viteve 1980, ka dokumentuar udhëtimin e tij drejt Islamit, i cili është i disponueshëm në platforma si YouTube. James Lake, një ish-ateist që u konvertua në Islam, e përshkruan jetën e tij si më të përlulur dhe ndihet më i dhembshur dhe i durueshëm që nga konvertimi i tij. Nailah Edwards, një kanadeze që ishte ateiste përpara se të konvertohej në Islam në vitin 2011. Ajo e ndau historinë e saj në Islam Channel.

Lista e këtyre të konvertuarve është shumë e gjatë dhe rrëfimet e këtij rrugëtimi drejt Islamit mund të shihen e të dëgjohen në kanalën YouTube, por ndër dëshmitë më të fuqishme dhe më nxitëse të mendimit, janë ato të ish-priftërinjve, ish-rabinëve, ish-murgjërve dhe misionarëve të

krishterë, që kanë zbuluar *fenë e vetme të vërtetë*. Kjo është një sfidë e jashtëzakonshme për misionarët e krishterë, prandaj ato 500 milionë dollarët që i shpenzojnë për të konvertuar myslimanët e varfër në Krishterim, do të duhej t'i shpenzonin në ruajtjen e “grigjës” së vet.¹⁰ Kush i ka lexuar “*Letra dhe dokumente*” të Bogdanit, do të gjej priftin shqiptar Don Nikë Leka prej Tivarit, i cili bashkë me familjen e vet, kishte vajtur në Kostandinopojë dhe atje kishte pranuar Islamin (1662). Bogdani brengosej, sepse *turqit* tashmë zhvillonin fushatë të madhe, duke u thënë të krishterëve: “*Bëhuni turq si Don Nikë Leka që ishte abat dhe vikar juaj*”.¹¹ Të tilla ndërmarrje shpeshherë vinin nga njerëz të përfshirë në mosmarrëveshje me hierarkitë kishtarë dhe, për këtë arsye, përbënte një mënyrë për t'i shpëtuar një situatë që konsiderohej e papërshtatshme dhe, në disa raste, përdorej si një formë hakmarrjeje kundër një kundërshtari të fuqishëm. Shembulli më i famshëm në kohët paramoderne ishte ai i murgut egiptian Ibrahim, i cili pas një grindjeje të hidhur me patriarkun e Kajros, në gjysmën e dytë të shekullit XIV, u bashkua me Islamin për t'i shpëtuar ndëshkimit që iu dha.

Në kohët e hershme moderne, për osmanët, ky lloj konvertimi ishte aq i lakmueshëm dhe kishte një rëndësi kaq simbolike, saqë në biografi të shumta të burrave të devotshëm myslimanë, u bë një temë retorike e përhapur, që synonte të nxirrte në pah, se si Islami ishte i vetmi besim i vërtetë në një periudhë ekspansionizmi të fortë turk. Shembulli më i mirë gjendet në një vepër shumë të njohur të shekullit XV. Tregon se si një përfaqësues i sulltanit mori pjesë në konkursin vjetor mbi njohuritë e Biblës midis klerikëve të një qyteti në Maqedoni. Fituesi, i cili u emërua udhëheqës i komunitetit të tij, ishte një prift i ri. Duke e ditur këtë, sulltani e ftoi atë në oborrin e tij dhe theksoi se në këtë mënyrë dhuratat e tij intelektuale mund të vlerësoheshin plotësisht. Ndërkohë, i

riu vendosi t'i bindej vizionit në të cilin ai aderonte në Islam dhe u vendos në shërbim të sundimtarit osman.¹² Ky ishte Mahmud Pashë Angjeloviqi, njohës i mirë i shkrimeve të krishtera, student i Mulla Gjuranit dhe studiues shkencor i Kuranit, i cili u bë edhe kryevezir i Sulltan Mehmetit.¹³ Në vitin 1581, një prift kishte ardhur në Koncilin Perandorak, për t'u konvertuar, pas një ëndërre që kishte parë, mori emrin Mehmet dhe ju dha një timar i vogël. Në të njëjtin vit, një prift tjetër, që ishte i afërm i shefit të lajmëtarëve, pranoi Islamit në Koncilin Perandorak, duke pritur përkrahje, edhe atij ju dha një timar. Një vit më pas, një prift 70 vjeçar pranoi Islamit dhe e mori emrin Mehmet, që kërkoj t'i jepej akrualet të themelit të shenjtë të *Aya Sofiya*, që ishte mbetur e pa kërkuar, pas vdekjes së priftit të mëparshëm.¹⁴

Të tilla rrëfime i takojnë historisë dhe ne nuk kemi pse të merremi me to. Irwin jep emra priftërinjsh, misionarësh e murgjish që janë konvertuar në Islam deri në botimin e librit të tij: Peshkop katolik i Uramiahut *David Benjamin Keldani* B.D (1904)¹⁵; ministri i Kishës Pentekostale *Kenneth L. Jenkins* (1954-2023)¹⁶; ish prifti greko-ortodoks *Mark Hanson – Hamza Yusuf* (1977); matematikani kanadez dhe një ish-misionar i krishterë *Gary Miller* (1978)¹⁷; prifti kopt *Ibrahim Khalil* (1959); kryepeshkopi Luteran *Martin John Mwaipopo* (1986); prift katolik gjerman, doktor i Teologjisë - *dr. Yahya A.R. Lehmann* (1980) etj. Irwin e ka botuar librin në vitin 1987, dhe prej atëherë lista e priftërinjve të konvertuar është shtuar: pastora e misionarja *Khadijah 'Sue' Watson* (2017); ministër (*dhjak*) i Kishës së Bashkuar Metodiste, *dr. Jerald F. Dirks* (1993); Rabbi *Moisha Krivitsky* (2007); ministri i Dëshmitarëve të Jehovahit Latino në Los Anodes *Raphael Narbaez, Jr.* (1991); prifti katolik *Idris Tawfiq* (2018), misionarja australiane *Selma A. Cook* (1988)¹⁸; kryepriifti i Kishës Ortodokse Ruse *Viacheslav Polosin* (1999); Jusuf (Joseph) Estes (1991), etj.. Ishte 23 dhjetori 1986, dy ditë para Krishtlindjeve, kur kryepeshkopi Martin John Mwaipopo i njoftoi kongregacionit të tij se po largohej nga Krishterimi për Islamit. Ai vetë shpjegon se: “*Kur e hapa Kuranin, vargjet e para që hasa ishin: ‘Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë. Atëherë në mua u mbollën për herë të parë farat e Islamit dhe zbulova se Kurani ishte i vetmi libër i shenjtë me të cilin njerëzit nuk kishin ndërhyrë që nga shpallja e tij.*” Prej atëherë ai u bë Al Hajj Abu Bakr John Mwaipopo.

Çfarë i shtyri këto priftërinj e misionarë drejt Islamit? Prifti australian i Kishës Ortodokse Ruse – David Gould (2024), vuri në dyshim aspekte të caktuara të Krishterimit, duke përfshirë shugurimin e grave, dhe e çoi atë të studionte tekstet islame. Pas konvertimit (2024) e mori emrin Abdul Rahman¹⁹. Murgu Hilarion Heagy, pas një kërkimi të përjetshëm për të vërtetën, i ndikuar nga Kurani, poezia e Rumiut dhe Sufizmi,

gjeti një lidhje të thellë shpirtërore përmes lutjes islame dhe recitimit të Kuranit, veçanërisht gjatë izolimit të karantinës së vitit 2020, sot njihet si Said Abdul Latif.²⁰ Të tjerë, prifti Vladislav Sohin (2014), peshkopi Kleopas Duclan (2023), prifti Vyacheslav Polosin (1999), prifti Vladimir Ugryumov (2022), prifti katolik amerikan Craig Fenter (2006), prifti Ian Robertson (2024), prifti Moses (Mojsi) Bangura²¹, ministri Rafael Narbaez (1991), prifti Lief Skietne (2017), ministri Jerald Drinks (1974), pastori Shamuël Shropshire (2019), prifti Paul Denet (2003), prifti Gould David (2023), pastori Robert Westmoreland (2024). Është ndoshta më e çuditshme që në raste të veçanta, ka ngjarë që me rastin e konvertimit të priftit, me të është konvertuar i gjithë “xhemati” i kishës së tij. Ky ishte prifti i Afrikës së Jugut - Ibrahim Richmond, që bashkë me të konvertoi edhe 100.000 ndjekësit e tij. Ai u ftua më pas të kryente haxhin prej mbretit saudit. Disa raportime të tjera, megjithëse me shifra të ndryshme, trajtojnë konvertimin e kishave (dhe famullive të tyre) në xhami, pas konvertimit të një prifti në Islam, duke përfshirë një rrëfim në Filipine, një në Afrikën e Jugut që përfshin një pastor tjetër - Adekunle Afolabi. Fillimisht anëtarët e tij e lanë, por pak më vonë u kthyen dhe iu bashkuan atij në Islam, përveç 150 pjesëtarëve që u larguan pas konvertimit. Në Filipine, kemi rrëfimin për famullinë e një kisha, që u konvertua në Islam brenda një dite të vetme. Raportet përmendin gjithashtu shndërrimin e kishave në xhami në kontekste të tjera, siç është shndërrimi i kishave të braktisura në xhami nga *Shoqëria Islamike e Floridës Qendrore*, për t'i shërbyer të njëjtit komunitet.

Këta gjetën pastaj dhe u habiten kur kishin vërejtur zakonet e të pastruarit (abdestit) në Testamentin e Vjetër (Eksodi 40:31-32) dhe në Testamentin e Ri (Veprat e Apostujve 21:26), zakonet i lënë nga të krishterët, por i praktikuar nga myslimanët. Se mënyra e lutjes së myslimanëve ishte fare identike me personalitetet biblike (Psalmi 95:6; Joshua 5:14; Mbretërit 18:42; Numrat 20:61 dhe Eksodi 3:5), për Abrahamin (Gjeneza 17:3), etj., edhe ky një zakon i lënë nga të krishterët dhe i praktikuar nga myslimanët. Myslimanët mbajtën mënyrën e salutimit të profetëve të mëparshëm dhe të vetë Jezusit: “*Paqja qoftë mbi ju!*”²² Për pelegrinazhin (haxhin) e të gjithë profetëve biblikë në *Mizpeh* (Gjeneza 28:18-19; 53:4, 14, 15; 31:45-49; Gjykatësit 11:29-39; 20, 21; I Samuel 7, 10 etj). Jezusi, sikurse myslimanët, nuk e ngrëni mishin e derit (Leviticus, 11:7-8; Deuteronomy, 14:8), dhe ndoqi ligjin e Mojsiut në lidhje me Sabatin, shkurorëzimin, synetimin (Gjonit 7:22), etj.. Dhe habia e madhe e tyre është se krishterët nuk veprojnë sot me shembullin dhe ligjin që jetoj Jezusi, por myslimanët!

1 David K. Irwin: “*What Christians Need to Know About Muslims*”, Springfield - Massachusetts 1987.

2 *Intermountain West Journal of Religious Studies*, #1/2009.



- 3 Akbar Muhammad: 'Some Factors which Promote and Restrict Islamization in America', *American Journal of Islam and Society*, #1(2)/1984, f.41-50.
- 4 A. A. Maslim & J. P. Bjorck: "Reasons for conversion to Islam among women in the United States", *Psychology of Religion and Spirituality*, #1(2)/2009, f. 97-111.
- 5 <https://www.pewresearch.org/religion/2025/03/26/religious-switching-into-and-out-of-islam/>
- 6 Gabriela Phillips: "Why Christians Are Converting to Islam... and How to Respond", <https://nadministerial.com/stories/islam-converts>
- 7 Maha Al-Qwidi: "Understanding the stages of conversion to Islam - the voices of British converts", PhD thesis, University of Leeds, 2002.
- 8 Benoist ishte pasardhës i një familjeje katolike franceze, por: "dogmat dhe ritet e Krishterimit në përgjithësi dhe të Katolicizmit në veçanti nuk më lejuan kurrë të ndieja praninë e Tij". Thotë se edhe para se ta njihje Islamin, kishte besim të plotë në "Zoti, është Një; Zoti është një unitet absolut; Ai kurrë nuk lindi, as nuk u lind; dhe nuk ka askush të barabartë me Të" (Kuran 112:1-4). Elementi thelbësor që përcaktoi në konvertimin e tij në Islam ishte Kurani. Filloi të studiojë me një frymë kritike të një intelektual perëndimor, por ngjau habia e madhe e një shpalljeje më të vjetër, me saktësisht të njëjtat nocione siç mësojnë studiuesit më modernë shkencorë.
- 9 Gjatë qëndrimit të tij me pushime në Marrakesh (Marokë), ai dëgjoi ezanin, që ju shpjegua si "muzikë për Zotin". Thotë Stevens: "Mendova, muzikë për Zotin? Nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë - kisha dëgjuar muzikë për para, muzikë për famë, muzikë për pushtet personal, por muzikë për Zotin!". Para se ta pranonte Islamin kishte shitur më shumë se 100 milionë albume dhe kishte më shumë se dy miliardë dëgjime [BMG, 30 tetor 2015].
- 10 David K. Irwin: "What Christians Need to Know About Muslims", Springfield - Massachusetts 1987.
- 11 Letër nga Shkodra, 9 Maj 1662, "Pjetër Bogdani - Letra dhe Dokumente nga arkivi i Kongregatës 'De Propaganda Fide' si dhe nga arkivat sekrete të Vatikanit", Redaktuar nga Stefan Capaliku, Shkodër 1997, Dokumenti #74, f.145.
- 12 Luigi Andrea Berto: "Christians under the Crescent and Muslims under the Cross c.630-1923", London - New York 2021, f. 31-57.
- 13 "Jeta dhe Vepra e Mahmud Pashës", fl.1453-1474, sipas Tijana Krstić: "Contested Conversions to Islam - Narratives of religious change in the Early Modern Ottoman Empire", Stanford California 2011, f.69. Për jetën e tij, Theoharis Stavrides: "The Sultan of Vezirs - The Life and Times of the Ottoman Grand Vezir Mahmud Pasha Angelovic", Brill, 2001.
- 14 T.Krstić: "Contested Conversions to Islam...", f.71.
- 15 Nuk ka shumë të dhëna për shkakun kryesor që e frymëzoi peshkopin katolik David Benjamin Keldani të konvertohet. Megjithatë ne kuptojmë nga pohimet e tij: duhet t'u kujtojmë të krishterëve se, nëse nuk besojnë në unitetin absolut të Zotit dhe nuk heqin dorë nga besimi në tre personat, ata janë me siguri jobsimtarë në Zotin e vërtetë...
- 16 Gjithçka filloi pas pranimit të një pune në Arabinë Saudite dhe aty pa një stil jetese tjetër për myslimanët e atjeshëm, një fe që praktikonin të gjitha racat, ngjyrat dhe gjuhët. Kjo e inkurajoi të mësonte më shumë për këtë fe. Lexoi shumë libra, por Kuranin e studioi për katër muaj. Ai thotë: "Ajo që më tërhoqi ishte se vëllezërit nuk ishin të etur të më bënin përshtypje me njohuritë e tyre. Nëse një vëlla nuk dinte si t'i përgjigjej një pyetjeje, ai më thoshte se thjesht nuk dinte dhe duhej të kontrollonte me dikë që dinte. Të nesërmen ai gjithmonë do të sillte përgjigjen. Vura re se si përlësia luante një rol kaq të madh në jetën e këtyre njerëzve misteriozë të Lindjes së Mesme".
- 17 Miller nuk kishte takuar kurrë një mysliman, më të afërmin mund ta kishte njëqind kilometra larg. Frymëzimi i erdhi nga pretendimet e jomyslimanëve për Profetin Muhamed a.s.. Disa shkrimtarë e konsideronin atë si "gënjeshhtar", kurse të tjerët si "të çmendur", por sipas prof. Millerit: "njeriu nuk mund të jetë 'gënjeshhtar' dhe 'i çmendur' në të njëjtën kohë". Kështu që vendosi ta zbulonte të vërtetën vetë dhe kjo e vërtetë e udhëzoi në Islam, kur zgjodhi emrin Abdul-Ahad Omar.
- 18 Edhe pse misionare australiane, Selma A. Cook, tregon luhatjen e saj në pamundësi për të gjetur shpjegime të kënaqshme në lidhje me Jezusin dhe fenë e krishterë. E kishin mësuar se Jezusi ishte biri i Zotit dhe se njeriu mund të shpëtohej vetëm përmes besimit në Jezusin. Pyeste veten pse Zoti, i cili ishte kaq i fuqishëm në mënyrë të dukshme, do të kërkonte diçka, e lëre më një bir për të përmbushur qëllimin e Tij. Pse Krijuesi nuk mund ta falte thjesht krijimin e Tij pa një ndërmjetës? Ishte e bindur dhe instinktivisht e dinte pa mëdyshje se ekzistonte një Zot, një sistem jete, një e vërtetë dhe një rrugë që të çonte tek ajo. Për ta kuptuar Islamin, i ndihmuan fqinjët e saj myslimanë. Ata thjesht i lexuan ajete nga kaptina kuranore e Merjemit, ju duk aq e kapshme sa lotët nuk i pushuan gjatë gjithë kohës së leximit. Mësoi se të gjithë profetët kishin ardhur që të shmangin çdo adhurmim përveç adhurmimit të Zotit të Vërtetë dhe t'i nënshtrohen Vullnetit të Tij. Ky ishte kuptimi i Islamit.
- 19 YouTube: Why Did Orthodox Priest Gould David Convert to Islam After 45 Years?
- 20 YouTube: A Catholic Priest's Journey To Islam with Said Abdul Latif (Fr. Hilarion Heagy).
- 21 YouTube: Former Missionary Helped over 600 Christian Priests Convert to Islam.
- 22 "Ai u përgjigj: Paqja me ju" (Zanafilla 43:23), "Por Zoti tha: Paqja me ty" (Libri i Gjygtarëve 6:23), "Thoni kështu vëllait tim: Paqja me ty" (1 Samuel 25:6), "E sjellte Zoti fytyrën e vet drejt teje, e ta dhëntë paqen" (Libri i Numrave 6:26), "Shko në Paqe dhe Hyji i Izraelit të plotësoftë kërkesën që i bëre" (1 Samuel 1:17), "Vetë Jezusi tha: Paqja me ju" (Luka 24:36, Gjoni 20:19, 20:26), "Në cilëndo shtëpi të hyni, më parë thoni: Paqja me këtë shtëpi" (Luka 10:5). A mund të takoni sot ndonjë të krishterë që të përshëndetë me fjalët e Jezusit "Paqja qoftë mbi ju"?

“Lëvizja e Deçanit” po mashtron, sepse katolicizmi nuk është shqiptarizëm

Milazim Krasniqi

“Lëvizja e Deçanit” dhe grupe të tjera hibride antishqiptare, e kanë shndërruar në kalë të betejës së vet donkishoteske tezën se gjoja kalimi në katolicizëm siguron forcim në shqiptarizëm. Barazimin e katolicizmit me shqiptarizmin, po tentojnë ta paketojnë si të vërtetë përfundimtare, edhe pse asnjë shenjë barazie nuk mund të ekzistojë ndërmjet katolicizmit si një religjion botëror dhe

shqiptarizmit, si një identitet kombëtar i një kombi të vogël ballkanik. Prandaj, do ta analizoj këtu shkurt, por mjaftueshëm saktë, se çka është katolicizmi dhe cili është relacioni eventual i tij me shqiptarizmin. Pse? Publiku ynë i gjerë, sidomos shumica myslimane, ka nevojë për këtë shpjegim, sidomos gjeneratat e reja, të cilat jo vetëm në Kosovë po edhe nëpër Evropë ndeshen me ide për konvertim.



Kisha Katolike e mban si themelues të vetin Jezu Krishtin (Isain a.s.).

Rrjedhimisht, nuk mund të ketë ndonjë identitet nacional shqiptar, që do të mund të buronte nga katolicizmi e nga Kisha Katolike.



Prandaj, publiku ynë i ekspozuar sulmeve brutale të këtyre kryqtarëve të sotëm donkishotesk në Kosovë e në diasporë, do të duhej të dinte disa të vërteta themelore mbi katolicizmin si besim fetar.

E para, katolicizmi është pjesë përbërëse e Krishterimit, si religjion botëror. Pra, katolicizmi është pjesë e religjionit botëror e jo e ndonjë ideologjie kombëtare. Nga ndarja (shizma) e kishave e vitit 1054 janë krijuar ndasi e dallime doktrinare brenda Krishterimit, por katolicizmi ka qenë dhe ka mbetur pjesë thelbësore e tij, ndërsa Kisha Katolike është një strukturë mbinacionale. Thënë thjesht, katolicizmi nuk mund të kthehet në dekor nacional të asnjë kombi, as në dekor nacional italian, as gjerman, as brazilian, as spanjoll, më së paku në dekor nacional shqiptar. Ndërsa Kisha Katolike me përbërjen e saj heterogjene dhe me shtrirjen e saj globale, assesi nuk mund të ketë tipare të ndonjë kishe kombëtare, siç i kanë kishat ortodokse, ruse, greke, rumune, bullgare, serbe.

**Gjenerata të
tëra të
shqiptarëve
katolikë kanë
jetuar e kanë
dëgjuar
liturgjitë
latinisht, por
ajo nuk i ka
bërë më pak
shqiptarë.**

Sa i përket doktrinës së katolicizmit, ajo mbështetet në librat e shenjtë (Biblën), në traditat dhe në koncilet e Kishës. Kisha Katolike e mban si themelues të vetin Jezu Krishtin (Isain a.s.). Rrjedhimisht, nuk mund të ketë ndonjë identitet nacional shqiptar, që do të mund të buronte nga katolicizmi e nga Kisha Katolike. Meqë brenda katolicizmit, sot, në botë aderojnë rreth një miliardë e pesëqind milionë njerëz, është naive të mendohet se shqiptarët mund të kenë ndonjë ndikim ose ndonjë vend të spikatur brenda tij a brenda Kishës Katolike.

Sa u përket festave fetare katolike, natyrisht që edhe ato janë brenda historisë dhe doktrinës së Kishës, e aspak të lidhura me ndonjë histori a traditë shqiptare. Prandaj është naivitet pretendimi se përmes tyre forcohet kujtesa a identiteti kombëtar. Në çdo religjion, festat fetare janë festa fetare, nuk bëhen kurrë festa kombëtare.

Sa i përket gjuhës së liturgjisë, gjuha latine ka qenë gjuha zyrtare, deri në Koncilin e Dytë të Vatikanit (1962-1965.) Pra, edhe gjenerata të tëra të shqiptarëve katolikë kanë jetuar e

kanë dëgjuar liturgjitë latinisht, por ajo nuk i ka bërë më pak shqiptarë. Kisha Katolike, nga ana e saj, ka proklamuar ekumenizmin si qëllim final të saj në raport me kishat e tjera të shumta. Ndërsa në raport me religjionet e tjera, përfshirë edhe Islamin, ka proklamuar dialogun ndërfetar dhe tolerancën. Pra, Kisha Katolike, ka proklamuar pajtim dhe tolerancë, duke u shkëputur nga praktikat e së kaluarës.

Duke pasur parasysh këtë histori, këtë përbërje dhe këto zhvillime brenda katolicizmit e Kishës Katolike, mund të nxirren këto përfundime:

Katolicizmi është pjesë thelbësore e Krishterimit si religjion botëror e nuk mund të bëhet kurrsesi religjion kombëtar i ndokujt, pra, as i shqiptarëve, për çka përhapin mjegull militantët e “Lëvizjes së Deçanit.”

“Kisha Katolike është mbinacionale dhe e centralizuar”, siç thuhet qartë edhe në Enciklopedinë Kroate. Si e tillë ajo nuk mund të fragmentohet në “kishë katolike shqiptare.”

Doktrina e katolicizmit buron nga Bibla, nga traditat dhe nga koncilet e Kishës, jo nga praktika a histori kombëtare shqiptare. Këtë doktrinë nuk mund ta ndryshojnë konvertitët e organizimeve të sotme hibride, si “Lëvizja e Deçanit.”

Një pjesë e kombit shqiptar i përkasin këtij besimi, por numri i tyre është pothuajse simbolik në kuadër të një miliardë e gjysmë katolikëve anekënd planetit. Kontributi atdhetar i klerikëve dhe besimtarëve katolikë shqiptarë brenda kombit tonë shqiptar është pjesë përbërëse e lëvizjeve tona kombëtare, kulturore dhe politike. Por, si në rastin e komuniteteve të tjera fetare, ajo e ka burimin te ndjenjat kombëtare, te ideologjia kombëtare, te zhvillimet historike, e jo te doktrina katolike, si e atillë.

Kisha Katolike ka hequr dorë nga konvertimet me dhunë dhe ka shpallur ekumenizmin dhe dialogun ndërfetar dhe tolerancën me besimet e tjera fetare. Prandaj, askush nuk ka të drejtë që në emër të saj të kërkojë konvertime me dhunë në Kosovë. Në këtë kontekst, është koha e fundit që vetë Selia e Shenjtë ta shprehë një qëndrim të qartë ndaj organizimeve hibride si “Lëvizja e Deçanit”, e cila fton në konvertim me dhunë në emër të

**Kisha Katolike
ka hequr dorë
nga
konvertimet
me dhunë dhe
ka shpallur
ekumenizmin
dhe dialogun
ndërfetar dhe
tolerancën me
besimet e tjera
fetare.
Prandaj,
askush nuk ka
të drejtë që në
emër të saj të
kërkojë
konvertime
me dhunë në
Kosovë.**

katolicizmit. Dhe është koha që shteti i Vatikanit ta njohë Kosovën si shtet të pavarur, me çka do të qartësohej plotësisht se kush flet në emër të katolicizmit lidhur me Kosovën dhe banorët e saj.

Sidoqoftë, edhe pa atë njohje zyrtare, mund të thuhet se kërkesat e “Lëvizjes së Deçanit” për kthim nga Islami në katolicizëm, janë në kundërshtim me strategjinë e Vatikanit për dialog dhe tolerancë me Islamin. Tendencat e “Lëvizjes së Deçanit” janë më shumë të lidhur me kohën e rekonkuistës, kur Kisha bënte kthimin me dhunë në katolicizëm. E dyta, theksimi i aspektit nacional nga “Lëvizja e Deçanit”, ka afri me doktrinën e Kishës Ortodokse Serbe, e cila e thekson identitetin nacional. Prandaj, gjasat janë se kjo lëvizje është më shumë brenda konceptit të Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa katolicizmin e përdorë si maskë për të mashtruar.

E fundit në këtë shënim: besimtarët katolikët shqiptarë janë pjesëtarë të nderuar të kombit tonë shqiptar dhe janë jashtë kësaj lëvizjeje të çoroditur. Deri sot nuk është asnjë rast që ndonjë katolik tradicional të jetë përfshirë në këtë lëvizje (përveç personelit në dy-tre kisha.) Rrjedhimisht “Lëvizja e Deçanit” nuk ka të bëjë me kthim në katolicizëm, aq më pak me forcimin e shqiptarizmit. Ideja e tyre qendrore është pikërisht dobësimi i shqiptarizmit në Kosovë, sepse pa dobësimin e shqiptarizmit në Kosovë, nuk mund të kthehet ndikimi i Serbisë në Kosovë. Ndërsa dobësimi i shqiptarizmit në Kosovë nuk mund të ndodhë pa u dobësuar identiteti islam i shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Identiteti ynë islam ka qenë dhe është në konflikt me ortodoksinë serbe, që nga koha kur edhe kalimi masiv i shqiptarëve në Islam ka qenë në të vërtetë ikje nga gllabërimi nga pretendimet gllabëruese të Kishës Ortodokse Serbe, për t'i kthyer shqiptarët ortodoks në serbë. Kjo është edhe sot fusha e betejës ndërmjet shqiptarëve e serbëve në Kosovë.

Fryma e munguar romantike dhe propaganda e gjallë ideologjike antikombëtare

Besnik Jaha

Dua ta nis këtë shkrim me një shpresë të singertë: që ky diskutim të mbetet pikërisht aty ku i takon, në rrafshin profesional, historik dhe akademik. Në planin personal nuk kam asnjë fije polemike me asnjë – përkundrazi, ruaj respekt për secilin. Mirëpo, pikërisht sepse e vlerësoj mendimin kritik, e ndiej domosdoshmërinë të kundërshtoj disa nga tezatzat e shprehura së fundmi rreth “pamjes” së identitetit

kombëtar, e të cilat, sipas mendimit tim, prodhojnë një pasqyrë të cunguar të historisë së shkrimit shqip (e, sidomos të letërsisë), dhe bien ndesh me frymën e unitetit që kanë ndërtuar rilindësit tanë.

Pra, diskutimet kinse të “protektorëve të kombëtarisë”, sikurse rasti i profesor Blerim Latifit dhe të atyre që mendojnë si ai, janë një rikthim i vjetruar te narracioni romantiko-



klerikal i historiografisë së viteve '80'-60, që si i tillë e ka "ndërtuar" kombin shqiptar duke e ndarë në "fisnikët që shkruan" dhe "të tjerët që rrinë në hije"; "ala turkët" dhe "ala frëngët"... Ky është një diskurs që sot s'pi më ujë, as ideologjikisht, as shkencërisht. Dhe, është e çuditshme që një profesor si Latifi (si njohës i historisë së filozofisë), në shekullin XXI, ende ushqehet akoma me këtë model linear, sikur jeta kulturore shqiptare të ketë qenë monopol i një pale; sikur jeta kulturore shqiptare të kishte qenë kanali i vetëm i një feje, dhe të gjithë të tjerët të mbeteshin jashtë orbite, gati si hije; sikur përbërja jonë kombëtare, kjo simfoni e shumëbesimisë, mos të ishte siç është; sikur letërsia shqiptare, me gjithë peshën e saj prej shekujsh, të ishte e lexueshme vetëm nga një kënd i vetëm, duke harruar horizontin e plotë; sikur kultura kombëtare të ishte përbërë kaq formalisht...

Dhe, më lejoni të shtoj edhe këtë: ndonjëherë, kur i lexojmë a shikojmë reagimet e tyre, ku vlera kulturore shqiptare paraqitet si pronë ekskluzive e njërit krah, në këtë rast katolik, siç bën shpura e profesor Latifi dhe e grupeve hibride antishqiptare, si e ashtuquajtura "Lëvizja e Deçanit", çuditërisht, më ngjajnë aspak profesionale, tepër të varfra, e, ndoshta edhe tendencioze e në shërbim të një ideologjie aspak në dobi të kombit. Ja, në vazhdim po mundohem t'i zbërthej më hollësisht disa dëshmi:

- Kulturën kombëtare e gjykojnë njëanshëm, sikur veprat, shkollat, alfabetet, përkthimet, abetaret, fjalorët, poezitë dhe traktatet e rilindësve të tjerë mos të kishin ekzistuar kurrë;

- Flasin sikur kultura kombëtare të ishte ndërtuar aq formalisht, aq thjesht, aq në mënyrë lineare, me një vijë të drejtë nëpër shekuj, ndërkohë që realiteti ynë historik ka qenë një mozaik shumëngjyrësh, i përzier, i gjallë, ku secila fe dhe secili grup ka vënë nga një gur në murin e quajtur komb.

- Gjykojnë sikur hoxhallarët shqiptarë mos të kishin shkruar asgjë që nga viti 1389 deri në shekullin XVIII-XIX, edhe pse, pikërisht besimi islam, urdhëron leximin (studimin, shkollimin) si imperativ kuranor i zbritur apriori (shto këtu edhe faktin se gjithë dëshmitë e shkrimit shqip janë pas ardhjes së turqve në Ballkan-1389, pasi më parë romakët e ndalonin me ligj shkrimin shqip, e që i bie

se turqit krijuan atmosferë për zhvillimin e shqipes dhe kulturës shqiptare edhe mes të krishterëve);


- Mbajnë një pozicion sikur medresetë mos të kishin prodhuar qindra njerëz të dijes, që ishin po aq shqiptarë sa priftërinjtë e kolegjeve sipas akëcilëve urdhra katolikë (franceskanë, jezuitë, dominikanë...), ndërsa nuk konsultojnë fare referencat nga burime relevante (ja vetëm disa: Is'hak Çelebiu (vd. 1536), Sihri-u, Valihî (vd. 1599), Vusûlî (vd. 1592), dhe Zârî, të lindur në Shkup; Bahârî (v. 1551), Mumin-i, Nehârî (vd. 1523), Sûzî-u (v. 1525), Shemi-u (v. 1530), Ashik Çelebi-u (vd. 1572) dhe Texhelli (vd. 1688) nga Prizreni; Mesihi Prishtinaliu (vd. 1512), Behari Prishtinaliu (vd. 1531), pastaj vëllezërit Azmi, Levhi-u dhe Nuhi-u, që krijuan në shek. XVI, pastaj Hatifi dhe Mustafa Çelebiu (vd. 1565) nga Prishtina; Suxhudi-u, Fakiri, Tului-u (1520-1572); Muidi-u (vd. 1585), Sersem Ali Dede (shek. XVI) nga Tetova; Arshi-u (vd. 1570), Hulusi-u, Nimeli-u (vd. 1603), Vali-u (vd. 1598) dhe Vahdeti-u nga Jeni Pazari; Bahari-u, Xhevani-u, Nazif-i, Rumuzi-u dhe Salahi-u nga Tërhallaja; Jahja Bej Dukagjini (i njohur tashmë edhe në studimet shqipe të vona); Vexhhi-u (vd. 1670) nga Dibra; Sabri Kruja (vd. 1607) nga Kruja; si dhe poetët Ayani-u, Xhelal Beu, Firdevsi (vd. 1564), Hafiz, Haveri (vd. 1565), Katibi-u, Keshfi-u, Mehmedi, Merdi-u, Sabaji-u, Sami-u, Sezaji-u, Sinani, Vahji-u (vd. 1546), Vezni-u (vd. 1578) dhe Zuhuri-u, të lindur në Manastir; Nihani Arnauti (vd. 1519), Ahmet Bej Dukagjini (vd. 1557), Lutfi Pashë Shkodra (vd. 1563), Lali Berati (shek. XVI), Dervish Osman Elbasani (vd. 1640), si dhe shumë të tjerë); (më falni se ju lodha, po lista shkon shumë-shumë gjatë, ndërsa në disertacionin tim, sapo të botohet, mund t'i gjeni qindra emra).

- Pastaj, flasin sikur Muhamed Çami mos ta kishte shkruar veprën e parë shqipe me personazh femër (fiktiv) – Erveheja;

- Sikur Nezim Berati mos të kishte shkruar librin e parë me poezi në shqip, Divani-n - 1735-1736, rreth 27 vjet para Jul Varibobës - 1762 – "Gjella e Shën Mërisë Virgjër".

- Sikur Ibrahim Shahidi Dede (nga Mugla, i cili në vitin 1514 kishte përpiluar një fjalor me mijëra fjalë, të titulluar "Tyhfei Shahidi" - "Dhurata e Shahidit", rrafsh 121 vjet para Frang Bardhit (1635), mos të kishte ekzistuar fare;

Kulturën kombëtare e gjykojnë njëanshëm, sikur veprat, shkollat, alfabetet, përkthimet, abetaret, fjalorët, poezitë dhe traktatet e rilindësve të tjerë mos të kishin ekzistuar kurrë.



- Sikur Hasan Tahsini mos të kishte hartuar alfabet;
- Sikur Daut Boriçi mos të kishte hapur shkolla shqipe, sikur Hasan Prishtina mos të kishte shkruar gjithë ç'pati për arsimin shqip;
- Sikur Said Najdeni e Hafiz Ali Korça mos të kishin shkruar abetare dhe tekste shqipe;
- Sikur Rexhep Voka e Qamil Bala mos të kishin punuar për arsim shqip, e Vehbi Dibra – Agolli mos të kishte qenë fare faktor kyç në pavarësinë e Shqipërisë;
- Sikur...; sikur...; sikur...

Mos të harrojmë se romantikët tanë kombëtarë nuk kanë bërë kurrë përçarje konfesionale, sikur nxitin këta, si një thirrje e lëvizje më antikombëtare që nga Rilindja Kombëtare e gjer më sot! Fryma romantike nuk ka qenë as rreshtimi i shqiptarëve sipas kishave e xhamive, as ndërtimi i hierarkive kulturore me parimin “katolikët bënë gjithçka, të tjerët asgjë”. Përkundrazi, ai brez – Naimi, Samiu, Kristoforidhi, Çajupi, Fishta, Mjeda – jetonte me një ideal: kombi shqiptar është mbi çdo ndarje. E, po ky ideal i tyre sot po sulmohet e luftohet. E, po këta sot po bëjnë të kundërtën: po e “konfesionalizojnë” historinë e shkrimit shqip dhe të kulturës kombëtare, e që, në fakt, është krejt kundër frymës së rilindësve e vlerave kombëtare.

Romantikët tanë mund të kishin thënë një gjë fare të thjeshtë: Nëse e sheh kombin me sy

kishtar, nuk ke kuptuar asgjë nga ringjallja kombëtare. Sepse, ideali romantik qe: “për atdheun të gjithë japim gjithçka”.

Mos të harrojmë se romantikët tanë kombëtarë nuk kanë bërë kurrë përçarje konfesionale, sikur nxitin këta, si një thirrje e lëvizje më antikombëtare që nga Rilindja Kombëtare e gjer më sot!

Gjithashtu, narracioni që përsërisin është i vjetër dhe i përgënjeshtuar tashmë (le të hulumtojnë më thellë, sepse u takon). Narrativa në të cilën mbështeten i merr faktet nga historiografia zyrtare, e cila, për dekada të tëra, për arsye ideologjike, i ka ngritur në kult disa figura (kryesisht katolike) – jo se nuk meritojnë vlerësim, por sepse u anashkalua sistematikisht kontributi i dijetarëve myslimanë, bejtexhinjve, hoxhallarëve rilindës, medreseve dhe letërsisë së tyre. Hera e parë, pas shumë vitesh, që po më bie të shoh dikë duke u mburrur me këtë narracion, i cili vetëm se është shembur, sepse është e pamundur të mbulohen me pluhur arkivat. Gjysma e historisë së shkrimit shqip ka qenë fshehur. Jo se mungonte, por “nuk duhej të dukej”.

Po, katolikët kanë kontribuar jashtë-zakonisht. Mirëpo, jo vetëm ata. Kjo është e vërtetë, e njohur, dhe askush s'mund ta hedhë poshtë. Ndërsa, këta po bëjnë një propagandë, dhe një të vërtetë po pretendojnë ta kthejnë në monopol. Dhe, kur një e vërtetë kthehet në monopol, dihet se ajo bëhet propagandë. Unë nuk besoj se nuk e dinë se në të njëjtën kohë dijetarët myslimanë, historia jonë “zyrtare”, i ka lënë jashtë, madje qëllimshëm.

Disa nga shembujt e mësipërm e të qartë, me vepra konkrete – jo mite, besoj se mjaftojnë. Pra, dihet mirë se historiografia jonë ka filtruar sipas fesë. Sigurisht, dihet po ashtu se historiografia jonë është “kastruar” sipas bindjeve ideologjike e konfesionale. Ja një shembull: në Ministrinë e Kulturës, në Prishtinë, korridoret i ke të monopolizuara me figura kombëtare katolike (prapë po e them, jo se nuk e meritojnë), ndërsa mungojnë qoftë edhe figurat që i lindi Prishtina, sikurse, për shembull: Mesih Prishtinaliu, Behari Prishtinaliu, Ashik Çelebiu (që për një kohë jetoi në Prishtinë e punoi si gjykatës), apo edhe të vonshmit, Hoxhë Kadri Prishtina etj..

PO, PSE PO NDODH KJO?

Sepse për dekada të tëra u krijua një “panteon zyrtar” i dijetarëve të pranueshëm e të “pagabueshëm”. Dhe kështu, dijetarët myslimanë, sidomos ata me rol publik, u lanë jashtë sepse nuk i përshtateshin kriterit të ri: kombëtarist + laik + i përdorshëm politikisht. Dhe, kështu sot jemi viktimë e atij narracioni propagandues. Pra, kjo është arsyeja pse thirrjet dhe reagimet e Latifit dhe “Lëvizjes së Deçanit” janë thjesht përmbledhje e një narracioni të vjetër, ndoshta edhe një bindje e gabuar, dhe jo produkt i një kërkimi serioz shkencor-akademik. Thënë troç, ka plot dëshmi, shkrime e fotografi, dorëshkrime e raporte në arkiva, që dëshmojnë se ka njëanshmëri dhe, nuk dua ta besoj, por reflekton, edhe qëllim të keq. Pra, ka plot fotografi ku shihen hoxhallarë, dijetarë, hafëzë – njerëz të shkolluar, të organizuar, të zgjuar – pjesë e një tradite intelektuale që ka ekzistuar paralel me vëllezërit tanë nga gjaku-katolikët. Dhe, ata ishin njerëz që merreshin me arsim, administratë, gjuhë, medrese, librari, shkolla private, botime, dhe nuk ishin “gjeth në erë”, siç shpesh i ka vizatuar historiografia shqipe. Siç po kjo historiografi dhe “argatët e saj” sot po e prishin frymën romantike të kombit, kaq të nevojshme në këtë kohë për shqiptarët.

Romantikët tanë, sidomos ata të fundit të shek. XIX, ishin një kor polifonik. Jo si ne sot.

Atëbotë myslimanët, katolikët, ortodoksët, ateistët, me një fjalë të gjithë, bejlerë, poetë, klerikë, arsimtarë, dervishë, myderrizë, të gjithë punuan që shqipja të bëhej gjuhë kombi, dhe kombi të bëhej i fortë e një. Prandaj, qëndrimi ndryshe bie ndesh me frymën romantike që ndërtoi kombin shqiptar. Pra, qëndrimi ndryshe është antikombëtar.

Mos të harrojmë se romantikët tanë nuk bënë kurrë hierarki fetare në historinë e kulturës kombëtare. Ky është konstrukt i historiografisë ideologjike (koçobihikiane), e që sot po rrëshqet dita ditës, sepse faktet janë më të forta se narrativat propagandë.

Po ashtu, mos të harrojmë se myslimanët shqiptarë gjithmonë i çmuan priftërinjtë katolikë për kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë – askush nuk e mohon (një



hoxhë qante derisa lexonte fjalimin në varrimin e Gjergj Fishtës). Mirëpo, historia që prezantohet sot prej kësaj lëvizjeje, është vetëm gjysma e së vërtetës, e gjysma tjetër është lënë jashtë për arsye që s’kanë lidhje me shkencën. Dhe, si një profesor universitar, Blerim Latifi nuk duhet t’u shërbejë narracioneve të gabuara e ideologjive kundërkombëtare, si një që reflekton nga reagimi i tij i fundit për Ditën e Alfabetit. Sepse, myslimanët kanë qenë pjesë e pandashme e kulturës shqiptare, e sidomos e rilindjes sonë, mirëpo historiografia që citohet sikur i ka lënë në hije, sepse nuk i përshtateshin modelit të ndërtuar ideologjikisht.

Kombi shqiptar është vepër e të gjithëve. Kush zgjedh ta shohë vetëm nga një dritare, e humb pamjen e plotë e të bukur që ka shqiptaria.

Po e mbyll këtë shkrim me dëshirën që t’i rikthehemi qetësisë së dijes, dhe jo zhurmës së narracioneve të trashëguara ideologjike e përçarëse.

Jeta virtuale – një portë drejt lajthitjes së brezit të ri

Nada Dosti

Më 2 dhjetor 2024, “Oxford University Press” shpalli fjalën e vitit termin “*Brain rot*” (fjalë për fjalë “*kalbëzimi i trurit*”). Përdorimi i këtij termi është rritur me 230 për qind midis viteve 2023 dhe 2024. Po pse “*Brain rot*”? Vetë “Oxford University Press” e ka përkufizuar atë si: “Përkeqësimi i supozuar i gjendjes mendore ose intelektuale të një personi, veçanërisht si pasojë e konsumimit të tepruar të materialeve (tani sidomos përmbytjes online), që konsiderohen të parëndësishme ose të lehta (jo impenjuese).” Ekspertët kanë vërejtur se termi “*Brain rot*” ka marrë një jehonë të re kohët e fundit, duke shprehur shqetësimet rreth ndikimit të konsumimit të tepërt të përmbytjeve me cilësi të ulët në internet, sidomos në rrjetet sociale. Dhe me “cilësi të ulët” këtu nënkuptojmë informacione jo të dobishme, akte dhe veprime që nuk përfaqësojnë asgjë, as mësojmë gjë të re por as nuk argëtoheni.

Por, kur ka ndodhur përdorimi i parë i shprehjes “*Brain rot*”? “Oxford University Press” shpjegon se ky term daton në vitin 1854, në librin “*Walden*” të Henry David Thoreau, i cili përshkruan përvojat e tij të jetesës së thjeshtë në natyrë. Në përfundimet e tij, Thoreau kritikon prirjen e shoqërisë për të nënvlerësuar idetë e ndërlikuara, ose ato që mund të interpretohen në mënyra të ndryshme, në favor të ideve të thjeshta, dhe e sheh këtë si një tregues të një rënieje të përgjithshme të përpjekjes mendore dhe

intelektuale: “Ndërsa Anglia përpiqet të shërojë kalbëzimin e patates, a nuk do të duhej ndokush të përpiqej të shërojë kalbëzimin e trurit, që përhapet shumë më gjerësisht dhe më vdekjeprurës?” Kur kjo shprehje në mes viteve 800, çfarë duhet të themi atëherë për realitetin e sotëm?

PËRSE PO NDODH KALBËZIMI I TRURIT?

Për ta kuptuar efektin e kalbëzimit të trurit na vjen në ndihmë Neuroshkenca dhe studimet e rrjeteve sociale. Duke kuptuar mirë si funksionon veprimtaria e trurit të njeriut bashkë me politikat e rrjeteve sociale, mënyra se si këto të fundit janë dizajnuar dhe se si veprojnë duke përfshirë këtu rolin e madh që algoritmet kanë, mund të arrijmë t’i japim një kuptim të gjithë këtij fenomeni që po ndodh në ditët e sotme.

Një studim i titulluar “*Të rrëmbyer nga përmbytja: Anhedonia (humbja e aftësisë për të gjetur kënaqësi në jetën reale) digjitale e shkaktuar nga neuroinxhinieria e rrjeteve sociale*”, shpjegon se si platformat e rrjeteve sociale janë kthyer në një hapësirë hiper stimuluese, që bën të angazhohet pjesa e vëmendjes dhe e shpërblimit në trurin e njeriut. Studime të shumta tregojnë ecurinë e rënies së përqendrimit tek individët me kalimin e kohës. Për shembull ky lloj përqendrimi ka qenë i qëndrueshëm për 8 minuta, më pas ka rënë në 3, më pas në 1 minutë, dhe tashmë deri në 30 sekonda dhe në rastin më ekstrem 3 sekondat e para.

Përqendrimi ka qenë i qëndrueshëm për 8 minuta, më pas ka rënë në 3, më pas në 1 minutë, dhe tashmë deri në 30 sekonda dhe në rastin më ekstrem 3 sekondat e para.



Përfundimet në studimin në fjalë tregojnë se një përdorim i tepruar i rrjeteve sociale lidhet fort me ndryshime strukturore dhe funksionale të trurit në rajone përkatëse, të lidhura me rregullimin e emocioneve, kontrollin e impuleseve dhe aftësitë sociale konjitive. Përfundimet në fjalë janë një thirrje e fuqishme për ta trajtuar varësinë nga rrjetet sociale si një faktor rrezikues neurologjik, pra jo vetëm lidhur me sjelljet, por edhe me ndjesitë, mendimet dhe aftësitë neurologjike. Një tjetër studim i titulluar “Lufta për vëmendjen njerëzore: Midis abuzimit të rrjeteve sociale dhe mirëqenies digjitale”, fokusohet në faktin se si vëmendja e përdoruesve kthehet në një shënjestër për ekonominë digjitale, kjo për arsye se përmbajtja, algoritmi dhe dizajnimi i rrjeteve sociale janë të formësuar në të tilla mënyra për ta gllabëruar vëmendjen. Përfundimi i studimit në fjalë tregon se si truri ynë manipulohet dhe trajnohet në të tilla mënyra për t’u përgjigjur në forma të caktuara ndaj stimujve për të tërhequr vëmendjen tonë, gjë e cila lidhet fort me kalbëzimin e trurit. Sepse nëse aftësia për t’u përqendruar te një përmbajtje në rrjetet sociale, e cila është tërheqëse, argëtuese dhe nxit dopaminë, atëherë si mund të përqendrohet truri teksa lexon një libër apo dëgjon një audiolibër. Dhe nëse arrin të përqendrohet, sa do të zgjas ky përqendrim?

Rrjetet sociale nuk janë thjesht argëtuese, apo kalim kohe, janë mekanizma që çorientojnë valët e trurit, duke i dëmtuar ato valë të cilat janë përgjegjëse për pushimin, përqendrimin dhe vetërregullimin.

Një tjetër studim, “Euforia e kohëve moderne: Ndikimi neurokonjitiv i përdorimit të rrjeteve sociale”, dëshmon për ndryshimin në valët e trurit pas përdorimit të rrjeteve sociale, më konkretisht, rënie të valëve alfa, që lidhen ngushtë me sinjale qetësimi dhe pushimi konjitiv, dhe rritje të valëve beta/gamma, të cilat lidhen me sinjale shqetësim të niveli të lartë apo mbistimulimit. Përfundimi i këtij studimi tregoi se rrjetet sociale nuk janë thjesht argëtuese, apo kalim kohe, janë mekanizma që çorientojnë valët e trurit, duke i dëmtuar ato valë të cilat janë përgjegjëse për pushimin, përqendrimin dhe vetërregullimin.

Dy studime nga më shqetësueset janë “Ndikimi i mediave sociale në zhvillimin njohës të fëmijëve dhe të rinjve: Një rishikim sistematik” si dhe “Efektet e kohës së tepërt para ekranit në zhvillimin e fëmijës: Një rishikim i përditësuar dhe strategjitë e menaxhimit”. Të dy këto studime fokusohen në brezin e ardhshëm të fëmijëve dhe adoleshentëve të sotëm. Rreziku që i kanoset këtij brezi, ndryshe nga brezi ynë ndoshta, ka të bëjë së pari me kohën e kaluar në rrjetet sociale, që sipas këtyre dy studimeve është shumë herë më e lartë se sa koha që kalon një i rritur, i cili ka edhe shumë angazhime të tjera, si dhe me përdorimin që i bëjnë rrjeteve sociale. Për ta ilustruar më mirë këtë, mund të marrim shembullin e një prindi, i cili teksa



është i zënë duke vozitur për të marrë dhe çuar fëmijët nga shkolla, ndërkohë çfarë bën fëmija në sediljen pas? Nga ana tjetër, nëse një i rritur hyn në youtube për të ndjekur një podcast apo ligjëratë të dobishme në formatin e videove të gjata, një fëmijë apo adoleshent ka më shumë gjasa të shohë ndonjë short ku probabiliteti është që në vend të ndonjë recete gatimi apo këshilla mjekësore, të shfaqet ndonjë qen apo mace, dhe në rastin më të keq një bashkëmoshatar që vepron ndonjë marrëzi.

Si përfundim, këto dy studime të fundit, të fëmijët dhe të rinjtë, i vënë kapakun ndikimit që ekspozimi i tepruar ndaj rrjeteve sociale është e lidhur ngushtë me mungesë përqendrimit, mungesës të mbajtjes mend (të mësuarit përmendësh) si dhe aftësisë për të marrë vendime (prandaj dhe sa vjen pyesin edhe më shumë ChatGpt për vendime që duan të marrin).

ZGJIDHJE E MUNDSHME

Është lehtë të thuash: mjafton të largohemi apo të heqim dorë nga rrjetet sociale dhe interneti, mirëpo ditët e sotme një gjë e tillë është thuajse e pamundur. Megjithatë, mund të minimizohet përdorimi dhe mund të kthehet në një përdorim të moderuar duke ndërmarrë disa vendime.

Përdorimi me vetëdijesim: Një përdorim i moderuar i rrjeteve sociale duke ushtruar te vetja fuqinë për të kontrolluar instinktet tona, duke mos lejuar të krijojmë varësi prej tyre, por të jemi ne vetë në gjendje për t'u kyçur dhe çkyçur kur duam ne, pa rënë pre e varësisë. Të marrim çka na duhet nga

rrjetet sociale, si komunikimi me miq të largët, mesazhe pozitive, informacione të dobishme, dozë motivimi, këshilla për blerje etj., pa lejuar që të kthehemi në shopoholic (të varur nga blerjet); pa rënë në binge scrolling (endje nëpër rrjete sociale pa ndonjë qëllim të caktuar pa vërejtur kalimin e kohës); dhe mbi të gjitha pa krijuar varësi dhe pa na u kalbur truri.

Detox: idealja do të ishte që vetes t'i caktojmë një kohë në ditë, një ditë në javë, disa ditë në muaj dhe një muaj në vit që të largohemi totalisht nga rrjetet sociale dhe interneti. Kohë të tilla mund të jenë një periudhë e mirë e testimi të vetes se sa gjatë mund të rrimë larg dhe deri në çfarë doze ka arritur varësia jonë, dhe sipas asaj të punuarit me veten. Si myslimanë, periudha të tilla kohore mund të jenë ditën e xhuma në kohën e drekës, ditë jave mund të jenë e xhumaja, ose e hëna dhe enjtja, një muaj në vit mund të jetë Ramazani.

Marrja e dopaminës nga burime të tjera: Ka plot burime natyrore nga të cilat mund të merren doza dopamine, duke filluar nga disa ushqime specifike, rrezet e diellit, ecja këmbëzbathur dhe kontakti me natyrën, ushtrime fizike si ecja, vrapi, ushtrime fizike dhe shpirtërore si namazi, agjërimi, pastaj meditimi, leximi apo memorizimi i Kuranit, një përqafim, këmbim dhuratash, kohë me miq dhe familjarë, realizimi i një ëndrrë apo objektivë etj., etj..

“Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat stabilizohen.” (Er Rad, 28)

Burimet:

- Giraldo-Luque, S., Afanador, P. N. A., & Fernández-Rovira, C. (2020). The struggle for human attention: Between the abuse of social media and digital wellbeing. *Healthcare*, 8(4), 497. <https://doi.org/10.3390/healthcare8040497>
- Heaton, B. (2025, June 26). 'Brain rot' named Oxford Word of the Year 2024. Oxford University Press. <https://corp.oup.com/news/brain-rot-named-oxford-word-of-the-year-2024/>
- Kuran (Rad, Vol. 28). (n.d.).
- Lakhan, S. E. (2025). Hijacked by the feed: Social Media Neuro-engineering-Induced Digital Anhedonia. *Cureus*, 17(4), e83256. <https://doi.org/10.7759/cureus.83256>
- Muppalla, S. K., Vuppalapati, S., Pulliahgaru, A. R., & Sreenivasulu, H. (2023). Effects of Excessive screen time on Child Development: An Updated review and Strategies for Management. *Cureus*, 15(6), e40608. <https://doi.org/10.7759/cureus.40608>
- Naik, V. S., Mathias, E. G., Krishnan, P., & Jagannath, V. (2025). Impact of social media on cognitive development of children and young adults: a systematic review. *BMC Pediatrics*, 25(1), 826. <https://doi.org/10.1186/s12887-025-06041-5>
- Satani, A., Satani, K. K., Barodia, P., & Joshi, H. (2025). Modern Day High: The Neurocognitive impact of social media usage. *Cureus*, 17(7), e87496. <https://doi.org/10.7759/cureus.87496>

Rrënjosja e virtyteve etike te fëmijët në mes psikologjisë dhe Islamit

Adlie Morina-Krasniqi

Rrënjosja e virtyteve etike dhe morale te fëmijët përbën gurthemelin e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë dhe funksionale. Kjo temë ka qenë historikisht një pike qendrore, si në aspektin fetar ashtu edhe në shkencat bashkëkohore. Këto dy këndvështrime kryesore, edhe pse të ndryshme, kanë shumë pika të përbashkëta thelbësore. Teksa psikologjia, me studimet e saj mbi zhvillimin kognitiv (Piaget) dhe moral (Kohlberg), ofron korniza shkencore dhe mjete praktike për kuptimin e sjelljes, motivimit dhe emapatisë te fëmijët, Islami ofron një kornizë të plotë shpirtërore dhe etike (Akhlaq), duke e parë fëmijën si një amanet dhe duke theksuar natyrshmërinë e tij të pastër (Fitra). Kjo punë synon të eksplorojë dhe të integrojë këto dy qasje, duke vënë në pah se si parimet islame të edukatës (si shembulli personal i prindërve dhe mësimi i vlerave përmes Kuranit dhe Sunetit) mund të forcohen dhe të zbatohen në mënyrë efektive, duke përdorur njohuritë e ofruara nga psikologjia bashkëkohore (si përforcimi pozitiv, zhvillimi i empatisë dhe roli i lidhjes prind-fëmijë). Në thelb, objektivi është të zbulojmë metodologjinë më të mirë të integruar, e cila i pajis fëmijët me një moral të lartë, duke i bërë ata individë të përgjegjshëm dhe të dobishëm si për veten, ashtu edhe për ymetin dhe shoqërinë në tërësi.

VIRTYTET DHE ZHVILLIMI MORAL NË PSIKOLOGJI

Procesi i ngulitjes së virtyteve etike te fëmijët nga një perspektivë psikologjike është një proces kompleks që

përfshin ndërveprimin e faktorëve të ndryshëm biologjikë, mendorë dhe socialë. Virtytet morale nuk janë thjesht të trashëguara gjenetikisht, por zhvillohen përmes një kombinimi të përvojave personale, mësimi social dhe ndikimeve kulturore. Psikologjia thekson rëndësinë e mjedisit familjar dhe shkollor në formësimin e këtyre virtyteve, ku fëmijët mësojnë të dallojnë mes të mirës dhe të keqes përmes shembullit, diskutimeve dhe përforcimit të sjelljeve etike. Ky zhvillim moral është një proces i vazhdueshëm, i cili përparon nëpërmjet fazave të ndryshme





të rritjes, duke u thelluar dhe konsoliduar me kalimin e kohës.

Zhvillimi i virtyteve etike lidhet ngushtë me zhvillimin njohës dhe emocional të fëmijës. Aftësia për të kuptuar perspektivat e të tjerëve, empatia dhe kontrolli i impulseve janë elementë kyçë që ndihmojnë në ndërtimin e një baze të fortë morale. Hulumtimet tregojnë se fëmijët që rriten në një ambient ku vlerat etike komunikohen qartë dhe praktikohen në mënyrë të qëndrueshme, kanë më shumë gjasa të zhvillojnë virtyte të qëndrueshme morale. Kjo ndihmon në ndërtimin e karakterit dhe sjelljeve, që promovojnë përgjegjshmërinë sociale, drejtësinë dhe respektin ndaj të tjerëve gjatë gjithë jetës së tyre. (Miller, 2007).

Metodat edukative, si: modelimi moral dhe angazhimi i fëmijëve në aktivitete morale, luajnë role vendimtare në këtë proces zhvillimor. Modelimi moral përfshin fëmijët që vëzhgojnë dhe imitojnë sjelljen etike të shfaqur nga të rriturit, gjë që i ndihmon ata të mësojnë dhe të përvetësojnë virtytet. Pjesëmarrja në diskutime dhe aktivitete etike u lejon fëmijëve të praktikojnë arsyetimin moral dhe të zhvillojnë empatinë, duke i mundësuar ata të marrin në konsideratë

Hulumtimet tregojnë se fëmijët që rriten në një ambient ku vlerat etike komunikohen qartë dhe praktikohen në mënyrë të qëndrueshme, kanë më shumë gjasa të zhvillojnë virtyte të qëndrueshme morale.

perspektivat dhe ndjenjat e të tjerëve. (Walker, 2023).

Psikologjia pozitive ofron më tej njohuri se si virtytet dhe pikat e forta të karakterit mund të kultivohen te fëmijët. Këto pika të forta përfshijnë cilësi si: mirësia, drejtësia dhe guximi, të cilat njihen në të gjitha kulturat dhe kontribuojnë në zhvillimin moral të karakterit. Inkurajimi i fëmijëve për t'i praktikuar këto pika të forta të karakterit mund të rrisë ndjenjën e tyre të empatisë dhe përgjegjësisë morale, të cilat janë komponentë thelbësorë të vendimmarrjes etike. (Baer, 2015).

Për më tepër, edukimi i karakterit duhet të marrë në konsideratë edhe ndikimet shoqërore në zhvillimin e virtytit. Të kuptuarit se si praktikatat e komunitetit, normat shoqërore dhe prejardhjet kulturore ndikojnë në rritjen morale është thelbësore. Sociologjia e Bourdieu thekson se kontekstet shoqërore mund të formësojnë perceptimet dhe vlerat individuale, dhe përfshirja e këtij kuptimi në edukimin e karakterit mund të ofrojë një qasje më të nuancuar për kultivimin e virtyteve. (Walker, 2023).

Motivimi moral luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e sjelljes etike. Teori të ndryshme etike, të tilla si etika e virtytit, etika deontologjike dhe utilitarizmi, ofrojnë korniza për

motivimin moral, duke theksuar pse veprimet duhet të jenë moralisht të drejta. Këto korniza ofrojnë arsye të ndryshme për sjelljen morale, të cilat janë të rëndësishme në hartimin e programeve të përshtatshme etike edukative për fëmijët, duke promovuar virtyte si ndershmëria, empatia dhe përgjegjësia. (Colle dhe Werhane, 2007). Motivimi moral është thelbësor për nxitjen e sjelljes etike, pasi ai përfshin arsyet dhe qëllimet që udhëheqin individët drejt veprimeve të drejta dhe të moralshme. Etika e virtytit fokusohet në ushqimin e tipareve morale të ndjeshme, si: mirësia, ndershmëria dhe guximi, të cilat janë të vendosura si udhërrëfyese për vendimmarrjen dhe ndryshimin e gjatë gjithë jetës. Kjo qasje thekson rëndësinë e përvetësimit të këtyre virtyteve që në fëmijëri, pasi ato formojnë bazën për qëllimet dhe vlerat morale të individit. Në këtë mënyrë, virtyti nuk është vetëm një koncept abstrakt, por një element praktik që është në lojë kur personi ndërvepron me botën dhe zhvillon karakterin e tij. Teoritë etike të ndryshme ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi natyrën e moralitetit dhe mënyrën se si motivimi mund të formësojë sjelljen njerëzore. Për shembull, etika e virtytit përqendrohet në zhvillimin e karakterit dhe virtyteve personale si ndershmëria dhe empatia, duke theksuar rëndësinë e brendshme të veprimit të mirë. Ndërkohë, etika deontologjike fokusohet në detyrat dhe rregullat morale, që duhet të ndiqen pavarësisht pasojave, duke nxitë veprime të drejta për arsye detyre. Utilitarizmi, nga ana tjetër, vlerëson veprimet sipas pasojave të tyre, duke synuar maksimizimin e lumturisë ose përfitimit për shumicën.

Teoria sociale njohëse e moralit, për shembull, thekson se si sjellja etike mund të mësohet përmes modelimit dhe përforsimit. Duke vëzhguar dhe imituar modele të tilla si prindërit ose mësuesit, fëmijët mësojnë rreth sjelljeve dhe virtyteve etike. Brenda një mjedisi që thekson sjelljen etike, fëmijët kanë më shumë gjasa të zhvillojnë aftësitë vetë-rregulluese të nevojshme për agjencinë morale dhe vendimmarrjen etike. (Hiekkataipale dhe Lämsä, 2017). Teoria sociale njohëse e moralit thekson rëndësinë e mjedisit social dhe modelimit në zhvillimin e sjelljes etike te fëmijët. Përmes vëzhgimit të sjelljeve të të rriturve të afërt, si prindërit dhe mësuesit, fëmijët mësojnë të dallojnë mes sjelljeve të pranueshme dhe të papranueshme, duke imituar dhe përsëritur këto modele në jetën e tyre të përditshme. Ky proces i mësimi social ndihmon në internalizimin e normave morale dhe virtyteve, duke krijuar një bazë për zhvillimin e vetëdijes morale dhe përgjegjësisë individuale.

Edukatorët dhe prindërit mund të luajnë një rol jetësor në krijimin e mjedisve që ua mundësojnë fëmijëve të praktikojnë dhe zhvillojnë virtytet morale. Duke u ofruar fëmijëve mundësi për të bërë zgjedhje morale dhe për të reflektuar mbi rezultatet, ata zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik dhe arsyetimit etik, të cilat janë thelbësore për rritjen e

tyre në individë të vetëdijshëm moralisht. Përfshirja e mësimeve mbi etikën brenda kurrikulave arsimore mund të mbështesë gjithashtu këtë proces zhvillimor duke u ofruar fëmijëve mundësi të strukturuar për t'u angazhuar me dilema etike dhe për të mësuar të zbatojnë virtytet e tyre në situata të ndryshme.

Si përfundim, qasja psikologjike për të ngulitur virtytet etike te fëmijët thekson një kornizë gjithëpërfshirëse, që përfshin motivimin moral, zhvillimin kognitiv, modelimin dhe përforsimin pozitiv. Këta elementë, kur kombinohen në mjedise edukuese, mund të mbështesin në mënyrë efektive zhvillimin etik të fëmijëve, duke i përgatitur ata për t'u qasur sfidave të jetës me një busull të fortë morale.

RRËNJOSJA E VIRTYTEVE ETIKE TE FËMIJËT SIPAS ISLAMIT

Literatura islame e trajton edukimin e etikës si një detyrë thelbësore fetare dhe prindërore. Nga ana islame, etika është thellësisht e rrënjësuar në mësimet fetare, të cilat ofrojnë një kornizë holistike dhe të përzetshme për sjelljen morale. Etika islame, siç argumentohet nga studiues të ndryshëm, ofron udhëzime gjithëpërfshirëse, që shtrihen përtej kohës dhe hapësirës, duke tejkaluar disa nga kufizimet e gjetura në teoritë etike perëndimore. (Al Aidaros et al., 2013). Mësimet islame theksojnë virtyte të tilla, si: ndershmëria, bamirësia dhe mirësia, të cilat janë të rrënjësura në jetën e përditshme përmes praktikave fetare dhe udhëzimeve morale të gjetura në tekstet fetare. Perspektiva islame sugjeron që të kuptuarit e etikës nga kjo pikëpamje mund të ofrojë një kuptim më të plotë të veprimeve të drejta dhe të gabuara. Ky kuptim pasurohet duke e krahasuar atë me kufizimet e paradigmave të tjera etike, duke ofruar kështu një kornizë unike për kultivimin e virtyteve te fëmijët.

Etika islame ofron një qasje të thelluar dhe gjithëpërfshirëse ndaj moralitetit, e cila është e lidhur me besimin dhe teknikën fetare. Ajo nuk kufizohet vetëm në parimet abstrakte, por manifestohet në mënyrë konkrete në jetën e përditshme nga virtyteve të tilla, si: ndershmëria, bamirësia dhe mirësia. Për më tepër, etika është adresa jo vetëm ndërpersonale, por edhe përgjegjësitë individuale dhe sociale, duke promovuar një balancë mes shërbimeve, mëshirë dhe përgjegjshmërisë. Po ashtu, literatura mbi edukimin islam thekson në mënyrë të pakontestueshme parimin e modelimit. Prindërit dhe mësuesit janë të detyruar të kenë sjellje të larta morale, pasi fëmija imiton dhe përvetëson atë që sheh. Studime tregojnë se zbatimi i hershëm i detyrave fetare (si namazi) nuk është vetëm ritual, por një mjet për të rrënjësuar virtyte si disiplina, përlulesia dhe lidhja e vazhdueshme me Krijuesin, të cilat janë baza për etikën.

Edukatorët kanë një ndikim kyç në formën e karakterit moral të fëmijëve duke krijuar një mbështetje mjedisore ku



virtutet mund të praktikohen në mënyrë të moralshme. Përmes mundësisë për ta përcaktuar moralin për kritikën e tyre mbi kritikën e tyre, reflektojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre të mendimit dhe arsytimit të etikës, të cilat janë themelore për mendimet e një vetëdijeje morale, të cilat përballen me sfidat e tyre në jetën e përditshme. Ky proces i ndërveprimit me situatën reale i ndihmon ata të kuptojnë rëndësinë e virtyteve, si: bashkëpunimi, ndershmëria dhe përgjegjshmëria në mënyrë të thelluar.

PËRFUNDIM

Në integrimin e këtyre njohurive, prindërit dhe edukatorët mund të përdorin si kuptimin empatik ashtu edhe mësimet fetare si qasje praktike për të ngulitur virtyte te fëmijët. Zbatimi i një kombinimi të teknikave psikologjike, siç është inkurajimi i empatisë dhe kuptimi i motivimeve morale, me praktikën etike islame mund të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin moral të fëmijët. Duke vepruar kështu, është e mundur të rriten fëmijë që jo vetëm janë të vetëdijshëm etikisht, por edhe të aftë të marrin vendime të shëndosha moralisht në aspekte të ndryshme të jetës. Kjo qasje e dyfishtë mundëson një kuptim dhe zbatim gjithëpërfshirës të virtyteve etike, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin moral të fëmijëve në një mënyrë që respekton si dimensionet shkencore ashtu edhe ato shpirtërore.

Referencat:

- Hoffman, M. L. 2000. "Empathy and Moral Development". Cambridge University. <https://doi.org/10.1017/cbo9780511805851>
- Al-Aidaros, A.-H., Md Idris, K., & Mohd Shamsudin, F. 2013. "Ethics and Ethical Theories from an Islamic Perspective". *International Journal of Islamic Thought*, 4(1), 1–13. <https://doi.org/10.24035/ijit.04.2013.001>
- De Colle, S., & Werhane, P. H. 2007. "Moral Motivation Across Ethical Theories: What Can We Learn for Designing Corporate Ethics Programs?". *Journal of Business Ethics*, 81(4), 751–764. <https://doi.org/10.1007/s10551-007-9545-7>
- Miller, G. F. 2007. "SEXUAL SELECTION FOR MORAL VIRTUES". *The Quarterly Review of Biology*, 82(2), 97–125. <https://doi.org/10.1086/517857>
- Hiekkataipale, M.-M., & Lämsä, A.-M. 2017. "(A)moral Agents in Organisations?" The Significance of Ethical Organisation Culture for Middle Managers' Exercise of Moral Agency in Ethical Problems. *Journal of Business Ethics*, 155(1), 147–161. <https://doi.org/10.1007/s10551-017-3511-9>
- Baer, R. 2015. "Ethics, Values, Virtues, and Character Strengths in Mindfulness-Based" Interventions: a Psychological Science Perspective. *Mindfulness*, 6(4), 956–969. <https://doi.org/10.1007/s12671-015-0419-2>

Varësia dopaminike si sfidë e shekullit – një qasje neuroshkencore dhe islame

Dr. Erda Ballëk

HYRJJE

Në epokën moderne, ku stimujt janë të shumtë dhe shpërblimi i menjëhershëm është norma, koncepti i dopaminës ka kaluar nga një term thjesht neuroshkencor në një metaforë kulturore për varësinë, motivimin dhe kërkimin e kënaqësisë.

Dopamina, një neurotransmetues thelbësor, luan një rol qendror jo vetëm në sistemin

e shpërblimit të trurit, por edhe në funksionet motorike, vëmendjen dhe motivimin.

Ajo është motori biologjik që na shtyn të kërkojmë burimet e nevojshme për mbijetesë, si ushqimi dhe riprodhimi. Megjithatë, çlirimi i saj i pakontrolluar, i nxitur nga teknologjia, konsumizmi dhe industria e argëtimit, ka çuar në një “mbingarkesë dopaminike”, që kërcënon aftësinë tonë për të gjetur kënaqësi në aktivitete më kuptimplota dhe afatgjata.

Dopamina është thelbësore për motivimin dhe mësimin. Ajo nuk është thjesht “molekula e kënaqësisë”, por më saktë “molekula e pritjes së kënaqësisë” – ajo që na shtyn të kërkojmë shpërblimin.



ROLI I DOPAMINËS DHE KURTHI I SHPËRBLIMIT TË MENJËHERSHËM – BAZA NEUROBIOLOGJIKE

Dopamina është thelbësore për motivimin dhe mësimin. Ajo nuk është thjesht “molekula e kënaqësisë”, por më saktë “molekula e pritjes së kënaqësisë” – ajo që na shtyn të kërkojmë shpërblimin. Ky neurotransmetues çlirohet në bërthamën akumbens (Nucleus Accumbens), pjesë e sistemit limbik, si përgjigje ndaj stimujve të rinj, të papritur ose shpërblyes. Ky çlirim forcon lidhjet nervore, duke e mësuar trurin të përsëris sjelljen që çoi në shpërblim.¹

Problemi i shoqërisë moderne qëndron në faktin se stimujt artificial ofrojnë doza të larta dopaminike me përpjekje minimale. Përdorimi i pakufizuar i rrjeteve sociale, video-lojërat, ushqimet e përpunuara dhe pornografia shkaktojnë një çlirim masiv të dopaminës, shumë më të lartë se sa aktivitetet natyrale si ushqimi apo ndërveprimi shoqëror. Për shembull, një video-lojë mund të çlirojë dopaminë me një shpejtësi dhe intensitet që asnjë detyrë akademike apo punë e thellë nuk mund ta arrijë. Kjo mbingarkesë e vazhdueshme çon në një fenomen neurobiologjik të quajtur down-regulation (ulje e rregullimit) të receptorëve të dopaminës, veçanërisht receptorëve D. Ulja e receptorëve të dopaminës dëmton aftësinë për të marrë vendime, për të kontrolluar impulset dhe për të ndjerë kënaqësi nga aktivitetet normale. Kjo krijon një “deficit motivimi” për detyrat afatgjata dhe një varësi ndaj stimujve të shpejtë.

Truri, në përpjekje për ta ruajtur homeostazën (stabilitetin biologjik) dhe për t'u mbrojtur nga stimulimi i tepërt, zvogëlon numrin dhe ndjeshmërinë e këtyre receptorëve. Rezultati është një gjendje hipo-dopaminergjike (ndjeshmëri e ulët ndaj dopaminës), ku individ ka nevojë për stimuj gjithnjë e më të fortë për të ndjerë të njëjtin nivel kënaqësie. Kjo gjendje manifestohet si apati, anhedoni (pamundësi për të ndjerë kënaqësi nga gjërat normale) dhe varësi. Individ bëhet i skllavëruar ndaj kërkimit të dozës së radhës, duke humbur aftësinë për të shijuar shpërblimet e ngadalta dhe të qëndrueshme të jetës.

Përdorimi i pakufizuar i rrjeteve sociale, video-lojërat, ushqimet e përpunuara dhe pornografia shkaktojnë një çlirim masiv të dopaminës, shumë më të lartë se sa aktivitetet natyrale si ushqimi apo ndërveprimi shoqëror.

Stimujt e varësisë (digjitale ose substanciale) shkaktojnë një çlirim masiv dhe të shpejtë të dopaminës, të njohur si “Dopamine Spikes”.²

Dr. Gabor Maté (psikiatër dhe autor i “In the Realm of Hungry Ghosts”), thotë: “Varësia nuk është rreth drogës, por rreth dhimbjes. Sot, dopamina është droga jonë kolektive, një përpjekje për të mbuluar boshllëkun që lë mungesa e lidhjes së vërtetë.”

TË KESH APO TË JESH?


Psikoanalisti Erich Fromm në librin, “To Have or to Be?” (Të kesh apo të jesh?), diagnostifikoi sëmundjen e shoqërisë moderne si një ndarje mes dy mënyrave themelore të ekzistencës:

1. Mënyra e të pasurit (Having Mode): Përkufizon veten dhe lumturinë përmes posedimit, konsumit dhe statusit. Identiteti bazohet tek ajo që ke: para, prona, pëlqime, ndjekës. Ushqehet nga Dopamine Spikes (shpërblime të shpejta). Kërkon kënaqësi të menjëhershme dhe të vazhdueshme.

2. Mënyra e të qenit (Being Mode): Përkufizon veten përmes përvojës, rritjes, dashurisë dhe kontributit. Lumturia gjendet tek ajo që je: i ditur, i dashur, kreativ. Lidhet me shpërblimin e vonuar (Delayed Gratification). Kënaqësi më e thellë dhe e qëndrueshme.³ Fromm-i argumenton se kapitalizmi modern kërkon konsumatorë identikë, shijet e të cilëve janë të standardizuara dhe mund të manipulohen lehtë, duke përdorur gjithnjë e më tepër “kurthin e dopaminës”.⁴

“DETOKSI I DOPAMINËS” – MIT DHE REALITET

Në përgjigje të këtij problemi, ka lindur një trendi i quajtur “detoks i dopaminës” ose “agjërime dopamine”. Megjithatë, emri nuk përputhet me realitetin e molekulës në fjalë. Siç shpjegon dr. Peter Grinspoon nga Harvard Medical School, ju nuk mund të “agjëroni” nga dopamina, pasi ajo është një kimikat thelbësor që truri e prodhon vazhdimisht. Qëllimi i vërtetë i kësaj praktike, siç e ka definuar fillimisht dr. Cameron Sepah, nuk është të eliminosh dopaminën, por të rifitosh kontrollin mbi sjelljet kompulsive duke u shkëputur për një periudhë të caktuar nga



stimujt problematik. Është një formë e terapisë konjitive-biheviorale. Një “detoks” i shëndetshëm nuk përfshin privimin nga ushqimi apo kontakti njerëzor, por një shkëputje të ndërgjegjshme nga teknologjia dhe kënaqësitë e lira.⁵

SHPIRTI I DOPAMINËS

“A ke parë atë që e ka marrë dëshirën e vet për zot?” (Xhathije, 23)⁶

Malik Badri r.a., babai i psikologjisë moderne islame, ofron urën midis këtyre dy botëve. Ai kritikoi ashpër psikologjinë perëndimore për sekularizimin e saj dhe për neglizhimin e dimensionit shpirtëror. Badri theksoi se shumë probleme psikologjike, përfshirë varësitë (çrregullimet dopaminike), duhet të trajtohen përmes një kornize psikospirituale. Në veprën e tij “*Kontemplimi: Një Studim Psikospiritual Islam*” (Contemplation: An Islamic Psychospiritual Study), Badri argumenton se varësia nuk është thjesht një problem biokimik, por një sëmundje e shpirtit që kërkon vetëllogaritje (murakabe) dhe kujtim të Zotit (dhikr) si mjete terapeutike.⁷

Këto praktika shpirtërore, duke e larguar vëmendjen nga stimujt e jashtëm dhe duke e drejtuar atë nga brenda, ndihmojnë në rivedosjen e ekuilibrit mendor dhe emocional, duke ofruar një burim të brendshëm dhe të qëndrueshëm të qetësisë.

Varësia nuk është thjesht një problem biokimik, por një sëmundje e shpirtit që kërkon vetëllogaritje (murakabe) dhe kujtim të Zotit (dhikr) si mjete terapeutike.

Ndërsa, Imam Gazaliu, në veprën madhështore të tij, “*Minhaxhul Abidiin...*” (Metoda e adhuresve), ofron një model të detajuar të psikologjisë shpirtërore drejt kontrollit dopaminergjik. Ai e ndan shpirtin (nepsin) në nivele, ku niveli më i ulët është Nefs el Emmare (shpirti nxitës për të keqen), i cili është i prirë drejt kënaqësive të menjëhershme dhe epsheve. Kjo gjendje është e ngjashme me skllavërimin ndaj ciklit të shpërblimit të shpejtë dopaminik. Gazaliu thekson rëndësinë e vetëkontrollit (murakabe) dhe llogaridhënies (muhasabe) si mjete për të kaluar nga Nefs el Emmare në Nefs el Mutmainne (shpirti i qetësuar).⁸ Kënaqësitë e kësaj bote, të cilat mund të krahasohen me çlirimin e shpejtë të dopaminës, janë të rrezikshme nëse nuk kontrollohen, pasi e largojnë zemrën nga qëllimi i saj final: njohja dhe kënaqësia e Zotit. Detoksi, në këtë kontekst, është një akt i murakabese që synon të disiplinojë shpirtin dhe të rrisë ndjeshmërinë ndaj kënaqësive shpirtërore.

MENAXHIMI I DOPAMINËS, DETOKSI SHPIRTËROR

Detoksi i dopaminës, kur interpretohet përmes thjerrëzës fetare, shndërrohet në një disiplinë shpirtërore, që synon pastrimin e zemrës dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj kënaqësive të vërteta.



Praktikat fetare islame në jetën e besimtarit, janë mënyrat më të shkëlqyera që ndihmojnë në menaxhimin e dopaminës, e që në bazë lidhen dhe përputhen me natyrshmërinë njerëzore (fitrah). Këtu do t'i përmendim disa:

Namazi: Kohët e caktuara e disiplinojnë stimulimin e dopaminës. Pasi që kohët ndahen brenda ditës, atëherë kemi të bëjmë me një gjendje aktive të vetedisiplinës.

Agjërimi (Es Saum): Ul ndjeshëm stimujt e lartë dopaminikë (ushqimi, pijet, marrëdhëniet) dhe rrit vetëkontrollin. Forcon kontrollin ekzekutiv mbi sistemin limbik (shpërblimin). Rrit ndjeshmërinë ndaj shpërblimeve natyrale.

Lutja (dua): Kërkon përqendrim të thellë (khushu) dhe ndërpret ciklin e shpërblimit të menjëhershëm, ngase është një pritje për përgjigjen e lutjes.

Kujtimi i Zotit (dhikr): Zëvendëson stimulimin e jashtëm me një burim të brendshëm dhe të qëndrueshëm të qetësisë. Krijon një lidhje të qëndrueshme shpirtërore, duke ulur varësinë nga stimujt e jashtëm dhe duke aktivizuar qendrat e qetësisë në tru.

Izolimi (itikafi): Heqja dorë përkohësisht nga bota (teknologjia, shoqëria), për t'u fokusuar në kontemplim. Rivendos ekuilibrin mendor duke ulur ndjeshëm inputin e stimujve të lartë dopaminikë, duke lejuar up-regulation të receptorëve dopaminik.

Tefakkur (meditimi): Do të thotë rikalibrimi i shpërblimit siç thekson Malik Badri, vëzhgimi i krijimit e largon mendjen nga dëshirat e saj, duke ofruar një kënaqësi të thellë dhe të shëndetshme për qenien.

Shoqërimi me të sinqertit (sadikanët): Zëvendëson kënaqësinë e shpejtë të stimujve me shpërblimin e ngadaltë dhe të thellë të lidhjeve njerëzore kuptimplote. Lidhjet shoqërore çlirojnë oksitocinë dhe serotoninë, duke balancuar sistemin e shpërblimit dhe duke ulur nevojën për dopaminë artificiale.

PËRFUNDIMI

Dopamina është një dhuratë hyjnore, një mekanizëm i krijuar për të na udhëhequr drejt asaj që është e dobishme për ne. Megjithatë, në peizazhin modern të mbushur me stimuj artificialë, kjo dhuratë mund të kthehet lehtësisht në një kurth. Tradita islame ka ofruar një kuadër të fuqishëm për të kuptuar dhe menaxhuar dëshirat njerëzore. Thelbi i kësaj qasjeje është koncepti i vasatije (rruga e mesit), siç përshkruhet në Kuran: *“Dhe kështu Ne ju bëmë një umet të mesit (vasatan), që të jeni dëshmitarë për njerëzimin...”* (El Bekare, 14)

Ky parim i “rrugës së mesme” ka të bëjë me një ekuilibër dinamik midis dy ekstremeve: midis asketizmit të plotë dhe hedonizmit të shfrenuar. Islami nuk kërkon heqjen dorë nga kënaqësitë e kësaj bote, por kanalizimin dhe moderimin e tyre.

Theksi i Gazaliut mbi luftën e shpirtit, analiza e Fromm-it mbi konsumizmin dhe qasja psikospirituale e Badrit, të gjitha bashkohen në një pikë: kënaqësia e vërtetë dhe liria arrihen jo duke iu dorëzuar dëshirave, por duke i menaxhuar ato me disiplinë dhe duke i drejtuar drejt qëllimeve më të larta. Detoksi i dopaminës, kur kuptohet si një “xhihad i nefsit” (luftë e shpirtit) modern, bëhet një praktikë thelbësore shpirtërore për të rivendosur ndjeshmërinë e zemrës dhe për të gjetur shpërblimin e vërtetë në adhurim, punë kuptimplote dhe lidhje të thella njerëzore.

Kjo është rruga drejt një jete të ekuilibruar...

1. Ganong Tıbbi Fizyoloji, “Nörofizyoloji- Endokrinoloji bölümü”, Güneş Tıp Kitapevi, 26. baskı, İstanbul, 2022, 221-277 syf.
2. Prof. dr N. Tarhan & Uzm. dr. Serdar Numedov, “Bağımlılık, Sanal veya Gerçek pozitif çözümler”, Timaş yayınları, İstanbul, 2023, f. 128
3. Matthias, A, “Erich From on the Psychology of Capitalism”, 2021.
4. Fromm, E, “Sahip Olmak ya da Olmak”, çev. Aydın Arıtan, Arıtan Yay., İstanbul 2016, syf 21-35.
5. Harvard helath publishing, “Dopamin fasting: Misunderstandnig science spawns a maladaptive fad”, 2020. The Guardian, “How Digital Media turned us all into Domain Addicts”, 2021.
7. Malik Badri, “Contemplation: An islamic Psychospiritual Study”- with an İntoduction by: Jeremy Henzell-Thomas, 2018.
8. Gazzali, M, “Minhâcü'l-Âbidîn ila Cenneti Rabbil âlemin” çev.“Cennete Doğru: Abidler Yolu”- Semrkand yayınları, İstanbul, 2020. Engeller bölümü-Nefis, 91-105 syf.



Prezantimi i denjë i Islamit në xhamitë e mërgatës shqiptare – ky mision i shenjtë mbi supet tona

Besnik Kadriolli

Islami, kjo bindje e natyrshme, që në terminologji apo gjuhën teologjike njihet me termin fe (feja islame), është aq i pastër, saqë kërkon kujdes dhe maturi, duke pasur për bazë njohuritë rreth tij mbi prezantimin e denjë përballë shoqërisë apo në veçanti besimtarëve myslimanë (xhematit).


Islami është fe e paqes, drejtësisë dhe mëshirës. Ai nuk është vetëm një sistem besimi, por edhe mënyrë jetese, që e udhëzon njeriun në çdo aspekt të mirëqenies së tij. Një

nga përgjegjësitë më të rëndësishme të çdo myslimani, e në veçanti të thirrësit, dijetarit, imamet, është ta prezantojë Islamin në mënyrë të denjë, me vepra dhe fjalë, që pasqyrojnë bukurinë e kësaj feje.

Përgjegjësia si ndërgjegje brenda çdo thirrësi islam (hoxhe), e cila rëndon mbi supet e tyre, duhet të jetë fondamenti themelor i angazhimit individual në shpërfaqjen e vlerave të çmuara që ngërthen në vetë misionin e tij. Ky angazhim kërkon patjetër

Islami është fe e paqes, drejtësisë dhe mëshirës. Ai nuk është vetëm një sistem besimi, por edhe mënyrë jetese, që e udhëzon njeriun në çdo aspekt të mirëqenies së tij.





durim dhe vazhdimësi, duke shpresuar çdoherë në kënaqësinë e Zotit xh.sh.: “Pra, të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Ti mos u pikëllo për ata, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë ata.” (En Nahl, 127).

Në kohën kur shumë keqkuptime ekzistojnë rreth Islamit, shembulli personal i atij që bartë mbi supe mesazhin e thirrjes në Islam është thirrja më e fortë dhe më e singertë. Çdo nxënës i dijes islame, që nga fillimet e tij, synon të arrijë që një ditë të jetë në karvanin e thirrësve dhe prezantuesve të Islamit në mënyrën e duhur, ku vepra dhe fjala e tij janë konstante dhe përkujnë me realitetin.

Kurajo dhe motivi i një thirrësi islam, i një hoxhe, buron nga vetë fjala e Allahut në Kuran dhe këshillat e Pejgamberit Muhamedit a.s., i cili ka thënë: “Kush i udhëzon të tjerët në të mirë, për këtë do të ketë shpërblim sikurse edhe ai i cili ka bërë mirë.”¹

Andaj, çdo sakrificë për të arritur që të përçosh te masa e gjerë mesazhin e Islamit, urtësinë e bindjes ndaj Zotit dhe dobisë e largimit nga devijimi, është një përpjekje që nuk lihet në harresë asnjëherë nga i Madhi Zot.

Çdo mysliman, çdo thirrës islam, që mban mbi supet e tij amanetin e fjalës së Zotit, është një “pasqyrë” e fesë që përfaqëson. Le të bëhemi thirrës të “heshtur”, që me sjelljen tonë ta bëjmë Islamin të ndritshëm në sytë e njerëzve.

Allahu xh.sh., në Kuranin fisnik, thotë: “Dhe thuaj: “Veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t’ju njoftojë për atë që vepruat.” (Et Tevbe, 105).

Mërgata shqiptare, pa mëdyshje është një thesar i çmuar kombëtar, i cili krahas angazhimeve të palodhshme për të siguruar mirëqenie për familjen, është edhe një krah i fortë i mbështetjes për vendlindjen, gjithëherë e shtyrë nga ndjenja e obligimit moral.

Strehimin dhe ngrohtësinë shpirtërore ata e gjenin në xhamitë apo vendfaljet, të cilat i kishin të menaxhuara me vetëfinancim nga djersa e punës së tyre, vetëm e vetëm që të ruhej besimi islam ndër breza. Realizimi i këtij misioni u arrit duke angazhuar hoxhallarë, imamë nga trojet shqiptare, të cilët shërbenin me zell dhe vetëmohim në ngritjen e vetëdijes islame në gjirin e mërgimtarëve kudo në botë, si dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Në sajë të këtij angazhimi, fillet e para i ngjanin vetë historisë së ditëve të para pas hixhretit të Muhamedit a.s. në Medinë, i cili bashkërisht me besimtarët vunë themelet e xhamisë dhe ngritën atë, që të jetë një institucion i vlerave dhe nevojave të çdo kategorie shoqërore. Një rol të tillë luajtën

qendrat islame shqiptare, ku vartësit e tyre, pra imamët, kishin mbi supet e tyre një mirëbesim dhe sytë dhe veshët e xhematit ishin te fjala dhe këshilla e mirëfilltë e hoxhës, në çdo sferë organizimi që ata kishin.

Nuk është e lehtë të jesh i balancuar mes realitetit kohor, tundimit teknologjik dhe përmbajtjes së palëkundur në gjurmët zinxhirore të Islamit të pastër, të cilin përpiqemi ta prezantojmë te besimtarët myslimanë në çdo nivel apo vend. Sot, joshja dhe ndikimi nga akterë të ndryshëm, qofshin ata materiale apo njerëzorë, është e pashmangshme, por vetëm me një vendosmëri dhe duke qenë thellë të palëkundur në mundin dhe mësimet e pastra islame mund t'i përballojmë dhe tejkalojmë me sukses.

Niveli intelektual i besimtarëve frekuentues të xhamive sot, krahasuar me vitet e '90-ta, është krejtësisht ndryshe; në safat e tyre do të gjesht studentë, arkitektë, mjekë, ushtarë, filozofë etj., dhe sfera e kritikës është shumë më e gjerë dhe llupa e tyre është specifikisht e drejtuar mbi gjuhën e ligjëruesit islam në minberin e tij.

Kujdesi ndaj kultivimit të tolerancës është akt i domosdoshëm, sepse zaten kjo ngërthehet dhe mishërohet thellë në vetë fenë islame, e sidomos në shoqëritë perëndimore, ku interpretimit të Islamit në masë, i kushtohet një vëmendje e posaçme edhe nga vetë organet e rendit dhe ligjit. Jo rrallëherë, keqinterpretimi apo dhe manipulimi i ligjërimeve islame, janë bërë mollë sherri, fatkeqësisht edhe shtysë për individë të pa arsimuar sa duhet në dijet reale islame, që ata të bëjnë vepra të dhunshme në emër të Islamit në vende të ndryshme të Evropës. Kjo pastaj ka prodhuar një revoltë shoqërore të mjedisit ku frekuentuesit e xhamive, besimtarët myslimanë, kanë qenë të targetuar në linçime si të padëshiruar në atë mes.

Por, falë angazhimit të vazhdueshëm të hoxhallarëve shqiptarë, të cilët kanë krijuar ura bashkëpunimi institucional me organet vendore shtetërore aty ku kanë jetuar dhe vepruar, ka bërë që paragjykimet të kthehen në mirënjohje ndaj punës dhe frytit të këtyre qendrave islame në vlerat të cilat shfaqin ato.

***“Ti
(Muhamed)
thirr për në
rrugën e Zotit
tënd me urtësi
e këshillë të
mirë dhe
polemizo me
ata (kundërshtarët) me
atë mënyrë që
është më e
mira. Zoti yt
është Ai që e di
më së miri atë
që është
larguar nga
rruga e Tij
dhe Ai di më
së miri për të
udhëzuarit.”***

(En Nahl, 125).

Sjellja shembullore e thirrësit islam dhe ndjekësve të tij, ka qenë dhe do të jetë zëri më i dëgjuar dhe tingulli më i butë në veshët dhe zemrat e jomyslimanëve objektivë, të cilët nuk paragjykojnë sipërfaqësisht, por fillojnë ta gjurmojnë me studim Islamin për ta njohur thesarin e tij. Marrim shembull Indonezinë, shtet i cili gjeografikisht i largët me gadishullin arabik, por falë edukatës islame, të cilën e bartnin tregtarët e asaj kohe dhe bashkëpunimit të sinqertë që kishin arritur me popullin e atij vendi, bëri që zemrat dhe mendjet e miliona njerëzve ta pranojnë këtë bindje islame të pastër, që përkon me natyrshmërinë njerëzore.

Pra prezantimi i Islamit kërkon urtësi, mirësi dhe butësi; një thirrje e ashpër apo imponuese e largon zemrën e tjetrit, ndërsa fjala e butë argumentuese e afron atë drejt të vërtetës. Nga jeta e vetë Pejgamberit a.s., kemi mësuar se mirësjellja e tij njerëzore me të tjerët, me të afërmit, të largët, beduinët (banorët e shkretëtirave apo periferive), bëri që zemrat e tyre të zbuteshin përballë mësimave islame dhe t'i përqaфонin ato.

Përveç natyrshmërisë së tij shembullore që kishte i Dërguari Muhamedi a.s., gjë për të cilën edhe ne jemi të thirrur që pashmangshmërisht ta praktikojmë si sunet njerëzillëkun e tij në personalitet, ishte edhe këshilla hyjnore nga Zoti i Madhërishëm në imperativ duke i thënë: “Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (En Nahl, 125).

Çdo mysliman, çdo thirrës islam, që mban mbi supet e tij amanetin e fjalës së Zotit, është një “pasqyrë” e fesë që përfaqëson. Le të bëhemi thirrës të “heshtur”, që me sjelljen tonë ta bëjmë Islamin të ndritshëm në sytë e njerëzve.

1 Shiko: <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1501>, 22.10.2025

Kimia në shërbim të mjedisit – përgjegjësia e njeriut sipas Islamit

Mr. Njomza Sadriu

Gjatë dekadës së fundit, rritja e shpejtë e popullsisë, përshpejtimi i procesit të ngrohjes globale, shterimi i burimeve të karburanteve fosile dhe ndotja e vazhdueshme e mjedisit, kanë përbërë faktorët kryesorë, që kanë nxitur promovimin dhe zbatimin e parimeve të kimisë së gjelbër dhe të inxhinierisë së qëndrueshme në të gjitha fushat shkencore dhe industriale, nga kimia e aplikuar deri te shkencat mjedisore.

KËTO FUSHA ZËNË NJË ROL GJITHNJË E MË TË RËNDËSISHËM NË INDUSTRIJË PËRPUNUESE KIMIKE.

Kimia e gjelbër dhe inxhinieria e qëndrueshme, si disiplina relativisht e reja, synojnë minimizimin e gjenerimit të ndotjes përmes përdorimit të lëndëve të para alternative, zhvillimit dhe përzgjedhjes së tretësve me ndikim më të ulët mjedisor, identifikimit të rrugëve të reja sintetike, përmirësimit të selektivitetit të reaksioneve kimike, reduktimit të mbetjeve, shmangies së përdorimit të komponimeve me toksicitet të lartë dhe zbatimit të qasjeve të tjera, që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm industrial.

Universi është një nga krijimet mahnitëse të Allahut xh.sh.; çdo gjallesë në të është caktuar me një rol të veçantë për të krijuar harmonizim dhe balancë ndërmjet elementëve të ndryshëm të tij.

Shoqëria njerëzore aktualisht përballet me shumë sfida mjedisore, të tilla si ndotja e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe humbja e biodiversitetit. Këto çështje shkaktojnë rreziqe të mëdha për ekosistemet dhe përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e mëtejshme në tokë.

Presioni antropogjen mund të vazhdojë të përkeqësojë problemet ekzistuese. Parandalimi dhe zbutja e çështjeve mjedisore kërkon shkencë të fortë dhe mbështetje të përkushtuar politike.

Në këtë kontekst, kimia mjedisore është një shkencë qendrore dhe multidisiplinare, e cila ofron koncepte të reja dhe metoda të aplikuara për zgjidhjen e problemeve aktuale mjedisore.

POZICIONI I ISLAMIT MBI KIMINË E GJELBËR DHE QËNDRUESHMËRINË MJEDISORE

Kriza mjedisore ka marrë përmasa serioze kohët e fundit për shkak të shfrytëzimit dhe menaxhimit të dobët të burimeve natyrore. Dëmtimi i mjedisit si pasojë e aktiviteteve njerëzore ka shkaktuar ndotje të ndryshme mjedisore, përfshirë ajrin, ujin dhe tokën, si dhe rritjen e temperaturës globale për shkak të shkatërrimit të shtresës ozonike të tokës.

Universi është një nga krijimet mahnitëse të Allahut xh.sh.; çdo gjallesë në të është caktuar me një rol të veçantë për të krijuar harmonizim dhe balancë ndërmjet elementëve të ndryshëm të tij. Këto role përfshijnë jo vetëm qeniet njerëzore dhe kafshët, por edhe bimët, të cilat kontribuojnë në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe në funksionimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Të tria këto elemente kanë nevojë të ndërsjella dhe janë bërë të ndërvlarura për të siguruar stabilitetin universal të universit. Përmes këtyre marrëdhënieve, Allahu xh.sh., e ka ndaluar keqpërdorimin dhe shfrytëzimin e tepruar të natyrës, i cili, nëse injorohet, mund të sjellë pasoja negative për të gjitha krijesat e gjalla.

Vetëdijësimi progresiv mbi degradimin e mjedisit natyror global ka bërë që njeriu të perceptojë gjendjen aktuale të pabarazisë mjedisore si një tregues i rrënjësisë shpirtërore të traditës bashkëkohore.

Në Islam, ndërveprimet e njeriut me mjedisin udhëhiqen nga koncepti i njeriut si “halife”, - përfaqësues ose kujdestar i Tokës. Kjo është arsyeja pse çdo mysliman ka një përgjegjësi shtesë për t’i ruajtur dhe gjelbëruar burimet natyrore të tokës.

Islami përbën një mënyrë të plotë jetese për individët që janë shpirtërore, paqedashës dhe modestë. Megjithatë, pavarësisht konceptit të thellë të qëndrueshmërisë, burimet e tokës shpesh keqpërdoren dhe shkatërrohen qëllimisht, duke nxitur kështu nevojën për qasje të reja si kimia e gjelbër.

Në Islam, Kurani konsiderohet si pema e qëndrueshmërisë ose si një udhërrëfyes drejt kimisë së gjelbër. Ligjet dhe rregullat e Sheriatit theksojnë qasje të përgjithshme lidhur me mënyrën më të mirë të zbatimit të parimeve të kimisë së gjelbër për mbrojtjen, rikthimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.

Allahu xh.sh., në Kuran, ka thënë: “Prishja është shfaqur në tokë dhe në det për shkak të asaj që duart e njerëzve kanë punuar, që Ai t’u bëjë të shijojnë një pjesë të asaj që kanë bërë, me qëllim që ata të kthehen (duke u penduar te Zoti dhe duke kërkuar faljen e Tij).” (Er Rum, 41).

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “Nuk ka asnjë besimtar që mbjell një pemë ose hedh një farë, e pastaj një zog, një njeri apo një kafshë ushqehet prej saj, pa iu llogaritur atij si një vepër bamirësie për të cilën do të shpërblehet me të madhe.” (Sahihu i Buhariut, 3:513).

Një pjesë e konsiderueshme e degradimit mjedisor buron nga mungesa e njohurive të




Inovacionet teknologjike, nga mjetet e thjeshta deri te pajisjet bashkëkohore ekologjike, mund të përmirësojnë jetën e njeriut duke kursyer kohë dhe energji.

njerëzve mbi atë që kërkon prej tyre Krijuesi i tyre, Allahu xh.sh.. Njerëzit duhet ta kuptojnë se ruajtja e mjedisit natyror është një detyrim fetar i përcaktuar nga i Plotfuqishmi. Këtë e përforcon edhe ajeti kuranor: “...Bëj mirë ashtu siç Allahu të ka bërë mirë ty dhe mos kërko të përhapësh prishje në tokë; Allahu nuk i do ata që bëjnë prishje.” (El Kasas, 77).

Një parim themelor i përcaktuar nga Pejgamberi Muhamed a.s., është: “Përfitimi nga diçka është në përpjesëtim me përgjegjësinë që ajo mbart.” (Sahihu i Buhariut).

Inovacionet teknologjike, nga mjetet e thjeshta deri te pajisjet bashkëkohore ekologjike, mund të përmirësojnë jetën e njeriut duke kursyer kohë dhe energji. Megjithatë, përdorimi i tyre duhet të bëhet me kujdes, duke synuar uljen e ndikimeve negative ndaj mjedisit, përfshirë ndotjen nga energjia, kimikatet, zhurmat dhe konsumin e ujit.

Nga perspektiva islame, asgjë nuk duhet ta largojë besimtarin nga adhurimi, përmendja e Zotit dhe sjellja e mirë ndaj familjes, shoqërisë dhe njerëzve të tjerë. Allahu xh.sh., i ka nënshtruar krijesat e Tij në shërbim të njeriut, por njeriu duhet t’i përdorë ato brenda



kufijve të përcaktuar nga ligji dhe udhëzimi hyjnor. Kjo konfirmohet në Kuran, ku Allahu xh.sh., thotë: “A nuk sheh se Allahu i ka nënshtruar për ju ato që janë në qiej dhe në tokë dhe ju ka plotësuar me të mira të dukshme e të fshehta?” (Llukman, 20).

Koncepti fillestar i kimisë së gjelbër bazohet në parandalimin e ndotjes ose të gjenerimit të mbetjeve të rrezikshme të çdo lloji. Parimet e kimisë së gjelbër janë përcaktuar me qëllim që të reduktojnë ose eliminojnë në mënyrë alternative krijimin e këtyre substancave kimike të rrezikshme, përmes përdorimit të solventëve të gjelbër, katalizatorëve ekologjikë dhe rrugëve sintetike të qëndrueshme.

Megjithatë, ky punim thekson disa elemente kyçe përmes së cilave koncepte të kimisë së gjelbër mund të nxirren nga Kurani dhe hadithet. Shkencërisht argumentohet se krizat mjedisore me të cilat përballen njerëzimi janë rezultat i aktivitetit njerëzor dhe menaxhimit të dobët të burimeve natyrore. Prandaj, koncepti i kimisë së gjelbër, nga një perspektivë islame, do të mundësonte përmirësimin e njohurive shkencore dhe fetare mbi ekosistemin, duke ndërtuar një urë lidhëse midis njeriut dhe mjedisit të tij natyror.

Referencat

- John Wiley & Sons, Inc., and Scrivener Publishing LLC. *Integrating Green Chemistry and Sustainable Engineering*. Hoboken, NJ: John Wiley & Sons, Inc.; Beverly, MA: Scrivener Publishing LLC, 2019.
- Ali, H., Khan, E. Environmental chemistry in the twenty-first century. *Environ Chem Lett* 15, 329–346 (2017). <https://doi.org/10.1007/s10311-016-0601-3>.
- Al-Hikmah Journal of Arts and Social Sciences Education, Vol. 2, No. 2, December, 2020 ISSN 2705-2559 E-ISSN 2705-2567.
- Jaino, I. (2010). Pemanasan Global. Retrieved from <http://dspace.unimap.edu.my/dspace/bitstream/123456789/7862/1/Pemanasan%20global.pdf> on 2nd December, 2019.
- Halim, I.A., and Akhir, N.S.M. (2017). Preservation of the Environment according to the Quran and Analysis of Environmental in Malaysia. doi:10.20944/preprints201710.0138.v1 Accessed from www.preprints.org on December, 2019.
- Umar, U.A., and Khamidi, M.F. (2012). Green and Sustainable Development in an Islamic Perspective. Research Gate Accessed from: <https://www.researchgate.net/publication/233996739> on December, 2019.
- Khalid, F. (1996). Guardians of the Natural Order, an Outline of the Islamic Approach to Environmental Protection. Accessed from: <http://www.lineonweb.org.uk/Resources/reading>. December, 2019.
- Hussain, M. (2004). Environmental Perspectives: Islam & Ecologist, London Islamic Network for the Environment. Retrieved from: <http://www.lineonweb.org.uk/Resources/reading.htm> December, 2019.
- Murphy, B. (2006). Green Gospels: Environmental Movement Aims for Religious Mainstream, USA: USA Today, Religion. Accessed from: http://www.usatoday.com/news/religion/2006-07-06-greengospels_x.htm. December, 2019.

Zëri i Atdheut në Poezinë e Mulla Mehmet Gashit

Ymer Havolli

Edhe pse më parë, nuk jam marrë me analiza apo recensione të poezive – pasi natyra e profesionit tim është krejt tjetër – megjithatë, disa prej elementeve që përmenden në këto poezi, si kujdesi për Kosovën dhe marrëdhëniet me aleatët, besimi në Zotin, më shtynë ta ndaj një vështrim timin modest lidhur me disa nga këto poezi. Po e marrë në shqyrtim modest se si e shoh unë, ta zëmë një poezi të shkurtër, por me mesazh të thellë, nga mulla Mehmet Gashi, një figurë që, përveç përkushtimit fetar, krijon edhe vargje, që prekin ndjenjat atdhetare dhe aktualitetin politik të vendit. Në këtë tekst të shkurtër, autori i flet Kosovës me zemër, me shqetësim dhe me dashuri, duke dhënë një porosi që mbetet e vlefshme edhe sot.


*Kosovë dëgjo,
Kosovë të lutem më dëgjo,
Disa fjalë t'i them,
E mos u hidhëro nëse janë pa vend.
Kujdes nga armiqtë, e kurrë mos u beso,
Sa më tepër afroji miqtë,
Amerikën mos e lësho.*

Në poezinë e tij, Mehmet Gashi, i drejtohet lexuesit me një porosi të sinqertë dhe të fuqishme, duke shprehur shqetësimin e tij për të ardhmen e vendit. Ai e porosinë lexuesin që të mos i besojë dashakëqijve, pasi historia ka treguar se ata shpesh kanë sjellë vetëm robëri dhe vuajtje. Përmes këtyre vargjeve, autori nënkupton se kujdesi dhe matura janë thelbësore për kujdesin ndaj diçkaje të

Në poezinë e tij, Mehmet Gashi, i drejtohet lexuesit me një porosi të sinqertë dhe të fuqishme, duke shprehur shqetësimin e tij për të ardhmen e vendit.

shtrenjtë për ne, Kosovës. Më tej, Mehmet Gashi, vë në spikamë rëndësinë-domosdoshmërinë e afrimit me miqtë e vërtetë, duke e konsideruar bashkëpunimin dhe besimin reciprok si themel për zhvillimin dhe sigurinë. Në fund, përmendja e Amerikës ka një domethënie të veçantë: ajo simbolizon përkrahjen, mbështetjen ushtarake, politike, ekonomike, kulturore dhe morale, që i është dhënë Kosovës në momentet më të vështira të ekzistencës së saj. Kjo është një thirrje që Kosova të mos harrojë aleatët strategjikë dhe të qëndrojë afër atyre që kanë qenë dhe mbeten shtyllë e sigurisë dhe e qëndrueshmërisë së saj si shtet. Përmes kësaj poezie të





shkurtër, por të thellë në përmbajtje, autori përçon një mesazh aktual dhe të rëndësishëm për drejtimin që duhet të ndjekë vendi. Autori i drejtohet lexuesit me një ton emocional, duke i dhënë një porosi për kujdes. Hoxha Mehmet Gashi, porosinë nëpërmjet këtyre vargjeve që Kosova të jetë e kujdesshme dhe të mos tregojë besim të verbër ndaj atyre që në të kaluarën kanë shkaktuar dhimbje dhe vuajtje. Kujdesi ndaj jo dashamirëve është një thirrje për të mos harruar historinë dhe për të mos rënë në grackat e premtimeve të rreme.

Në vargun e tij poetik, Mehmet Gashi, ngre lart ndjenjën e atdhedashurisë dhe shpirtin kombëtar shqiptar dhe fetar. Poeti merr në duar flamurin kuqezi, duke e bërë atë simbolin kryesor të frymëzimit të tij letrar. Me vargje të thjeshta, por të ngrohta dhe plot urtësi, ai madhështon figurën e Ismail Qemalit, themeluesin e shtetit shqiptar. Në poezinë e tij të njohur, ai shprehet:

Ismail Qemajli, një plak i urtë shumë,

Flamurin e ngriti i pari e s'na la në gjumë.

Këto vargje, përveç se përcjellin respekt të thellë për shpallësit e Pavarësisë së Shqipërisë, pasqyrojnë frymën e gjallë të Rilindjes Kombëtare dhe krenarinë për aktin madhështor e të shumëpritur të shqiptarëve, atë të shpalljes së pavarësisë. Mirëpo, mulla Mehmet Gashi nuk ndalet vetëm tek Ismail Qemali. Ai madhështon edhe figurën emblematike të Isa Boletinit dhe të Marigonës, që

simbolizojnë trimërinë dhe përkushtimin e popullit shqiptar. I këndon urtësisë, trimërisë dhe asaj artistike:

Pas tij vjen baca Isë,

Shokët e tij si shqiponjat tona,

Këtë flamur e qëndisi,

Motra jonë Marigoja.

Sa bukur dhe fuqishëm e mbyll poeti këtë poezi me vargjet plot lutje dhe besim në Zotin:

Të lutem, o i Madhi Zot,

Të na udhëzoshë mbarë,

Me shekuj dhe mot

Me flamur shqiptar.

Përveç temës atdhetare, me një dashuri të thellë e shpirtërore, mulla Mehmet Gashi i këndon edhe Kosovës dhe tokës arbërore. Në vargjet e tij, Kosova paraqitet si nëna e të gjithëve, e bekuar nga Zoti dhe e pasur me fusha e male pjellore:

Kosovë, nëna jonë,

Fusha, malet shumë pjellore,

Edhe Zoti shumë të do,

Moj Kosovë, moj tokë arbërore.

Në krijimtarinë e tij, poeti nuk harron as edukimin dhe përparimin e brezit të ri. Ai i bën thirrje rinisë që të lexojë, të mësojë dhe të punojë me përkushtim, sepse libri është çelësi i diturisë dhe i vetëdijes kombëtare:

Libri të jep të vërtetën, vetëm duhet ta lexosh,

Libri të mëson të njohësh veten, të mëson si duhet të punosh.

I gjithë vëllimi poetik i mulla Mehmet Gashit përshkohet nga një frymë e thellë atdhedashurie, besimit në Zot, përkushtimi ndaj arsimit, respekti për figurat kombëtare dhe porositë që të mos harrohet historia e trishtuar. Poezitë e tij mbartin thjeshtësi popullore, por edhe madhështi shpirtërore, duke quar mesazh se, njeriu fetar i kompletuar është kombëtar i palëkundur, është udhërrëfyes për dashurinë ndaj atdheut, si dhe pishtar për edukimin e brezave të rinj. Ai shkruan me zemër, me besim dhe me ndjenjë të thellë për popullin e vet.

Poezitë e tij nuk janë vetëm vargje, por mesazhe morale dhe shpirtërore, që ftojnë në kujtesë, dashuri për atdheun, respekt për figurat kombëtare dhe përgjegjësi për të ardhmen.

Në një kohë kur poezia shpesh largohet nga ndjenjat e thella njerëzore dhe kombëtare, krijimtaria e mulla Mehmet Gashit vjen si një frymë e pastër, që na kujton se arti i vërtetë nuk humbet kurrë kur lind nga shpirti dhe besimi.

Prishtina gjatë shekujve XV-XVI

PhD cand – Agon Krasniqi

HYRJJE

Prishtina është kryeqytet i Republikës së Kosovës, qytet i rëndësishëm në periudhat historike si në antikë, mesjetë dhe modernitet. Qyteti i cili njihet si Ulpianë në periudhën antike, dhe ishte pjesë administrative e Vicianës (Vushtrrisë), në mesjetë do të njihet si Prishtinë, emër ky i cili vendoset në shekullin IX. Definicioni i fjalës Prishtinë, bazuar në Salnamen Osmane, i referohet “vendit të pazarëve”, apo “vend i grumbullimit”. Megjithatë, ky referim i takon më shumë fjalës “prishe”, ndërsa prapashtesa do i vendosej më vonë në kohën osmane, duke iu referuar vendit si Periştine apo Prishtinë.

Prishtina do të përballej me sulme të njëpasnjëshme. Qyteti do të kalonte nga

sundimi Romak në sundimet si Bizantine, Bullgare, Serbe, Osmane dhe në fund atë Jugosllave. Përfundimisht ajo do të vendosej nën sundimin osman nga Sulltan Mehmeti II, në vitin 1455. Megjithatë ardhja e parë e osmanëve në Prishtinë i takon periudhës së Bayezidit I (Bajazidi), konkretisht vitit 1390. Nga viti 1455 gjerë në vitin 1912, Prishtina hyri në sundimin osman, në përjashtim të vitit 1690-1689, ku Prishtina u pushtua nga forcat austriake, në krye me Pikolominin. Nga viti 1878, Prishtina ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës, me funksionimin administrativ si sanxhak në vilajet. Më 22 tetor të vitit 1912, Prishtina u pushtua nga forcat serbe në kuadër të Luftës Ballkanike.

Prishtina kishte hyrë në sundimin osman përfundimisht në vitin 1455, atëherë kur edhe kishte filluar regjistri administrativ për të.





PRISHTINA GJATË SHEKUJVE XV - XVI

Prishtina kishte hyrë në sundimin osman përfundimisht në vitin 1455, atëherë kur edhe kishte filluar regjistri administrativ për të. Sipas defterëve osman të shek. XV, Prishtina ishte kaza e nahijës së Vushtrrisë (njohur si Vulçiturn).¹ Ndërlidhja administrative varionte në këtë mënyrë: Prishtina nën kazanë e Vushtrrisë dhe Vushtrria në Vilayet-i Vilk apo të Rumelisë, me kohën pastaj në Vilajetin e Budinit dhe më pas në Vilajetin e Temeşvarit (Temeshvar).

Në defterin Tahrir të vitit 1530, Prishtina, Morava dhe Labdi, ishin pjesë e nahijes së Vushtrrisë dhe se Prishtina ishte pjesë e organizimit të jetës sociale, ekonomike dhe administrative të nahijes së Vushtrrisë. Urdhrat e saj merreshin nga udhëheqësi i nahijes. Sipas këtij defteri Tahrir të vitit 1530, në Prishtinë ishin 3 mahalle (lagje) myslimane në qendër dhe 9 lagje gebran (jomyslimanë). Në përgjithësi, pa përfshirë qendrën, në Prishtinë në vitin 1530 ishin 17 lagje myslimane dhe 98 lagje jomyslimane.²

Në shekullin XVI, vazhdoi ndarja e njëjtë administrative: Prishtina ishte pjesë e tashmë sanxhakut të Vushtrrisë. Kazaja e cila u ngrit në statusin e sanxhakut, nuk ndikoi që Prishtina të fitonte status të ri administrativ.³ Në bazë të Kanunnames së Sanxhakut të Bosnës në fund të vitit 1530, Prishtina ishte pjesë e udhëheqjes administrative të Yeni Pazarit (Pazarit të ri).⁴ Prishtina shënoi ngritje administrative në vitin 1588, ku fitoi statusin e sanxhakut në kuadër të Ejaletit të Rumelisë. (Ural, 2013: 38).

Qyteti ndahej në mahalle (lagje). Në lagje bëhej zhvillimi i qyteti në bazë të sistemit osman. Sipas defterit Tahrir, në Prishtinë gjatë shekullit periudhës së Bayezidit II, gjendeshin 10 Cemaat-i Müslümânân hane (Hane të xhematit mysliman). Në regjistrin e vitit 1486, janë të regjistruara 51 hane. Në vitin 1519 janë regjistruar 67 hane, 12 mücerred (dervish beqar), 13 bâ-berat (artizanar), 12 akıncıyan (kalorës kufitar). Në periudhën e Sulltan Süleymanit, në regjistrin e vitit 1525-1526, janë të regjistruara 3 mahalle (lagje) myslimane: Mahalle-i Cami-i Sultan Mehmed Han (Lagjja përreth xhamisë Sulltan Mehmet), e cila kishte 45 hane;

Mahalle-i Mescid-i Çarşi (Mëhalla përreth Mesxhidit të Çarshisë), 41 hane dhe Mahalle-i Mescid-i Sinan Beğ (Mëhalla përreth Mesxhidit Sinan Beğ), 28 hane, 28 mücerred (dervish beqar). Në defterin Tahrir të vitit 1530, ishin 3 mëhalle (lagje) myslimane, në total 121 hane, 1 hatib, 2 imam, 3 müezzin (myezinë) dhe 3 ba-berat (artizanar), 18 hane, 29 mücerred (dervish beqar), 7 akıncıyan (kalorës kufitar). Në regjistrin e vitit 1540, kemi shtimin e mëhallëve myslimane, nga 3 në gjashtë: Mahalle-i Cami-i Sultan Mehmed Han Gazi aleyhi'r rahmetü ve'l gufran (Mëhalla e Xhamisë së Sulltan Mehmed Han Gaziut, Allahu e mëshiroftë dhe ia falë mëkatet), që përfshinte 45 hane, 2 hane fakirü'l-hal (dy familje me gjendje të varfër), 13 hane të tjera. Mahalle-i Ayasofya (Lagjja e Aja Sofisë – Prishtinë), që përfshinte 8 müselleme nefer (ushtarë i luftës, bujk i paqes). Kjo ishte shkëputur nga lagjja e lartpërmendur. Mahalle-i Mescid-i Mehmet Beğ, (Mëhalla përreth mesxhidit Mehmet Beğ), 17 hane, 1 hane fakirü'l hal (familje me gjendje të varfër). Kjo mëhallë ishte shkëputur nga Mahalle-i Mezbureden (Lagjeja Mezbureden). Mahalle-i Mescid-i Sinan Beğ (Mëhalla përreth mesxhidit Sinan Beğ), 21 hane, 3 nga to fakirü'l-hal (familje me gjendje të varfër). Edhe kjo ishte shkëputur nga mëhalla mezbure. Mahalle-i Mescid-i Hasan Beğ (Mëhalla përreth mesxhidit Hasan Beğ), përfshinte 35 müselleme nefer (ushtarë i luftës, bujk i paqes), 9 nga ta fakirü'l-hal (gjendje të varfër). Mahalle-i Mescid-i Emin Alaeddin tab-i Mescid-i Çarşi (Mëhalla e Mesxhidit të Emin Alaeddinit, degë (vartësi) e Mesxhidit të Çarshisë), 14 müselleme nefer (ushtarë i luftës, bujk i paqes), 2 si fakirü'l hal (me gjendje të varfër), janë regjistruar.⁵

Sipas defterit Tahrir, në regjistrimet e Sanxhakut të Vushtrrisë, në vitet 1569-1570, Prishtina kishte të regjistruar 10 mëhallë, 273 hane dhe 1 Hass (Çiftilig) të Sulltanit. Gazi Sulltan Mehmed Han Camii (Xhamia e Gazi Sulltan Mehmetit), (44 hane), Mehmed Bey Mescidi Mahallesi (Lagjja përreth Mesxhidit Mehmet Beğ), (29 hane), Yaralı Sinan Bey Mescidi Mahallesi (Lagjja përreth mesxhidit Sinan Beğ), (24 hane), Çarşi Mescidi Mahallesi (Lagjja përreth

mesxhidit të Çarshisë), (12 hane), Hasan Bey Mescidi Mahallesi (Lagja përreth mesxhidit Hasan Bej), (30 hane), Emir Alaeddin Mahallesi (Lagja Emir Alaeddin), (48 hane), Yunus Efendi Cami Mahallesi (Lagja përreth xhamisë Junus Efendiu), (38 hane), Hasan Emin Ağa Mescidi Mahallesi (Lagja përreth mesxhidit Hasan Emin Ağa), (16 hane), Hatuniye Mescidi Mahallesi (Lagja përreth mesxhidit Hatuniye), (12 hane), Ramazan Çavuş Mahallesi (Lagja Ramazan Çavushi), (20 hane).⁶ Në këtë defter tahrir të vitit - 1569 1570, në Mëhallën Fatih Sultan Mehmed Cami Mahallesi përmendet se “Këtu gjenden 44 shtëpi të myslimanëve”.⁷

Në bazë të këtyre defterëve, Prishtina kur ishte me 10 hane myslimane, kishte 50 banorë myslimanë, 1486-1487, 51 hane me 255 banorë, 1519, 67 hane me 372 banorë, 1526, 114 hane me 583 banorë, 1530, 139 hane me 737 banorë, 1544-1545, 83 hane, 472 banorë.⁸

Në periudhën osmane, regjistrimi i popullsisë jomyslimane ishte regjistruar me emrin cemat-i grebran. Kuptimi i fjalës “gebr” nënkuptonte popujt ateistë dhe paganë, por në shtetin osman këtu klasifikoheshin edhe ehli-kitab apo popujt e librit. Kështu që regjistrimi i popullsisë për popullsinë jomyslimane ishte bërë emërtimin gebran, çka edhe kjo vërehet edhe në Prishtinë. Nga regjistrimet e para pothuajse të gjithë ishin të krishterë, kryesisht të ritit latin, me çrast njiheshin si Cemaat-i Latiner (Xhemati Latiner). Në defterin Tahrir, pas depërtimit osman në Prishtinë, ishin 6 lagje jomyslimane dhe 1 latine.⁹ Për një kohë të shkurtë do rritej në 8 jomyslimane dhe 1 latinez.¹⁰ Në vitin 1545 ishin të regjistruara 9 lagje jomyslimane.¹¹

Lagjet e jomyslimanëve gjatë shek. XV dhe XVI në Prishtinë ishin këto: Mahalle-i Kaçanoka, Mahalle-i Puyasar, Mahalle-i Pukoçiste, Mahalle-i İştitar, Mahalle-i Virilaço, Mahalle-i Kusrik, Mahalle-i Latinler, Mahalle-i Lukar.¹²

Në mëhallën Kaçonaka në vitin 1487-1486, kishte 50 hane, 8 mücerrad (dervish beqar), 8 bive (status i gruas së ve), 1 baştina (çiflig); në vitin 1525-1526, 57 hane, 2 mücerrad (dervish beqar), 2 bive (status i gruas së ve), 9 baştina (çiflig); në vitin 1544-1545, 72 hane, 8 mücerrade (dervish beqar), 1 bive (status i gruas së ve). Në vitin 1569-1570, numri i haneve do ngrihej në 59.¹³ Në Mëhallën Puyasar, gjatë vitit 1477-1478, kishte 45 hane, 12 mücerrade, 10 bive. Në vitin 1487-1488; 31 hane, 3 mücerrade, 15 bive; në vitin 1525-1526, 47 hane, 3 mücerrade, 5 bive, 6 baştina; në vitin 1544-1545, 58 hane, 4 mücerrade, 1 bive, ndërsa në vitin 1569-1570, 53 hane. Në Mëhallën Pukoçiste, gjatë vitit 1477-1478 në regjistrat e defterit tapu tahrir, janë të regjistruara 34 hane, 11 mücerrade, 6 bive; gjatë vitit 1486-1487, kemi 17 hane, 2 mücerrade, 5 bive, 1 baştina; në vitin 1525-1526, 29 hane, 1 mücerrad, 4 baştina; në vitin 1544-1545, 31 hane, 8 mücerrade dhe në vitin 1569-1570.¹⁴ Në mahallen İştitar

**Prishtina
kishte hyrë në
sundimin
osman
përfundimisht
në vitin 1455,
atëherë kur
edhe kishte
filluar regjistri
administrativ
për të.**

gjatë vitit 1477-1478, kemi 27 hane, 4 mücerrad, 3 bive; në vitin 1486-1487, nuk ka pasur regjistrime për këtë lagje; në vitin 1525-1526, 24 hane, 1 mücerrad, 1 bive, 9 baştina; në vitin 1544-1545, 35 hane dhe 3 mücerrade dhe në vitin 1569-1570, 34 hane. Në Mëhallën Virilaço, në defterin tapu tahrir të vitit - 1477 1478 kemi 46 hane, 7 mücerrade, 10 bive të regjistruara; në vitin 1487-1486 nuk kemi regjistrime për këtë mahall; në vitin 1525-1526, 45 hane, 1 mücerrad, 3 bive, 6 baştina; në vitin 1544-1545, 45 hane, 4 mücerrade, 1 bive dhe në vitin 1569-1570, 65 hane. Në Mëhallën Kusrik, në regjistrimet e defterit tapu tahrir të vitit 1478-1477, kemi 20 hane, 4 mücerrade, 5 bive; në vitin 1486-1487 nuk ka regjistrime, në vitin 1525-1526, 19 hane, 2 bive, 1 mücerrad; në vitin 1544-1545, 22 hane, 2 mücerrad, ndërsa në vitin 1569-1570 nuk ka shënime për këtë mëhallë. Në Mëhallën Latine kemi regjistrim vetëm si bashkësi. Në vitin 1486-1487, janë të regjistruara 4 hane, 1 mücerrad dhe 3 bive; në vitin 1525-1526 kemi

5 hane, 3 bive dhe 4 baştina; në vitin 1544-1545, kemi 9 hane, 1 mücerrad, 1 bive; ndërsa në vitin 1569-1570 regjistrohet si Mahalle-i Katolik me 6 hane. Në Mëhallën Lukar, gjatë vitit 1477-1478, kemi 27 hane, 3 mücerrad, 2 bive të regjistruara; në vitin 31 ,1487-1486 hane, 5 mücerrad, 5 bive: në vitin 1525-1526, 17 hane, 1 mücerrad, 6 baştina; në vitin 1544-1545, mëhalla përbëhej nga, 28 hane, 2 mücerrad, 1 bive; në vitin 1569-1570 nuk ka regjistrime për këtë lagje.¹⁵

Demografia e Prishtinës ndër vite ndryshonte. Sipas një defteri, i cili nuk ka datë, numri i popullsisë ishte 1601. Në regjistrimin e vitit 1486-1487, numri i popullsisë ishte 1450; në vitin 1519 kishte 1644 banorë; në vitin 1525-1526 kishte 2122 banorë; në vitin 1530 kishte 2402 banorë; në vitin 1544-1545 kishte 2140 banorë.¹⁶ Siç shihet, në regjistrimin e vitit 1545-1544 ka rënie të numrit të popullsisë, megjithatë arsyet janë të panjohura deri më sot. Gjatë kësaj periudhe 58 vjeçare, të regjistrimeve, numri i popullsisë myslimane rritej për 12%, ndërsa i asaj jomyslimane zvogëlohej për 12%.¹⁷

EKONOMIA NË PRISHTINË GJATË SHEKUJVE XVI DHE XVII

Politika osmane mbi ekonominë në Ballkan fillimisht ishte e vendosur mbi taksat. Nga regjistrimet e defterit Arvanid, përkthyer nga Halil Inalciku, osmanët kishin vendosur taksën e quajtur ispençe, me një shifër 25 akçe për popullsinë jomyslimane (meshkujt e martuar). Gratë e veja (Dul Kadınlar), paguanin një taksë prej 6 akçeve. E njëjta vazhdoi edhe në periudhën e Sulltan Mehmetit II, i cili në Kanunnamenë e tij, e vazhdoi të njëjtën politikë. Ndërsa në shek. XVI, pagesa për ispençe varionte deri në 30 akçe.¹⁸ Lidhur me ispençën ka pasur diskutime, ku disa dijetarë osmanë e kanë shpallur atë si jo legjitime dhe bidat, pasi që

Produkti / Objekti tatimor	Lloji i taksës	Sasia (vukiyye)	Sasia e përafërt në kg	Vlera në akçe
Grurë (Buğday)	Öşr	383	≈ 491.7 kg	5.745 akçe
Elb (Erzen)	Öşr	163	≈ 209 kg	1.635 akçe
Tërshërë (Yulaf)	Öşr	25	≈ 32.1 kg	485 akçe
Thekër (Çavdar)	Öşr	35	≈ 44.9 kg	355 akçe
Misër (Daru)	Öşr	5	≈ 6.4 kg	55 akçe
Vreshta (Bağat)	Öşr	855	≈ 1.096 kg	16.655 akçe
Burçak (lloj bishtajorjeje)	Öşr	25	≈ 32.1 kg	255 akçe
Mulli (Asiyab)	Öşr	1 njësi	-	155 akçe
Vegël mulliri (Tekne)	Resmî	1 njësi	-	1.555 akçe

ku ekziston xhixja (cizye), vendosja e ispençes ishte jo legjitime në juridiksionin e sheriatit islamik.¹⁹ Megjithatë kjo taksë e vazhdoi funksionin e saj dhe e njëjta u zbatua edhe në Prishtinë, si pjesë e politikës osmane mbi ekonominë e bazuar nga të ardhurat e tokës. Nga regjistrimi i vitit 1477-1478, në Prishtinë ishin grumbulluar 9.434 akçe, si rezultat i mbledhjes së ispençes. Ispençe ishte marrë për 329 hane sa ishin ekzistente në këtë vit dhe 33 për mucerrade.²⁰ Në një nga defterët tahrir pa datë, nga ispençe ishin grumbulluar 7.665 akçe, nga 269 hane, 24 mucerred dhe 55 bive.²¹ Në vitin 1526-1525, nga 265 hane, 14 mucerred, 50 bive ishin grumbulluar 8.128 akçe. Në vitin 1544-1545, nga 322 hane, 34 mucerred, 5 bive, janë grumbulluar 8.986 akçe.²² Nga taksat e grumbulluara në Prishtinë në përgjithësi, jo vetëm nga ispença, të ardhurat shkonin deri në 53.319 akçe, bazuar në një defterë pa datë. Në vitin 1486-1487, ishin 25.401 akçe; në vitin 1525-1526, 65.801 akçe; në vitin 1544-1545, 76.940 akçe.²³ Në pronën e sulltanit (Prishtinë Sultan Hassi), në vitin 1487 kishte 26.204 akçe të ardhura; në vitin 1527, kishte 65.801 akçe të ardhura.²⁴ Në Zeamet-i Prishtinë hass-ı mir-liva (Zeamet e Prishtinës, toka e të drejtës së mir-liva-s (komandantit të lartë të sanxhakut), regjistrin për Nefs-i Bazar-ı Prishtinë (Të ardhurat e pazarit të Prishtinës), të ardhurat janë regjistruara 348.497 akçe.²⁵ Përpos saj, u ndërmorrën taksa për produktet bujqësore, taksë kjo e cila quhej öşr (muqasama), ku u mor fitimi nga 1/10 e produkteve bujqësore. Kështu në Nefs-i Prishtinë, taksapaguesit e taksës Öşr, në vitin 1477-1478, taksat që kanë dhënë banorët e qytetit të Prishtinës që merren me bujqësi dhe kopshte vijnë kështu: Sipas dokumentit, për grurin (buğday) është mbledhur një taksë bujqësore e tipit öşr (taksë osmane për 1/10 të prodhimit), me sasi 383 vukiyye, që i bie afërsisht 491.7 kilogramë, dhe me një vlerë monetare prej 5.745 akçe. Po ashtu, për elbin (erzen) janë regjistruar 163 vukiyye (rreth 209 kg) me vlerë 1.635 akçe, ndërsa për tërshërën (yulaf) janë mbledhur 25 vukiyye (rreth 32.1 kg), me vlerë 485 akçe. Për thekrën (çavdar) janë shënuar 35 vukiyye (rreth 45 kg) me vlerë 355 akçe dhe për misrin (daru) janë regjistruar 5 vukiyye (rreth 6.4kg) me vlerë 55 akçe. Për vreshtat (bağat), taksa e mbledhur ishte 855/16.655, Öşr-i burçak: 25/255; Öşr-i asiyab: 1/155, Resm-i tekne 1.555.²⁶

Të dhënat e taksave bujqësore në Nefs-i Prishtinë (1477–1478)²⁷


- 1 BOA, TT: 133; OAK: 45-/23; BOA, TT: 9.
- 2 BOA, TT: 977; BOA, TT: 167.
- 3 BOA, TT: 1057; BOA, TT: 22; BOA, TT: 977; BOA, TT: 133; BOA, TT: 167; BOA, TT: 167.
- 4 Tahir Sezen, *Osmanlı Yer Adları*, (Ankara: Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Yayını, 2006), 413.
- 5 BOA, TT: 234.
- 6 Raif Vırmaç, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri I*, (Ankara: T.C Kültür Bakanlığı Osmanlı Eserleri, 1999), 204; Hava Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, (Konya: Çizgi Yayınları, 2016), 28-29.
- 7 Vırmaç, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri I*, 211.
- 8 Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 30.
- 9 BOA, TT: 22.
- 10 BOA, TT: 1057.
- 11 BOA, TT: 234.
- 12 Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 34.
- 13 BOA: TT, 1048; BOA: TT, 22; BOA: TT, 133; BOA: TT, 234; BOA: TT, 1081; Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 34; Vırmaç, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri I*, 204.
- 14 BOA: TT, 1048; BOA: TT, 22; BOA: TT, 133; BOA: TT, 234; BOA: TT, 1081; Selçuk: 2016, 34; Vırmaç: 1999, 204
- 15 BOA: TT, 1048; BOA: TT, 22; BOA: TT, 133; BOA: TT, 234; BOA: TT, 1081; Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 34-36; Vırmaç, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri I*, 204.
- 16 Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 38.
- 17 Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 40.
- 18 Halil Inalcik, *Osmanlı İdare ve Ekonomik Tarihi*, (İstanbul: İslam Yayınları, 2011), 81.
- 19 Selçuk, *Osmanlı İdaresinde Prishtine*, 41.
- 20 BOA: TT, 1048
- 21 BOA: TT, 1057
- 22 BOA: TT, 234
- 23 BOA: TT, 1057; BOA: TT, 22; BOA: TT, 133; BOA: TT, 234
- 24 Nikolai Todorov, *The Balkan City 1400-1900*, (Seattle: Washington University, 1983), 468.
- 25 BOA: TT, 22.
- 26 BOA: TT, 1048.
- 27 BOA: TT, 1048.

Kontributi i vëllezërve Benu Musa në zhvillimin e shkencës (shekulli IX)

Artan S. Mehmeti

MUHAMED (803 – 872)

*E*bu Xhafar Muhamed ibën Musa ibën Shakiri, ishte më i madhi nga vëllezërit Benu Musa. Ai lindi në qytetin e Bagdadit (Irak), në kohën kur kjo qendër lulëzonte si një metropol i dijes nën kalifatin Abbasid. Ebu Xhafari ishte i njohur për kontributin e tij të shquar në matematikë, astronomi, gjeografi dhe inxhinieri, si dhe për ndihmën e tij në përkthimin dhe zhvillimin e veprave shkencore greke dhe indiane.



AHMED (805 – 873¹)

*E*bu el Kasim Ahmed ibën Musa ibën Shakiri, i dyti ndër vëllezërit, lindi gjithashtu në Bagdad. Ai spikati në fushën e teknologjisë mekanike dhe ishte i njohur për ndërtimin e makinerive dhe pajisjeve automatike. Ahmedi kontribuo i zhvillimin e robotikës së hershme dhe inovacioneve inxhinierike, përfshirë mjete automatike për matje dhe rregullim të lëvizjes së ujit, si dhe në astronomi, gjeografi dhe matematikë.

EL HASAN (810 – 873)

El Hasan ibën Musa ibën Shakiri ishte më i vogli ndër vëllezërit Benu Musa dhe një kontribuues i rëndësishëm në astronomi, gjeografi, matematikë dhe fizikë. Ai bashkëpunoi ngushtë me vëllezërit e tij në projekte shkencore dhe përkthime.

Të tre vëllezërit, Muhamedi, Ahmedi dhe El Hasani, u bënë të njohur në literaturën e historisë së shkencës islame me emrin e përbashkët Benu Musa (bijtë e Musait), duke u përmendur shpeshherë edhe si “tre vëllezërit”.

Musa ibën Shakiri, studiues i njohur i periudhës abbaside, jetoi dhe veprroi në Bagdad gjatë sundimit të kalifit El Me'mun er Rashid, me të cilin mbante marrëdhënie të afërta. Musa ibën Shakiri ishte i interesuar në astronomi dhe astrologji. Pas vdekjes së Musa ibën Shakiri, kalifi u bë kujdestar i vëllezërve Benu Musa, i cili ia besoi ata Is'hak bin Ibrahim el Musabit, i cili në të kaluarën e tij kishte qenë mëkëmbës i Bagdadit. Vëllezërit u rritën në një mjedis shkencor dhe atyre iu dha edukimi më i mirë i mundshëm në Bagdad, ku studionin gjeometrinë, mekanikën, matematikën dhe

astronominë, kurse edukimin e tyre e kishte marrë përsipër Jahja bin Ebu Mensuri, i cili ishte një ndër dijetarët e shquar të asaj kohe. Më vonë, ata u vendosën në Bejt el Hikma (Shtëpia e Urtësisë), ku drejtuan një bibliotekë të rëndësishme, një observator astronomie, si dhe një qendër përkthimi të veprave filozofike dhe shkencore greke. Me kalimin e kohës, vëllezërit Benu Musa u renditën ndër dijetarët më të shquar të Bejt el Hikma, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e shkencave natyrore dhe matematikore brenda këtij institucioni shkencor. Më i madhi i tyre, Ebu Xhafer Muhamedi ishte një shkencëtar me njohuri të gjera për gjeometrinë, yjet dhe “Almagestin”. Ahmedi ishte një ekspert dhe shpikës në fushën e inxhinierisë mekanike. El Hasani kishte një mjeshtëri të madhe në gjeometri.

Vëllezërit Benu Musa përfaqësojnë një figurë kyçe në zhvillimin e shkencave natyrore në periudhën e artë të shkencës islame, veçanërisht në fushat e astronomisë, kozmografisë dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejt edhe në gjeografi. Kontributet e tyre ishin të ndërlidhura ngushtë me vëzhgime empirike, ndërtimin e instrumenteve, zhvillimin e metodologjive të matjes dhe interpretimit të lëvizjeve të trupave qiellorë, si dhe me rishikimin dhe përmirësimin e njohurive ekzistuese.

“Kitab Harakat el falak el ula” është një vepër tashmë e humbur. Në burimet historike, kjo vepër njihet gjithashtu me titujt “Kitab el Haja” dhe “Kitab bajjana fihi bi tarik ta’limi va madhhab handasi annahu lajsa fi kharij kurat el kavakib el thabitah kurah tasi’ah”. Në këtë vepër, autori shqyrton modelin gjeocentrik të Ptolemeut mbi strukturën e universit, i cili parashtron ekzistencën e një sferë të nëntë, përgjegjëse për lëvizjen e përbashkët të të gjithë trupave qiellorë. Në kundërshtim me këtë model, vëllezërit Benu Musa, veçanërisht Ahmedi, propozojnë një teori alternative, sipas së cilës trupat qiellorë, përfshirë Diellin, Hënën, planetët dhe yjet, nuk varen nga një forcë e vetme e jashtme apo nga një sferë shtytëse, por lëvizin në mënyrë autonome, të udhëhequr nga parime të brendshme natyrore. Kjo qasje përfaqëson një shkëputje nga kozmologjia tradicionale e Ptolemeut dhe dëshmon për një evolucion të mendimit



Me kalimin e kohës, vëllezërit Benu Musa u renditën ndër dijetarët më të shquar të Bejt el Hikma, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e shkencave natyrore dhe matematikore brenda këtij institucioni shkencor.

shkencor drejt një konceptimi më kompleks, më racional dhe më fleksibil të universit. Po ashtu Muhamed ibën Musa, në këtë libër, zbuloi dhe e sqaroi në mënyrë të detajuar se ekzistonte një forcë tërheqëse në mesin e trupave qiellorë, duke lënë kështu nën hije ligjin e Njutonit për gravitacion universal. Në kuadër të këtyre studimeve, vëllezërit Benu Musa i kushtuan vëmendje edhe dukurive meteorologjike, duke regjistruar në mënyrë sistematike vërtetimet e tyre mbi ndryshimet klimatike dhe atmosferike.

Me urdhër të kalifit El Mëmun er Rashid, vëllezërit Benu Musa u angazhuan në një projekt shkencor madhor për matjen e një shkalle të gjerësisë gjeografike të Tokës, i cili u realizua përmes vërtetimeve dhe matjeve empirike në shkretëtirën e Mesopotamisë Veriore. Duke u mbështetur në metoda të avancuara matematikore dhe astronomike, ata matën lartësinë e Yllit Polar nga dy pika të ndryshme në Veri dhe Jug, me qëllim të përcaktimit të ndryshimeve në këndin e ngritjes së këtij ylli në varësi të gjerësisë gjeografike. Nëpërmjet përdorimit të parimeve të trigonometrisë, ata llogaritën perimetrin e Tokës në rreth 24.000 milje (afërsisht 38.624 kilometra), një vlerësim jashtëzakonisht i saktë për kohën, me vetëm 3.6 % devijim nga vlera e pranuar sot prej 40.075 kilometrash. Kjo arritje dëshmon nivelin e lartë të dijes së tyre shkencore dhe aftësinë për të aplikuar metoda teorike në

zgjidhjen e problemeve praktike. Këto arritje pasqyrohen në veprën e tyre të njohur “Kitab ma’rifat masahat el ashkal el basitah va-el kurijjah”, në të cilën trajtohen mënyrat e llogaritjes së sipërfaqeve gjeometrike (matja e sipërfaqeve të thjeshta dhe atyre sferike), me një saktësi të lartë për kohën. Edhe pse përshkrimi i plotë i matjes së perimetrit të Tokës nuk ruhet drejtpërdrejt në këtë vepër, shumë burime dytësore dhe historianë të shkencës e përmendin këtë matje si një nga arritjet më të mëdha të vëllezërve Benu Musa në fushën e gjeografisë matematike dhe astronomisë praktike. Ky kontribut përfaqëson një nga përpjekjet më të avancuara të shekullit IX, për të kuptuar përmasat dhe formën e Tokës.


Përveç këtij projekti madhor, vëllezërit Benu Musa, në “Kitab ma’rifat masahat el ashkal el basitah va-el kurijjah”, publikuan edhe *vrojtime* sistematike të trupave qiellorë, me fokus të veçantë lëvizjen e Diellit dhe të Hënës në kupën qiellore të kryera nga qyteti i Bagdadit. Këto vrojtime, që u realizuan me instrumentet më të avancuara të kohës, shërbyen si burim bazë për ndërtimin e teorive të sakta mbi lëvizjet periodike të trupave qiellorë dhe ndikimin e tyre në ndryshimet sezonale, si dhe në hartimin e kalendarit diellor. Duke u bazuar në të dhënat që i fituan nga *vrojtime* sistematike, vëllezërit Benu Musa, arritën në përfundimin se gjatësia e një viti ishte 365 ditë dhe 6 orë, një vlerësim tejet i afërt me përllogaritjet moderne. Kjo saktësi është e rëndësishme duke marrë parasysh faktin se, për shkak të këtij “teprimi” prej 6 orësh, edhe sot e kësaj dite, një herë në katër vjet, kalendarit i shtohet një ditë (29 shkurti) për ta balancuar vitin diellor. Për më tepër, vëllezërit realizuan edhe vrojtime astronomike të detajuara, përfshirë ato të yllit Regulus, të cilat i kryen nga shtëpia e tyre e ndërtuar mbi një urë në Bagdad, në periudhat 840/41, 847/48 dhe 850/51. Këto vrojtime dëshmojnë për një nivel të avancuar të njohurive dhe instrumenteve të përdorura prej tyre në shekullin IX.

Libri i titulluar “Kitab el Daraj” i vëllezërve Benu Musa paraqet një kontribut të rëndësishëm në fushën e astronomisë gjatë shekullit IX, në kuadër të traditës shkencore

Arritën në përfundimin se gjatësia e një viti ishte 365 ditë dhe 6 orë, një vlerësim tejet i afërt me përllogaritjet moderne.

islame. Vepra trajton në mënyrë të detajuar strukturën e universit dhe lëvizjet e trupave qiellorë, duke ofruar një studim të avancuar dhe të përmirësuar të modelit Ptolomeut. Autorët propozojnë përmirësime në teorinë e epicikleve dhe deferenteve, me qëllim rritjen e saktësisë në llogaritjet astronomike. Përveç aspekteve teorike, libri përfshin edhe udhëzime praktike për ndërtimin e instrumenteve astronomike, si astrolabet, duke shërbyer si burim i rëndësishëm për dijetarë si El Battani dhe El Hejthemiu. I punuar në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad, ky libër pati një ndikim jashtëzakonisht të madh në avancimin e astronomisë në botën islame. Edhe pse në disa burime historiko-shkencore, si autor të këtij libri e përmendin Thabit ibën Kurrani, rolin kryesor në avancimin e astronomisë teorike dhe praktike, e bartin vëllezërit Benu Musa.

“Kitab fi ‘Amel el Asturlab”, është një ndër librat më të hershme të hartuar në fushën e astronomisë praktike dhe instrumenteve shkencorë, me fokus të veçantë në ndërtimin dhe përdorimin e astrolabit. Libri ofron një studim të thelluar dhe të strukturuar mbi ndërtimin e këtij instrumenti, duke përfshirë udhëzime të detajuara për kryerjen e matjeve astronomike, përcaktimin e kohës, lartësinë e yjeve dhe pozicionin e trupave qiellorë. Po ashtu, në këtë libër, vëllezërit Benu Musa shpjegojnë parimet gjeometrike dhe matematikore që përbëjnë bazën e funksionimit të astrolabit, me theks të veçantë te projeksionet sferike dhe lidhjet ndërmjet lëvizjeve të objekteve qiellore dhe paraqitjes së tyre në këtë instrument astronomik. Përveç përdorimeve tradicionale, vepra paraqet edhe aplikime inovative në fushat e navigacionit, gjeodezisë dhe përcaktimin e kohëve të namazeve, duke dëshmuar një qasje të gjithanshme dhe ndërdisiplinore. Kjo vepër nuk është thjesht një manual teknik, por një dëshmi e avancimit shkencor në epokën islame, me ndikim të thellë në zhvillimin e instrumenteve astronomike si në botën islame, ashtu edhe në atë perëndimore. Kontributi i vëllezërve Benu Musa përmes kësaj vepre mbetet një gur themeli në historinë e shkencës.



Një tjetër libër i rëndësishëm në fushën e astronomisë, i përpiluar nga vëllezërit Benu Musa, është “Kitab fi Sanat el Shams bil Irshad”. Kjo vepër paraqet një studim të detajuar të lëvizjeve diellore, bazuar në vërtetimet astronomike të sakta dhe të sistematizuara. Në kuadër të këtyre studimeve, vëllezërit Benu Musa, analizojnë në mënyrë të detajuar rrotullimin e Tokës rreth Diellit (revolucionin), duke përfshirë periudhat e ekuinokseve (pranveror dhe vjeshtor) dhe solsciteve (verore dhe dimërore), si dhe ndryshimet sezonale të gjatësisë së ditës dhe natës. Autorët përshkruajnë metodologjinë e tyre të vëzhgimit përmes përdorimit të instrumenteve të specializuara, si kuadrantët dhe astrolabët, duke dëshmuar njohuri të avancuara, në kontekstin e ndërveprimeve ndërmjet lëvizjeve diellore dhe fenomeneve të tjera hapësinore. Prioriteti i dhënë mbledhjes së të dhënave empirike dhe përsëritjes sistematike të matjeve, pasqyron një qasje metodologjike rigoroze, e cila jo vetëm që i paraprin, por edhe kontribuon në formësimin e metodave bashkëkohore të astronomisë.

Përveç kontributit të saj teorik në kontekstin e zhvillimeve shkencore gjatë periudhës së artë islame, “Kitab fi Sanat el Shams bil Irshad” ofron edhe aplikime të natyrës praktike në një sërë fushash, përfshirë bujqësinë, menaxhimin e burimeve ujore dhe organizimin e kalendarëve. Kjo dëshmon për një qasje

Prioriteti i dhënë mbledhjes së të dhënave empirike dhe përsëritjes sistematike të matjeve, pasqyron një qasje metodologjike rigoroze, e cila jo vetëm që i paraprin, por edhe kontribuon në formësimin e metodave bashkëkohore të astronomisë.

funkionale, ndërdisiplinore dhe të orientuar drejt nevojave konkrete të shoqërisë së kohës. Si një ndër veprat më të rëndësishme të shkencës islame të shekullit IX, ky studim pasqyron nivelin e avancuar të astronomisë observative dhe rolin thelbësor të dijetarëve myslimanë në integrimin e dijeve teorike me aplikime praktike, në funksion të jetës së përditshme dhe zhvillimit shoqëror. Në disa studime historike mbi zhvillimin e shkencës gjatë periudhës së artë islame, ky libër i është atribuar Thabit ibën Kurrasë, një prej studiuesve më të njohur të asaj periudhe.

Libri me titull “Ruj’at el Hilal ‘ala Ra’j Ebu Xhafer”, i përpiluar nga vëllezërit Benu Musa, përbën një studim të specializuar mbi vëzhgimin e Hënës së re (hilalit) dhe rolin e saj në përcaktimin e fillimit të muajve hënorë në kalendarin islam. Bazuar në teoritë shkencore të Ebu Xhafar Muhamed ibën Musa, ky libër ofron një analizë të detajuar të faktorëve astronomikë dhe atmosferikë që ndikojnë në dukshmërinë e hilalit. Në bazë të teorive gjeometrike dhe parimeve trigonometrike, autorët përcaktojnë kohën dhe vendin optimal për vëzhgim, duke realizuar një analizë të detajuar të pozicioneve të Hënës, Diellit dhe vëzhguesit në Tokë. Për ta realizuar një studim të detajuar të pozicioneve të Diellit, Hënës dhe vëzhguesit në Tokë, vëllezërit Benu Musa kombinuan teoritë trigonometrike dhe parimet



gjeometrike për të përcaktuar vendin më të përshtatshëm për kryerjen e vëzhgimeve të tyre. Përveç aspektit teknik, libri trajton edhe çështje ligjore dhe fetare që lidhen me fillimin e muajit Ramazan dhe festave islame, duke reflektuar një bashkëveprim të ngushtë midis shkencës dhe normave fetare. Me një qasje integruese ndërmjet praktikës dhe teorisë, vëllezërit Benu Musa vendosën standarde të reja në fushën e astronomisë islame, duke ushtruar një ndikim të thellë dhe afatgjatë mbi dijetarët e mëvonshëm dhe zhvillimin e shkencës në botën islame. Kjo vepër përbën një kontribut të rëndësishëm në ndërthurjen e njohurive shkencore me praktikën dhe ritualet fetare, duke reflektuar kështu lidhjen e ngushtë midis shkencës dhe jetës së përditshme në kulturën islame.

Ndër veprat e tjera të rëndësishme të vëllezërve Benu Musa, në fushën e astronomisë është libër i humbur i titulluar “Kitab bad’ el ‘alam”, që i atribuohet Muhamed ibën Musës. Gjithashtu, Ahmed ibën Musa është autor i një “Zixhi”, që përmban të dhëna për llogaritjen e pozicioneve të trupave qiellore, i përmendur nga Ibën Junusi rreth vitit 990 në veprën e tij me titull “Ez Zixh ‘ul kebir el hakimij”. Përveç kësaj, Ibën Junusi gjithashtu e cek edhe një “Zixhi” tjetër të humbur të vëllezërve Benu Musa. Një tjetër kontribut i tyre fushën e shkencës së astronomisë është përkthimi i një vepre kineze me titullin “A Book of Degrees on the Nature of Zodiacal Signs”. Përkthimi i kësaj vepre dëshmon angazhimin e vëllezërve Benu Musa për të ndërthurur njohuritë astronomike të kulturave të ndryshme me traditën shkencore islame, duke kontribuar në zhvillimin e një qasjeje ndërkulturore në astronominë mesjetare.

Burimet:

- Prof. dr. Fuat Sezgin, *Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë Islame*, përkthet nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup 2015.
- Sami Frashëri, *Qytetërimi Islam*, LOGOS-A, Shkup 2009,
- Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin – Trashëgimia jonë arabe, Shqipëroi nga frëngjishtja Ornela Ademovi, Tiranë 2007.
- HALIMAAL-GHRARI, ARKITEKTËT E MENDIMIT SHKENCOR NË QYTETËRIMIN ISLAM Vula nga biografitë e dijetarëve myslimanë **në periudha të ndryshme**, nga arabishtja në anglisht e përkthet: Abdulaziz HAUARIA, Përkthet nga gjuha angleze: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. B-O-O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë, 2020.
- Ahmed Essa, Othman Ali, *Studime në Qytetërimin Islam – Kontributi Mysliman në Rilindje*, përkthet: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë, 2019.
- Besart Shala, *Dituria islame*, nr. 230, shtator, 2009.
- https://en.wikipedia.org/wiki/Banu_Musa
- https://mathshistory.st-andrews.ac.uk/Biographies/Banu_Musa/,
- <https://muslimheritage.com/the-mechanics-of-banu-musa-in-the-light-of-modern-system-and-control-engineering/>,
- <https://www.iranicaonline.org/articles/banu-musa-the-name-applied-to-three-brothers-abbasid-astronomers-whose-father-was-musa-b/>,
- <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=16683>,
- https://www.thesciencefaith.com/muslim-heroes/muslim-scientists/banu-musa-family-of-honor/?utm_source=chatgpt.com,
- Data e vdekjes së dy vëllezërve Banu Musa nuk është dokumentuar në mënyrë të saktë për secilin veç e veç. Shumica e burimeve historike përmendin vitin 873 si referencë të përbashkët, pasi ata jetuan dhe vepruan në periudha të afërta dhe mungojnë të dhëna të detajuara biografike. Për këtë arsye, 873 përdoret si datë e përgjithshme e vdekjes së tyre në literaturën shkencore.

“40-vjet nga botimi i shqipëruar i Kuranit fisnik”

REPORTAZH PËR AKADEMINË SOLEMNE ME RASTIN E 40-VJETORIT TË PËRKTHIMIT TË PLOTË TË KURANIT FISNIK NË GJUHËN SHQIPE

“40-vjet nga botimi i shqipëruar i Kuranit fisnik” – titullohej Akademia solemne, e organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, e cila rikthente në kujtesë një nga ngjarjet më të rëndësishme që i dha gjuhës shqipe një peshë të re shpirtërore dhe kulturore, atë të përkthimit të kuptimeve të Librit të Zotit, Kuranit fisnik, përkthyer nga akademiku Feti Mehdiu. Përreth vetes kjo Akademi, e mbajtur më 15 tetor 2025, kishte mbledhur studiues, njerëz të dijes dhe të kulturës, akademikë dhe mysafirë të tjerë.

Kjo ngjarje, pra përkthimi i kuptimeve të Kuranit fisnik, u tha se ishte më tepër sesa një proces gjuhësor, duke u cilësuar kështu si një akt fetar, kulturor dhe identitar, një gurthemel, i cili i dha gjuhës shqipe mundësinë që të bartë brenda vetes një nga tekstet më të shenjta për besimtarët myslimanë.

PËRKTHIMI I KUPTIMEVE TË KURANIT – DËSHMI SE KOMBI YNË KA DIJETARË

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij para të pranishmëve, e cilësoi këtë ngjarje si një nga kulmet e përpjekjeve intelektuale, gjuhësore dhe shpirtërore të kombit tonë. Ai tha se, në mesin e shumë aktiviteteve shkencore që organizohen në vendin tonë dhe më gjerë, ky aktivitet është veçanërisht i dalluar, jo vetëm për tematikën që trajton, por për thellësinë që përfaqëson dhe dritën që shpërndan.

“Të përkthesh kuptimin e Kuranit, ashtu si bëri me devotshmëri, përkushtim dhe guxim profesional profesor Feti Mehdiu, është një kurorëzim i suksesit, por edhe një afim më i madh të mëshira dhe shpërblimi të Zotit xh.sh.,





duke e bërë këtë jo vetëm një arritje fetare, gjuhësore apo akademike, por edhe një dëshmi se si besimi, dija dhe përkushtimi mund të bashkohen për të bërë historinë. Një komb që e ka të përkthyer kuptimin e Kuranit në gjuhën e tij, e njeh më mirë fenë dhe kulturën e vet, ai e gjen veten pjesë të një bote shpirtërore të gjerë, pa humbur gjë nga identiteti i tij kombëtar” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Myftiu Tërnavë, më pas, vazhdoi dhe tha se, përkthimi i kuptimeve të ajeteve të Kuranit fisnik, është një dëshmi se kombi ynë ka dijetarë, gjuhëtarë dhe studiues që janë të aftë ta bartin fjalën hyjnore në gjuhën e tyre me respekt dhe saktësi, duke treguar kështu se, përkthimi i kuptimit të Kuranit në gjuhët e ndryshme të botës nuk është vetëm i lejuar, por është i nevojshëm, në mënyrë që fjala e Zotit të kuptohet e të zbatohet.

“Përkthimi paraqet një urë mes kulturës islame dhe trashëgimisë kombëtare, duke treguar se besimi dhe identiteti kombëtar mund të bashkëjetojnë në harmoni. Botimi i përkthimit të kuptimeve të Kuranit në shqip këtu e 40-vjet më parë, pra më 1985, s’ka dyshim se përfaqëson një moment historik për kulturën islame shqiptare, një pikë kthese në qasjen tonë ndaj tekstit hyjnor. Përmes këtij përkthimi, Fjala e Zotit, e shpallur në gjuhën arabe, filloi të kumbojë qartë në gjuhën e zemrës dhe mendjes së shqiptarëve, duke u bërë më e afërt, më e kuptueshme dhe më e perceptueshme për miliona besimtarë shqiptarë dhe studiues. Vetë urdhri i Zotit për ta sqaruar Kuranin, e bën të domosdoshëm përkthimin e tij në gjuhët e ndryshme të botës, që mesazhi hyjnor të mos mbetet i mbyllur në një gjuhë të vetme, por të arrijë te të gjithë njerëzit, ashtu siç është edhe vetë qëllimi i shpalljes.”

Myftiu Tërnavë, më pas tregoi edhe për pamundësinë e përkthimit të fjalëpërfjalshëm të Kuranit, duke përmendur kështu ajetin kuranor, në të cilin Zoti i Madhëruar thotë: “Sikur të ishte deti ngjyrë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, deti (uji i tij) do të shterej para se të përfundojnë, fjalët e Zotit tim, e sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti).” (El Kehf, 109).

Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, foli edhe për shpërblimin që ka përkthyesi i kuptimeve të Kuranit, duke thënë se ai ka kryer një detyrë që kontribuon drejtpërdrejt në përcjelljen e mesazhit të Zotit në këtë botë. “Shpërblimi i përkthimit të kuptimeve të Kuranit qëndron në përhapjen e mesazhit të Islamit dhe përcjelljen e udhëzimeve të tij tek njerëzit në gjuhët e tyre. Pra, përfshirja dhe marrja me Kuran është një nga format më të mira të adhurimit të Zotit xh.sh.. Zoti i shpërbleftë të gjithë ata që kanë kontribuar në mësimin, interpretimin, komentimin dhe përhapjen e Kuranit te ne dhe më gjerë.”

PRANIA E KURANIT TE SHQIPTARËT ËSHTË E HERSHME SA EDHE PRANIA E ISLAMIT

Drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në BIK, Ramadan Shkodra, në fjalën e tij, tha se shënimi i përvjetorëve të veprave të mëdha nuk është vetëm një rikthim në histori, por është një akt i vetëdijshëm kulturor dhe shkencor, që na fton të reflektojmë mbi rrugëtimin e dijes dhe të besimit, mbi zhvillimet që kanë pasuar dhe mbi vlerat që mbeten të qëndrueshme në kohë.

“Përvjetorët na kujtojnë se veprat e mëdha nuk i përkasin vetëm një brezi apo epoke, por janë pasuri e gjallë e kujtesës dhe e frymëzimit, që ushqen brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Në këtë frymë nderimi dhe reflektimi, sot kujtojmë dhe vlerësojmë një ndër arritjet më të rëndësishme të mendimit islam dhe të kulturës kombëtare shqiptare, botimin e plotë të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe, të realizuar në Prishtinë më 1985 nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe përkthyer me përkushtim, dije të thellë dhe ndjeshmëri gjuhësore nga profesor Feti Mehdiu, i cili hapi rrugën e një epoke të re të komunikimit ndërmjet besimit dhe gjuhës, duke e bërë fjalën e Zotit të kuptueshme për çdo shqiptar, që dëshiron ta lexojë dhe ta përjetojë Kuranin në gjuhën e vet amtare.”

Ai tha se ndikimi i gjithanshëm i Kuranit në historinë e dijes dhe të qytetërimit ka bërë që ai të përkthehet ndër shekuj në rreth njëqind gjuhë të botës, për t’u bërë kështu i kuptueshëm për njerëz të kombeve dhe kulturave të ndryshme.

“Përkthimi është dëshmi jo vetëm e pasurisë shprehëse dhe forcës shpirtërore të gjuhës shqipe, por edhe i pjekurisë profesionale dhe përgjegjësisë institucionale të studiuesve dhe të institucioneve islame shqiptare. Ai është dëshmi se në hapësirën tonë kulturore, feja dhe gjuha kanë ecur bashkë, duke i vënë në shërbim të njëra-tjetrës dijen, urtësinë dhe përhapjen e vlerave universale të paqes, drejtësisë dhe mëshirës që përçon Kurani.”

Në fund të fjalës së tij, drejtori Shkodra, foli edhe rreth përpjekjeve të përkthimeve të Kuranit fisnik në gjuhën

shqipe, duke thënë se këto i gjejmë që në kohën e Rilindjes Kombëtare.

“S’do mend se interesimi, përkushtimi dhe kontributi i shqiptarëve ndaj dhe për Kuranin janë të hershme dhe të dukshme. Punën e parë serioze në këtë drejtim e ndërmori Ilo Mitkë Qafëzezi, i cili në Ploeshti të Rumanisë, më 1921, botoi në shqip gjashtë suret e para të Kuranit. Ndër nismëtarët për përkthimin e Kuranit gjejmë personalitete të shquara të islamologjisë dhe të atdhetarizmit, si haxhi Vehbi Dibra, hafëz Ali Korça dhe posaçërisht hafëz Ibrahim Dalliu. Me gjithë vullnetin dhe përkushtimin e madh të këtyre kolosëve për ta përkthyer Kuranin në shqip, rrethanat historike nëpër të cilat kaloi Shqipëria dhe shqiptarët nuk e lejuan konkretizimin e këtij misioni. Ky mision u bë realitet vetëm më 1985, falë qarkut të ulemave të Kosovës, që ishin të përqendruar në Prishtinë.”

PËRVJETOR I PËRMASËS KOMBËTARE

Profesori i letërsisë, dr. Hysen Matoshi, duke e cilësuar si një akt të rëndësishëm përkthimin e librave të shenjtë, shtoi se momentet e tilla janë momente të verifikimit të kapaciteteve shprehëse të një gjuhe dhe të emancipimit të folësve të saj, ndërsa koha e përkthimit rëndom përbën kthesë me rëndësi për procese të mëtejme të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor dhe identitar.

“Krahasuar me kohën e pranimit të Islamit si fe me përmasa mbizotëruese në hapësirën etnike shqipfolëse, mund të themi se përkthimi i Kuranit në shqip del si i vonuar. Pavarësisht se botimi i përkthimit të parë të plotë të Kuranit është i një date të vonshme kundruall jetëgjatësisë së Islamit ndër shqiptarët, përkatësisht i vitit 1985, përpjekjet në këtë drejtim janë të periudhave më të hershme. Ne shqiptarët bëjmë pjesë ndër kombet e fundit që e pasurojmë bibliotekën tonë me këtë literaturë kapitale fetare, kulturore e të rëndësishë së gjithëmbarshme shoqërore.”

Profesor Matoshi më pas evokoi kujtime nga koha kur qe përkthyer Kurani fisnik. “E mbaj mend shumë mirë botimin e parë të Kuranit në shqip. Atëbotë isha maturant, ndërsa bashkë me një numër shumë të vogël shokësh iu gëzua sihariqit se fjala e Allahut tanimë po vinte në shqip dhe se shqipja kishte treguar zotësinë e saj leksikore që ta përçonte një vepër fundamentale rëndësinë shumëplanëshe të së cilës e kishte njohur secila kohë, secila hapësirë globale dhe veçmas kushdo që i ishte përmbajtur asaj. Tre vjet më vonë pashë se si në literaturën e letërsisë botërore profesori i asokohshëm i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, Hasan Mekuli, e kishte renditur Kuranin ndër veprat e obligueshme”, megjithëse më pas dha edhe vërejtjet e tij se kësaj ngjarje nuk iu kushtua vëmendja e merituar: “Ndonëse me rastin e botimit të parë të Kuranit në shqip nuk iu kushtua vëmendja e merituar, kjo ngjarje me ndikim në proceset

kulturore e shoqërore u shënuar në periodikun e asokohshëm të vendit, madje edhe në atë jugosllav, si një zhvillim i rëndësishëm për gjuhën shqipe dhe për besimtarët shqiptarë të përkatësisë fetare islame.”

Në fund të fjalës së tij, profesor Matoshi, tha se: “Përkthimi dhe botimi i parë i Kuranit Fisnik në gjuhën shqipe, i pasuar nga disa botime të tjera, e ka zgjeruar dimensionin mendimor të lexuesit shqiptar, por njëkohshëm ka bërë që në shumë shkrime fetare, shkencore, kulturore, letrare etj., të shfaqen si referenca edhe pjesë nga përmbajtja e tij. Përkthimi dhe botimi i Kuranit Fisnik ka ndihmuar edhe sa i përket standardizimit të terminologjisë islame në gjuhën shqipe, ndonëse mbetet ende për të bërë në këtë drejtim. Si një leksik i kufizuar e madje edhe i anashkaluar në fjalorët ekzistues të shqipes, jo rrallë fjalësi islam është plotësuar e saktësuar duke u mbështetur në fjalët a trajtat që janë përdorur në akëcilin përkthim të Kuranit.”

KRENAR QË E SHËNOJ KËTË PËRVJETOR BASHKË ME JU

Përkthyesi i kuptimeve të Kuranit, akademik Feti Mehdiu, për përkthimin e të cilit edhe u mbajt kjo akademi, tha se ndihet i nderuar dhe shumë krenar që këtë përvjetor, pra të përkthimit të kuptimeve të Kuranit, e shënon sot së bashku me gjithë të pranishmit. “Jemi të privilegjuar që shënojmë rrugëtimin 40-vjeçar të përkthimit të parë së bashku me përkthyesin. Allahu ka dashtë që edhe unë ta pres këtë përvjetor e ta shënoj bashkë me ju. Kjo më bën të ndihem edhe më i lumtur dhe krenar. Përkthyesi dhe botuesi i vitit 1985 kanë edhe më shumë arsye të jenë të lumtur dhe krenarë, sepse me këtë botim, gjuha shqipe u radhit me gjuhët e botës, të cilat kanë Librin e shenjtë të përkthyer në gjuhët e tyre. Me këtë u dëshmuar se edhe gjuha shqipe ka potencial dhe bagazh gjuhësor të mjaftueshëm t’i dalë zot gjuhës së Kuranit.”

Ai më pas tregoi edhe për mënyrën e përkthimit të Kuranit, duke thënë se: “Në punën time kam zgjedhur dhe u jam përmbajtur dy parimeve: përkthim më i saktë – më i afërt me origjinalin, ku rrezikohet bukuria, por ruhet saktësia, si dhe transkriptim shkencor dhe transliterim të emrave të përveçëm që janë në Kuran. Këto parime, të mbështetura në teori, e të dëshmuar në fushën e përkthimit, i ruaj edhe sot, pas 40-vjetësh.”

Në fund të fjalimit të tij, akademik Mehdiu, shprehu edhe falënderimet dhe respektin e veçantë, fillimisht për Bashkësinë Islame të Kosovës, që më 1985 realizoi edhe botimin e përkthimit të parë, si dhe për organizimin e kësaj Akademie, duke lutur Zotin e Madhëruar që të festojmë edhe shumë përvjetorë të tjerë.

Bajram Zeqiri

“20-vjet përkushtim me vizion”

DEPARTAMENTI I GRUAS SHËNOI 20-VJETORIN E THEMELIMIT

Departamenti i Gruas, që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, shënoi përvjetorin jubilar të themelimit me moton “20-vjet përkushtim me vizion”. Për dy dekada, ky Departament ka luajtur rol kyç në avancimin e rolit të gruas myslimane në jetën fetare, arsimore dhe shoqërore të vendit.

Në ceremoninë solemne, udhëheqësja e Departamentit, znj. Vaxhide Podvorica-Bunjaku, pasqyroi rrugëtimin e këtij Departamenti që nga themelimi e deri më sot, duke theksuar se ai vazhdon të jetë zë, hapësirë dhe mbështetje për gratë, në të gjitha fushat e jetës.

“Departamenti i Gruas është sektori i vetëm për gra që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili bënë pjesë në Drejtorinë Fetaro-Arsimore pranë këtij institucioni. Misioni ynë është ta fuqizojmë gruan myslimane në të gjitha dimensionet e jetës së saj: fetare, morale dhe

shoqërore. Përmes projekteve, trajnimeve dhe bashkëpunimeve të ndryshme, synojmë të ndërtojmë gjenerata që e ruajnë identitetin fetar, e forcojnë rolin e tyre në familje dhe shoqëri, duke qenë shembull frymëzimi për brezat që vijnë”, - tha ndër të tjera ajo.

Kurse kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, theksoi nevojën e domosdoshme që ishte në atë kohë për krijimin e hapësirave për gratë dhe vlerësoi lart arritjet që sot Departamenti i Gruas numëron falë punës së palodhur dhe përkushtimit maksimal të teologeve.

“Departamenti i Gruas qëndron krenar si një nga shtyllat më të fuqishme, më të begata dhe më frytdhënëse të veprimtarisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ajo që dikur nisi si një vizion i guximshëm, sot është shndërruar në një realitet madhështor, me mbi 300 të punësuarë e të përkushtuarë në shërbim të fesë dhe kombit, me projekte të



qëndrueshme që prekin zemrat e familjeve në tërë Kosovën dhe mërgatën tonë të dashur, e me një rrjet bashkëpunimi që nis nga institucionet tona vendore e arrin deri te partnerët ndërkombëtarë brenda dhe jashtë Kosovës. Ky Departament, i lindur nga nevoja dhe i rritur me sakrificë, është bërë sot zë i fuqizimit, i dinjitetit të gruas shqiptare myslimane, shembull i profesionalizmit dhe urtësisë, një dritare që pasqyron bukurinë e rolit të saj në fe dhe shoqëri. Çdo projekt, çdo aktivitet, çdo kontribut i këtyre dy dekadave flet për mund, për devotshmëri, për përkushtim të thellë dhe për dashuri të pastër për komunitetin”, tha mes të tjerash Myftiu Tërnavë.

Në këtë përvjetor morën pjesë edhe zv.kryeministria në detyrë, znj. Emilje Rexhepi dhe nënkryetaria e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu, të cilat shprehën mirënjohje dhe vlerësim për punën shumëdimensionale të Departamentit të Gruas, duke e cilësuar si një institucion kyç në fuqizimin e grave dhe vajzave të reja në vend.

“Në emrin tim personal, në emër të institucionit të Republikës së Kosovës, ju uroj për përvjetorin e Departamentit të Gruas dhe ju dëshiroj suksese në të ardhmen”, u shpreh znj. Emilje Rexhepi.

“Sot, teksa e festojmë këtë përvjetor, ne festojmë edhe kontributin e secilës vajzë dhe secilës grua që ka qenë pjesë e këtij Departamenti, mësimdhënëse, ligjëruese, organizatore, studiuese, të cilat kanë ndërtuar ura mes vlerave fetare, familjare dhe shoqërore. Sot, ne jo vetëm që festojmë, por edhe rikonfirmojmë misionin tonë, të ndërtojmë një shoqëri ku çdo grua ndjehet e sigurt në shtëpinë e saj, e respektuar në komunitetin e saj, e dëgjuar në institucionet e saj. Departamenti i Gruas gjatë këtyre 20 vjetëve ka treguar se bashkëpunimi ndërinstitucional, edukimi fetar i balancuar dhe aktivizmi komunitar mund të sjellin ndryshim të qëndrueshëm”, tha në fjalën e saj mes të tjerash nënkryetaria e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu.

Gjatë kësaj ceremonie u ndanë edhe mirënjohje për aktivistet dhe mualimet e para, që dhanë kontribut në këtë Departament.

Mirënjohje iu nda koordinatorës së parë të këtij Departamenti, znj. Besa Ismaili për kontributin e dhënë në ngritjen dhe forcimin e Departamentit të Gruas (2010-2005), znj. Suela Dibra për kontributin e dhënë në Departamentin e Gruas gjatë viteve 2008-2005, aktivistes dhe mualimes Mihana Goga-Bekteshi për kontributin e dhënë në Departamentin e Gruas gjatë viteve 2010-2008, aktivistes Hanife Kastrati për kontributin e dhënë në Departamentin e Gruas gjatë viteve 2016-2009, mualimes Blerta Ilijazi për kontributin e dhënë në Departamentin e Gruas gjatë vitit 2010-2009 si dhe Zyrës për Çështje Fetare të Turqisë “Dijaneti” për kontributin e vazhdueshëm në projektet e Departamentit të Gruas nga viti 2015 e deri me tani.



Manifestimin e pasuroi edhe një ekspozitë me fotografi, e cila dokumenton veprimtarinë, projektet dhe zhvillimin e Departamentit ndër vite, duke sjellë para të pranishmëve një panoramë të qartë të kontributit të tij në jetën shoqërore dhe fetare të vendit.

Kujtojmë që Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, më 24 janar të vitit 2005, themeloi Departamentin e Gruas, një hap ky i guximshëm për fuqizimin e rolit të gruas në jetën fetare dhe shoqërore. Me hapjen e kësaj zyre u vendos një pikënisje e re, një hapësirë e dedikuar ku gratë mund të gjenin mbështetje, mundësi veprimi dhe një ambient ku idetë, iniciativat dhe bashkëpunimet merrnin formë.

Koordinatorja e parë e këtij Departamenti ishte znj. Besa Ismaili, e cila së bashku me një grup të palodhur aktivistesh vendosën themelet e forta të punës së tij.

Sot, falë mbështetjes së pakursyer të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë dhe falë angazhimit të jashtëzakonshëm të teologeve dhe aktivisteve, Departamenti i Gruas është shndërruar në një forcë të rëndësishme në shoqëri. Nga një zyre e vogël me pak aktivitete, është shndërruar në një strukturë të fuqishme me ndikim të gjerë, duke numëruar sot një brez të tërë teologesh të arsimuara, të përgatitura dhe të angazhuara në shërbim të komunitetit. Programet edukative janë zgjeruar, bashkëpunimet janë shumuar dhe roli i mualimeve është bërë i pazëvendësueshëm në jetën fetare dhe shoqërore. Departamenti vazhdon të rritet, duke sjellë ide të reja, projekte të qëndrueshme dhe një rrjet të gjerë profesionistësh, që sot përbëjnë një nga pasuritë më të çmuara të tij.

Departamenti i Gruas sot ka hapur degë në pothuajse të gjitha komunat e vendit, në të cilat kontribut japin mbi 150 mualime.

Aktualisht në gjithë Kosovën janë mbi dhjetë mijë vijues të mësim-besimit, të cilët ndjekin mësimet fetare në xhamitë ku mualimet zhvillojnë veprimtarinë e tyre.

Shota Krasniqi

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRI I ÇËSHTJEVE ISLAME, THIRRJES DHE UDHËZIMIT I MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE

Më 12 nëntor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga ministri i Çështjeve Fetare, Thirrjes dhe Udhëzimit i Mbretërisë së Arabisë Saudite, dr. Abdulatif bin Abdulaziz al Sheikh.

Gjatë këtij takimi, u biseduan tema me interes të ndërsjellë, veçanërisht në lidhje me çështjet islame dhe bashkëpunimin në fusha të ndryshme.

Ministri Al Sheikh, përgëzoi përpjekjet e bëra nga Kujdestari i Dy Xhamive të Shenjta dhe Princi i Kurorës në shërbim të Islamit dhe myslimanëve, përfshirë këtu kujdesin për kryerësit e umres dhe haxhit. Ai gjithashtu e njohu Myftiun Tërnavë për programet dhe aktivitetet ndërkombëtare të ndërmarra nga Ministria, me qëllim të thellimit të kuptimit të vlerave islame të nxjerra nga Kurani i shenjtë dhe Suneti i Pejgamberit, si dhe për të luftuar ideologjitë e gabuara.

Nga ana e tij, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shprehu mirënjohjen e tij për Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe udhëheqjen e saj, të përfaqësuar nga Kujdestari i Dy Xhamive të Shenjta, mbreti Selman bin Abdulaziz al Saud dhe Princi i Kurorës, Muhamed bin Selman bin Abdulaziz, për përpjekjet e tyre të palodhura në shërbim të qeverisë dhe popullit të Kosovës, përpjekje që do të mbeten të regjistruara përgjithmonë në analet e historisë.

Myftiu Tërnavë gjithashtu përgëzoi përpjekjet e ministrit dr. Abdulatif al Sheikh, në promovimin e moderimit dhe luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit, përmes programeve të shquara fetare dhe intelektuale nga të cilat ka përfituar Bashkësia Islame. Ai vlerësoi projektet e zbatuara nga Ministria e Çështjeve Islame dhe ndikimin e tyre pozitiv në popullin e Kosovës.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOMANDANTIN E KFOR-IT, GJENERALIN ÖZKAN ULUTAŞ

Më 21 nëntor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim zyrtar komandantin e KFOR-it, gjeneralin Özkan Ulutaş.

Myftiu Tërnavë, gjatë takimit, vlerësoi lart punën dhe kontributin e KFOR-it në garantimin e stabilitetit dhe sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke theksuar se bashkëpunimi i mirëfilltë ndërmjet institucioneve fetare dhe atyre të sigurisë është thelbësor për ndërtimin e besimit dhe harmonisë shoqërore.

Nga ana e tij, gjenerali Özkan Ulutaş, shprehu mirënjohjen për pritjen dhe vlerësoi rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës si një faktor i rëndësishëm në promovimin e paqes, dialogut dhe tolerancës ndërfetare.

Të dyja palët, në fund të takimit, konfirmuan gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm në të mirë të qytetarëve dhe stabilitetit të vendit.



MYFTIU TËRNAVA NËNSHKROI MARRËVESHJEN PËR HAXHIN 2026

Më 7 nëntor 2025, me ftesë të ministrit të Ministrisë së Haxhit dhe Umres së Arabisë Saudite, dr. Tefvik Rabiah, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i

shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë zyrtare në Xhide të Arabisë Saudite.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë dhe zëvendësministri i Haxhit dhe Umres,

z. Abdel Fettah Meshat, nënshkruan marrëveshjen e Haxhit për vitin 2026, me të cilën rregullohet organizimi i udhëtimit të besimtarëve kosovarë për kryerjen e haxhit.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI OBJEKTIN E AMBULANCËS NË GURAKOC TË ISTOGUT

Më 22 nëntor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi objektin e ambulancës në Gurakoc të Istogut. Ky objekt është ndërtuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, me financim nga organizata “Bejt Zekat” nga Kuvajti.

Myftiu Tërnavë u shpreh i kënaqur me punët në ndërtimin e kësaj ambulance, teksa edhe një herë rikonfirmoi gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të kontribuar në fusha të tjera, ashtu siç ka bërë edhe në të kaluarën.

Objekti i ri i ambulancës ka qenë një domosdoshmëri për banorët e kësaj ane, pasi që deri më tani, kushtet në të cilat kanë ofruar shërbime mjekët kanë qenë tejet të vështira.

Kujtojmë se gurthemeli për ndërtimin e kësaj ambulance është vënë më 1 korrik 2024, teksa së shpejti pritet të bëhet edhe hapja e saj për ofrimin e shërbimeve, si dhe dorëzimi i këtij objekti për Komunën e Istogut.



U PROMOVUAN VEPRAT “DËSHMITAR I GJENOCIDIT NË SREBRENICË” DHE “KONVERTIMI NË ISLAM NË BALLKAN”

Në kuadër të aktiviteteve të Panairit të 28-të të Librit – Tirana 2025, që u mbajt në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, më 15 nëntor 2025, u promovuan dy vepra me rëndësi të veçantë për historinë dhe studimet bashkëkohore, të botuara nga Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, më konkretisht vepra “Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë”, e autorit Mevludin Hrnjić dhe “Konvertimi në Islam në Ballkan”, i autorit Anton Minkov.

Për librin “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës” të autorit Mevludin Hrnjić, foli drejtori për Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, i cili theksoi se vepra është një rrëfim autentik i një të mbijetuarit të gjenocidit të Srebrenicës



dhe sjell për lexuesin kujtimet e dhimbshme të tragjedisë së korrikut 1995.

Ndërkaq, për librin “Konvertimi në Islam në Ballkan” i autorit Anton Minkov, profesor Sadik Mehmeti, në fjalën e tij, u shpreh se kjo vepër fton në një rishikim të thellë të paradigmave të

trashëguara dhe paraqet një korrigjim të rëndësishëm paradigmatic për studimet ballkanike.

Ky aktivitet u prit me interes nga vizitorët e panairit, të cilët u njohën nga afër me përmbajtjen dhe vlerën shkencore të këtyre dy veprave.

DELEGACIONI I BIK-UT MORI PJESË NË SIMPOZIUMIN SHKENCOR TË ORGANIZUAR NGA KMSHZ-JA

Më 17 nëntor 2025, delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, i udhëhequr nga sekretari i BIK-ut, njëherësh zv.myftiu Ahmet ef. Sadriu, dhe i shoqëruar nga drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora, si dhe drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në simpoziumin shkencor me temë “Xhamitë shqiptare në mërgatë në shërbim të kombit, fesë dhe integritetit”, të organizuar nga Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër.



Në këtë tubim morën pjesë përfaqësues të bashkësive islame nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, imamë, studiues, përfaqësues institucionalë nga Ambasada e Kosovës, Ambasada e Maqedonisë së Veriut, Konsullata e Kosovës në Cyrih, si dhe drejtues të unioneve islame shqiptare nga Gjermania, Austria, Italia dhe vende të tjera të Evropës.

Diskutimet u përqendruan në rolin e xhamive në diasporë si shtylla të identitetit fetar, kulturor dhe kombëtar të komunitetit shqiptar në mërgatë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, sekretari i BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, përshëndeti

të pranishmit në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe Myftiut Naim ef. Tërnavë. Ai shprehu mirënjohje për organizatorët, Komunitetin Mysliman Shqiptar në Zvicër dhe kryetarin e tij, hfz. Mehas ef. Alija, duke vlerësuar lart këtë nismë me karakter shkencor dhe komunitar.

Ndërsa, drejtori i IHSI-së, Sabri ef. Bajgora, paraqiti kumtesën e tij me titull “Xhamitë shqiptare në mërgatë për kauzën kombëtare”, duke theksuar rëndësinë e xhamive si qendra të identitetit dhe vetëdijes kombëtare. “Ky organizim dëshmon nivelin e lartë të vetëdijes dhe të organizimit. Shqiptarët tanë, kudo që jetojnë, duhet ta dinë se

nga vijnë, kush janë dhe si duhet të veprojnë për të mbrojtur fenë dhe identitetin e tyre, sot dhe në të ardhmen”, theksoi ai.

Ngjarja u vlerësua si platformë e rëndësishme diskutimi dhe si mundësi për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve fetare të vendlindjes dhe diasporës.

Pjesëmarrja e delegacionit të lartë të BIK-ut dëshmoi mbështetjen e fuqishme të institucionit për mërgatën shqiptare dhe vlerësimin për kontributin e tyre të vazhdueshëm në ruajtjen e fesë, identitetit, traditës dhe unitetit kombëtar.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS EKZEKUTOI 75 MIJË EURO PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËVE JETIMË

Bashkësia Islame e Kosovës ka vazhduar edhe këtë muaj me përkrahjen e saj të rregullt për fëmijët jetimë në vend. Ajo, më 18 nëntor 2025, ka dhuruar gjithsej 75 mijë euro, një shumë e cila u është shpërndarë 500 fëmijëve jetimë, secilit në vlerë prej 150 euro për tre muajt e ardhshëm. Ky donacion është realizuar në bashkëpunim me Qendrën e Mbretit të Arabisë Saudite për Ndihma Humanitare.

Tanseli Rogova, drejtor i Financave në Kryesinë e Bashkësisë Islame të

Kosovës, bëri të ditur se pagesat tashmë janë transferuar dhe se synimi i institucionit është që mbështetja të jetë e vazhdueshme. Sipas tij, “Bashkësia Islame e Kosovës është gjithmonë pranë jetimëve, si një nga kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.”

Gjatë muajit të kaluar, BIK, në bashkëpunim me Shoqatën “Bereqeti” ka shpërndarë çanta dhe pajisje shkollore për fëmijët jetimë, duke lehtësuar fillimin e vitit të ri shkollor për ta.

Në këtë drejtim, BIK-u ka paralajmëruar se nga viti i ardhshëm pritet të zgjerohet bashkëpunimi me Mbretërinë e Arabisë Saudite, me synimin që të rritet numri i jetimëve që do të përfitojnë nga ndihmat financiare dhe projektet e tjera humanitare.

Vetëm gjatë këtij viti, përmes këtij projekti, Bashkësia Islame e Kosovës ka ofruar 300 mijë euro në para të gatshme për fëmijët jetimë në vend, pa llogaritur format e tjera të ndihmave materiale dhe sociale.



U MBAJT TRYEZA “SHKATËRRIMI I XHAMIVE NË KOMUNËN E DEÇANIT DHE JUNIKUT NGA FORCAT SERBE GJATË LUFTËS SË VITEVE 1998-1999”

Më 26 nëntor 2025, në kuadër të festave të nëntorit, Këshilli i Bashkësisë Islame në Deçan, në bashkëpunim me Komunën e Deçanit, organizuan Tryezë diskutimi me temën: “Shkatërrimi i xhamive në komunën e Deçanit dhe Junikut nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1998-1999”.

Ky ishte një aktivitet me rëndësi të veçantë, i cili synonte jo vetëm informimin, por edhe nxitjen e reflektimit shoqëror rreth kësaj trashëgimie të dhimbshme.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues institucionalë, studiues, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe qytetarë, të cilët rikujtuan dëmet e mëdha të shkaktuara ndaj objekteve të kultit gjatë kohës së luftës. Gjatë diskutimeve u theksua numri i xhamive të shkatërruara, dëmet materiale, shpirtërore dhe kulturore që iu shkaktuan komunitetit, si dhe rëndësia e dokumentimit të këtyre krimeve kulturore për ruajtjen e kujtesës historike dhe të së vërtetës.

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, tha se trashëgimia islame shqiptare ka rëndësi të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh edhe pretendimet e fqinjëve për përvetësimin e saj, ndërsa theksoi se ruajtja dhe dokumentimi i kësaj trashëgimie është detyrë institucionale dhe shoqërore. Ai shtoi se një angazhim i tillë është pjesë e mbrojtjes së identitetit tonë historik.

Ndërkaq, Ramadan Shkodra, drejtor për Shtyp dhe Veprimtari Botuese, u shpreh se xhamitë ndër vite kanë shërbyer jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë kombëtar, duke nënvizuar rolin e tyre në ruajtjen e identitetit dhe kohezionit shoqëror. Ai përmendi se çdo objekt kulti bart një histori dhe një mesazh që lidhet ngushtë me qëndrueshmërinë e komunitetit.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora, para të pranishmëve foli rreth shkatërrimit të xhamive në periudhën e luftës së fundit në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, duke sjellë të dhëna të rëndësishme nga hulumtimet e institucionit.

Profesori i Historisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Selim Bezeraj, theksoi se “me shkatërrimin e xhamive u synua shkatërrimi i kujtesës kolektive dhe identitetit kulturor”, duke shtuar se rikthimi i vëmendjes ndaj këtyre dëmeve është thelbësor për të mos lejuar që e kaluara të harrohet dhe për të ndërgjegjësuar brezat e rinj.

Shkodran Imeraj nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, foli shkurtimisht rreth kontributit të ylemave në ndalimin e shpërnguljes së qytetarëve nga trojet shqiptare, duke theksuar rolin e tyre historik dhe moral.

Para fillimit të Tryezës, u hap një ekspozitë me fotografi, ku u prezantuan pamje të xhamive të shkatërruara në komunën e Deçanit dhe Junikut gjatë viteve 1998-1999.

Ekspozita u vizitua nga shumë qytetarë dhe u vlerësua si një kontribut domethënës në rikujtimin e dëmeve të shkaktuara trashëgimisë kulturore dhe fetare, duke i dhënë ngjarjes një dimension edhe më të fuqishëm sensibilizues.



28 NËNTORI – DATË QË DUHET TË NA BASHKOJË

Më 28 nëntor 2025, në të gjitha xhamitë, anekënd Kosovës, me rekomandim të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, u mbajt hytbe e përbashkët kushtuar festës së 28 Nëntorit – shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Në këtë hytbe, 28 Nëntori, u tha se më nuk mbetet vetëm një datë e rëndësishme në kalendarin tonë, por, tashmë kjo datë është një simbol i bashkimit rreth interesit kombëtar.

Duke e cilësuar përkushtimin për atdheun si një detyrë fisnike të çdo qytetari, u përmend se dashuria për atdheun të afron më tepër te Zoti dhe se, sakrifica për të, është një vepër që të ngre në radhët e dëshmorëve.

Një nga pikat që u përmend gjatë hytbes ishte edhe kontributi themeltar i parisë myslimane për kombin dhe arsimin, duke ngre zërin kundër keqdashësve, të cilët sot po synojnë që ta shndërrojnë çështjen kombëtare në burim përçarjeje.

“Të heshtim përballë këtyre shpifjeve, do të ishte tradhti ndaj Haxhi Ymer Prizrenit, themeluesit të Lidhjes së Prizrenit, e cila që më shumë se thjesht një organizim, dhe mesazhet e saja ishin më shumë se thjesht pakënaqësi dhe revoltë ndaj shtypjes.”

Përgjatë historisë sonë, paria jonë myslimane, kanë lënë trashëgimi të çmuar në urtësi dhe mendim politik. Ata, disa të njohur e disa edhe të panjohur për ne, dhanë dijen, kontributin dhe jetën për këtë vend, për këtë gjuhë, për këtë popull.

Ndër ata, të cilët u përmendën ishin edhe: Daut ef. Boriçi, themeluesi i Lidhjes së Prizrenit dhe hartuesi i abetares së parë shqipe, i cili shkroi: “Shqiptari, me mënyrën e shkronjave që kam kallzue, mbrenda pak kohe mundet me shkruë gjuhën e vet”; pastaj hafëz Ali Podgorica, kryetar i bashkisë së Durrësit, i cili me dorën e tij ngriti flamurin kombëtar; haxhi Vehbi Dibra,

firmëtari i pavarësisë, i cili dha fetvanë e njohjes së flamurit që kemi sot; hafëz Ali Korça, një ndër mësuesit e parë të shkollës shqipe në Korçë, i cili u cilësua si ai që “ujiti” shkronjat e Naimit; hafëz Ibrahim Dalliu, me kontributin e të cilit u themelua Normalja e Elbasanit; mulla Idriz Gjilani, i cili kur hapi mejtepin për djem e vajza, tha: “S’ka fe pa atdhe! Pa

një atdhe të lirë feja nuk mbahet, nuk mund të ushtrohet!”

Në fund, me mesazhin se 28 Nëntori duhet të na kujtojë përgjegjësinë që kemi ndaj trojeve tona, ndaj gjuhës, kulturës, unitetit dhe të ardhmes së brezave të rinj, u urua që Zoti ta ruaj kombin, fenë, gjuhën dhe vatanin tonë.



KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË KONFERENCËN ISLAME NË EDIRNE TË TURQISË

Nga 31 tetor deri më 2 nëntor 2025, në qytetin e Edirnes në Turqi, u mbajtën punimet e Konferencës Islame me temë “Nën nënqiellin e kupolës sonë”, organizuar nga Fondacioni “İslam Âlimleri Vakfı”, nën patronazhin e Guvernatorit të Edirnes.

Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në këtë Konferencë mori pjesë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili në seancën e parë të Konferencës, të udhëhequr nga prof. dr. Nasrullah Hacımüftüoğlu, prezantoi kumtesën me temë “Roli i institucioneve fetare në ndërtimin e kohezionit social në vendet ballkanike”.

Në këtë Konferencë morën pjesë edhe përfaqësues nga bashkësitë islame të dhjetë shteteve të Ballkanit, si dhe intelektualë dhe profesorë të njohur të shkencave islame nga Turqia dhe bota arabe.

Punimet e Konferencës, të ndara në gjithsej katër seanca, trajtuan tema me interes të veçantë mbi sfidat me të cilat

përballen shoqëritë islame në vendet e Ballkanit, si dhe nevojën e bashkëpunimit dhe koordinimit me bashkësitë simotra për të tejkaluar sfidat dhe rreziqet që kërcënojnë virtytet morale dhe vlerat familjare islame.

Në hapje të Konferencës morën pjesë ish-kryetari i Dijanetit të Turqisë Ali Erbash, zëvendëskryetari Osman Şahin, guvernatori i Edirnes, rektori i Universitetit të Trakisë në Edirne, si dhe shumë personalitete të njohura të botës akademike e publike të Turqisë.

Në seancën e tretë, që kishte për temë familjen dhe sfidat e saj në vendet e Ballkanit, kryeimami Sahiti, shpalosi para të pranishmëve rëndësinë dhe rolin historik të familjes shqiptare në ruajtjen e identitetit, si dhe në kultivimin e vlerave kombëtare dhe fetare të shoqërisë shqiptare. Ndër të tjera, ai theksoi sfidën e migrimit si një nga problemet më serioze me të cilat përballen familja shqiptare në kohët moderne, e cila në masë të madhe ka ndikuar në strukturën dhe stabilitetin e saj.



KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË SEMINARIN E ORGANIZUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT E TURQISË

Më 5 dhe 6 nëntor 2025, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në punimet e seminarit të organizuar nga Ministria e Arsimit e Turqisë, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Fetar, i cili u mbajt në Stamboll.

Përveç drejtuesve të arsimit nga Ministria e Arsimit e Turqisë, në takim ishin të pranishëm edhe këshilltarët për arsim pranë ambasadave turke në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, si dhe përgjegjësit për arsimin fetar pranë institucioneve të bashkësive islame të këtyre vendeve.

Gjatë punimeve të seminarit, kryeimami Sahiti, theksoi rolin dhe rëndësinë që kanë institucionet fetaro-arsimore të Bashkësisë Islame në

përgatitjen e kuadrove, si dhe kontributin e tyre në ngritjen e vetëdijes, edukimin dhe fisnikërimin e besimtarëve. Ai po ashtu nënvizoi nevojën e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve edukativo-arsimore në hartimin e kurrikulave, shkëmbimin e përvojave dhe përfitimin nga përvoja e pasur e shkollave “İmam Hatip” në Turqi, me qëllim të ngritjes së cilësisë së

arsimit fetar dhe avancimit të institucioneve fetaro-arsimore në vendet tona.

Në fund, kryeimami Sahiti, theksoi rëndësinë e përmirësimit të infrastrukturës bashkëkohore arsimore dhe domosdoshmërinë që medresetë tona t'i plotësojnë ciklet e arsimit të ulët dhe të mesëm, në përputhje me nevojat bashkëkohore të arsimit fetar.



DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË TUBIMIN E ORGANIZUAR ME MOTON: “ME EMRIN E ALLAHUT, BASHKË NDËRTOJMË DRITË E BASHKIM”

Më 1 nëntor 2025, me ftesë të Kryesisë së Xhamisë dhe Qendrës Kulturore Shqiptare në Hildesheim të Gjermanisë, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, dhe imami i xhamisë “Mati 1”, Fadil ef. Musliu, morën pjesë në tubimin e organizuar me moton: “Me emrin e Allahut, bashkë ndërtojmë dritë e bashkim.”

Ky aktivitet u mbajt në kuadër të iniciativës për blerjen e objektit për xhami në Hildesheim.

Tubimi ishte një ngjarje e veçantë, ku morën pjesë shumë mysafirë nga diaspora dhe nga trojet tona. Përveç numrit të madh të besimtarëve nga Gjermania dhe më gjerë, të pranishëm ishin edhe mysafirë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Lugina e Preshevës.



Në fjalën e tij para të pranishmëve, drejtori Ekrem ef. Simnica, përshëndeti pjesëmarrësit në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe Myftiut Naim ef. Tërnavë. Ai theksoi vlerën dhe rolin e xhamisë në jetën e besimtarit, duke nënvizuar rëndësinë e kontributit në ndërtimin, renovimin dhe blerjen e objekteve fetare.

Tubimi u karakterizua nga një atmosferë vëllazërore dhe entuziaste, duke u përmbyllur me sukses përmes grumbullimit të shumës së nevojshme për blerjen e objektit të xhamisë në Hildesheim.

Në fund të aktivitetit u shkëmbyen dhurata dhe u ndanë mirënjohje për kontributin e dhënë, të cilat u pranuan nga kryetari i xhamisë, z. Idriz Pulaj.

DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË MBRËMJEN HUMANITARE PËR BLERJEN E XHAMISË NË QYTETIN PERG TË AUSTRISË

Më 22 nëntor 2025, me ftesë të kryetarit të ALKIG-ut, Vahidin ef. Behlulit, njëherësh kryetar i këshillit të xhamisë, drejtori për Diasporë në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në mbrëmjen humanitare për blerjen e xhamisë në qytetin Perg të Austrisë.

Në këtë organizim morën pjesë figura të rëndësishme të jetës fetare nga bashkësitë islame të vendlindjes dhe diasporës, duke dëshmuar nivelin e lartë të angazhimit dhe unitetit të komunitetit shqiptar mysliman në Evropë.

Drejtori Simnica, pasi përshëndeti të pranishmit, përcolli përshëndetjet dhe urimet në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve udhëheqëse të saj dhe Myftiut Naim ef. Tërnavë, si dhe më pas foli për vlerën e xhamive në diasporë. Ai theksoi se kush kontribuon për këto shtëpi të Allahut, në fakt po ndërton një fortifikatë për fenë dhe

identitetin e vet në këtë botë dhe një pallat për veten e tij në Ahiret.

Në fund, ai i uroi për zemërsisht kryetarin e xhamisë në Perg, Vahidin ef. Behlulin, Kryesinë dhe xhematin për blerjen e kësaj xhamie, duke shpresuar që ajo të bëhet pikë bashkimi, uniteti dhe fuqizimi shpirtëror për komunitetin shqiptar në Perg të Austrisë.

Edhe kësaj radhe, shqiptarët e Pergut të Austrisë dhe nga mbarë bota

dëshmuan zemërgjerësinë, përgjegjësinë dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar për shtëpitë e Allahut.

Gjithashtu, gjatë qëndrimit në Austri, së bashku me drejtorin e diasporës në BFI-së së Maqedonisë së Veriut, Mafiz ef. Rrustemi, shfrytëzuan rastin për të vizituar edhe dy qendra të tjera islame: “Bashkimi” në Linz dhe “Horizonti” në Wels, ku u takuan me imamët dhe kryetarët e këtyre xhamive.



DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË MANIFESTIMIN E ORGANIZUAR NGA XHAMIA “BASHKIMI” NË LINZ TË AUSTRISË

Drejtori për Diasporë pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, së bashku me kryetarin e ALKIG-ut, Vahidin ef. Beluli, morën pjesë në manifestimin me rastin e festës së 28 Nëntorit, të organizuar nga xhamia “Bashkimi” në Linz të Austrisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori Simnica, përcolli urime e falënderime në emër të Bashkësisë Islame të

Kosovës, institucioneve udhëheqëse dhe të Myftiut Naim ef. Tërnavë. Ai theksoi rëndësinë e unitetit, ruajtjes së vlerave tona fetare dhe kombëtare dhe angazhimit të vazhdueshëm të mërgatës në mbështetje të institucioneve të atdheut.

“Kjo ditë na kujton se liria, identiteti dhe bashkimi nuk janë dhuratë, por janë amanet dhe përgjegjësi që çdo brez

duhet t’i ruajë dhe t’i ndërtojë më tej. E në diasporë, kjo përgjegjësi është edhe më e madhe. Ne jemi zëri, imazhi dhe pasqyrimi i kombit tonë. Me punën tonë, me moralin tonë, me familjet tona dhe me bashkësitë tona fetare e kulturore, ne tregojmë se kush janë shqiptarët dhe nga vijnë”, tha mes të tjerash ai.

Manifesti u begatua me pjesëmarrjen e madhe të shqiptarëve atje, ndërsa këtë organizim e zbukuruan grupi i nxënësve me paraqitjen e tyre të bukur dhe shfaqjen e programit festiv dhe ish-nxënësi i Medresesë “Alauddin”, Rexhep Sahiti, i cili në kuadër të programit u paraqit me uniformën e veteranit të UÇK-së, duke sjellë emocione dhe respekt të veçantë për sakrificën e brezave të lirisë.

Drejtori Simnica shprehu falenderim dhe mirënjohje të veçantë për gjithë organizatorët duke i uruar të gjithë shqiptarët për festën e 28 Nëntorit.



DHUROHEN VESHJE DIMRI PËR NXËNËSIT NË MEDVEGJË

Më 19 nëntor 2025, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” dhuroi veshje dimri për fëmijët e shkollës fillore “Banja e Sjarinës” në Sjarinë, si dhe për nxënësit e shkollës “Zenel Hajdini” në Tupallë – Medvegje. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet

Shoqatës “Bereqeti” dhe imamit të Medvegjës, Ilham Hasani, të cilët u angazhuan për të mbështetur familjet dhe fëmijët në nevojë gjatë stinës së ftohtë.

Drejtuesit e shkollave, mësimmhënësit si dhe përfituesit shprehën mirënjohje

të veçantë për këtë kontribut humanitar, duke theksuar se ndihma e tillë sjell gëzim dhe lehtësim të dukshëm për komunitetin lokal.


Faleminderit të gjithëve që mbështesin kauza të tilla në dobi të fëmijëve, arsimit dhe komunitetit tonë!



**BOTIM
I RI**

Shtëpia botuese "Dituria Islame" ka botuar librin "Vakëfi – Dispozitat Themelore" të Burhanuddin Ibrahim bin Musa Et-Tarabulsit, një vepër e rëndësishme që mbështetet në tekstet themelore të medhëbit hanefi dhe synon t'u ofrojë studentëve e studiuesve një qasje të qartë dhe të besueshme mbi rregullat dhe praktikën e vakëfit. Duke u bazuar në dorëshkrime të rralla dhe në literaturë të mirënjohur juridike, libri paraqet një pasqyrë të plotë mbi dispozitat, investimet dhe rëndësinë shoqërore të vakëfeve, duke plotësuar një boshllëk të rëndësishëm në literaturën islame në gjuhën shqipe. Librin mund ta siguron në Librarinë "Dituria Islame" në Prishtinë.

<https://www.facebook.com/librariadituriailame>



DITURIA ISLAME • Nr. 421 DHJETOR 2025